**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Kuvendi i Komunës Rahovec***
*Skupština Opština Rahovac/Municipality of Rahovec*

---

**01 Nr. 05/22**
**Rahovec, 20.05.2022**

Ftohen anëtarët e Kuvendit Komunal, që të marrin pjesë në mbledhjen e cila do të mbahet më **31 maj 2022 (e martë )**, me fillim në orën **10:00**, në sallën e KK Rahovec.
Për këtë mbledhje propozoj këtë:

**R E N D D I T E**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për bartjen e mjeteve rezervë në investime kapitale;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për themelimin e Komiteteve për Arsim dhe Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për përbërjen dhe organizimin e Komitetit për Arsim;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për përbërjen dhe organizimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft - Rregullores për dhënien e titujve të nderit, dekoratave dhe çmimeve nga Komuna e Rahovecit;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për aprovimin e listës së anëtarëve të zgjedhur të Këshillit të Fshatit Hoçë e Madhe;
9. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për ndryshimin dhe plotësimit e vendimit 01 Nr.296/22, i datës 30.03.2022 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e morgut për nevojat e komunitetit të fshatit Hoçë e Vogël;
10. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr.295/22, i datës 30.03.2022 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për nevojat e komunitetit të fshatit Çifllak;
11. Raporti vjetor i Punës së Komitetit të Auditimit për vitin 2021.

**KRYESUESI I KUVENDIT**

**Defrim Kafexhiu**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Kuvendi i Komunës Rahovec***
*Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec*

---

# PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **29.04.2022,** me fillim në ora **10:15.** Mbledhjen Kuvendit e ka udhëhequr Kryesuesi i Kuvendit z. Defrim Kafexhiu. Konstatoj se kuorum për mbajtjen e mbledhjes kemi, fillimisht e përshëndes nënkryetarin e Komunës z. Fatmir Iska, anëtaret e kuvendit komunal, ekzekutivin. përfaqësues te mediave dhe gjithë të pranishmit ne sallë.
E kemi edhe një pikë shtesë, betimi i kuvendarit të ri z.Alban Bajraktari, i cili ftohet ne foltore për leximin e deklaratës për betim:
**Alban Bajraktari -** Unë, Alban Bajraktari, "Betohem se do t'i kryej me nder, besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat, dhe do ti ushtroj autorizimet e mia si anëtar i Kuvendit të Komunës së Rahovecit, në mënyrë që të sigurohen kushtet për jetë të qetë për të gjithë".
**Kryesuesi –** I nderuari z. Alban Bajraktari ju urojë mirëseardhje në mesin tonë. Pikat e rendit të ditës për këtë mbledhje janë:

## REND DITE

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar**
2. **Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;**
3. **Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Rahovec (QKMF);**
4. **Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt Planit Komunal për Integritet 2022-2026;**
5. **Raporti vjetor i Punës së Komitetit të Auditimit për vitin 2021;**
6. **Shqyrtimi dhe miratimi propozim vendimit për bartjen e mjeteve vetanake nga viti 2021 në vitin 2022;**
7. **Shqyrtimi i Raportit financiar janar – mars 2022;**
8. **Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për formimin e komisionit për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve, rrugicave, parqeve, shesheve, lagjeve në komunën e Rahovecit;**
9. **Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve, rrugicave, parqeve, shesheve, lagjeve, në komunën e Rahovecit;**
10. **Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për caktimin e lokacionit për hapësira për biznese;**
11. **Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave Komunale për bujqësi;**
12. **Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P-00054-0, 00265-0, 00498-0, 02909-0, 03015-0, 03016-0, 00251-0;**
13. **Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale për blegtori;**
14. **Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P-02302-0 dhe P-00250-0;**

15. **Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shpalljen me interesi të përgjithshëm publik parcelën P-71513005-02756-0 në Zonën Kadastrale Krushë e Madhe;**
16. **Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shpalljen me interesi të përgjithshëm publik parcelën P-71510033-00527-1 në Zonën Kadastrale Xërxë;**
17. **Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shpalljen me interesi të përgjithshëm publik parcelën P-71510033-00527-2 në Zonën Kadastrale Xërxë;**
18. **Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për vazhdimin e kontratës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës;**
19. **Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për themelimin e Komitetit Konsultativ për Arsim në Komunën e Rahovecit;**
20. **Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim vendimit për themelimin e Komitetit Konsultativ për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në Komunën e Rahovecit.**

**Kryesuesi** – Para se të dalim me propozime te anëtarëve te kuvendit kumunal, pika e pestë e rendit te ditës, raporti vjetor i Punës së Komitetit të Auditimit për vitin 2021, për shkak te mungesës te kryesuesit te komitetit kjo pikë duhet të tërhiqet prej rendit te ditës, këtu kemi edhe emailin e dërguar nga z.Sead Rama, "Desha të ju njoftojë që nesër nuk mund te jem prezent në kuvend për arsye personale pasi që më ka ndodhur një punë urgjente jashtë dhe nuk gjendem në Rahovec. Me shpresë qe seancën tjetër te bëjë raportimin para kuvendit komunal".
**Sinan Kryeziu** – Përshëndetje, faleminderit kryesues. Unë në emër te grupit te VV-së, kërkojë që pika e rendit te ditës nr.6 të shtyhet për senacën e radhës për arsye që ketë pikë në seancat e kaluara ne e kemi votuar pro, por për shkak te gjetjeve nga ana e ministrisë se financave, ka kërkuar ndyshim dhe rivotim në asamble, ne kërkojmë kohë që në seancën e radhës ta kemi materialin e të gjeturave, sepse mendojmë që ne mund të japim kontribut për ndryshim-plotësim-miratim, sepse kemi frikë që ministria e financave ta kthej prapa përsëri.
**Sejfullah Sejfullahu** – Përshëndetje për të gjithë, kam kerkesë që pika e 10-të, pothuajse e 15-ta, që është fjala për Krushë te Madhe, për shpalljen e interesit publik, të shtyhet një seancë apo dy, sepse kemi nevojë për disa konsultime dhe kohë.
**Kryesuesi** – Faleminderit Sejfullah, kryetari ka një sqarim lidhur me këto propozime, pastaj i vendosim në votim.
**Kryetari** – Përshëndetje kryesues Defrim Kafexhiu, drejtorë, asambleistë, media, nënkryetar. Kam një sqarim për Sinan Kryeziun; Ministria e pushtetit lokal, departamenti i ligjshmërisë dhe ministria e financave, kanë thenë që për tri projekte, shumë thjeshtë nga pozicioni i shërbimeve kapitale duhet te kalojnë në mallra dhe shërbime, pra, para dy seancave është dashur që ne mjetet e njëjta, mos ti bëjmë investime kapitale, po në mallra dhe shërbime. Kjo eshte kërkesë e ministrisë se financave – departamenti për buxhet. Drejtori Afrim limani është në dijeni te plotë për këtë qështje. Prandaj nuk duhet të humbim kohë, duhet të jemi te qartë se kjo është kërkesë e ministrisë se financave, te njëjtat kode duhet të kalojnë nga investimet kapitale në mallra dhe shërbime, vetëm ky është ndryshimi, gabimi këtu eshte se ministria është vonuar gati dy muaj, une ju ftoj ta votoni, këtu ndërrohet vetëm kategoria, kush nuk mendon si unë, le të vjen për demantim, ne e kemi bë me procedurë me kohë, por gabimi ynë është që nuk e kemi qenë në dijeni që investimet kapitale tani e tutje duhet të barten në mallra dhe shërbime. Anëtarët e vjetër të kuvendit e dijnë shumë mirë se çfarë jam duke folur, d.m.th nuk është asnjë gabim këtu, thjeshtë ndërrohet kategoria. Sa i përket problemit të ngritur nga Sefa, duhet ta dini që para se ta shpallim zonën me interes publik, sigurisht që spastrohet qështja ne aspektin ligjor, bëjmë edhe dëgjimin publik në komunitet, e tëra qe kërkohet këtu është që ne, pronat e njëjta kërkojmë ti mbrojmë me kuvend te komunës, ku cdo ndryshim tjetër duhet prap te pytet kuvendi, është shumë e sigurt kur me vendim të kuvendit shpallim një parcelë me interes të përgjithshëm, por kjo nuk d.m.th që ne kemi të drejtë te veprojmë blanko, duhet ta spastrojmë situatën me gjeodezi dhe gjërat e nevojshme si dhe të konsultohemi me komunitet.
Në këëe rast ne duhet t'i takojmë Krushianët, të supozojmë që është një projekt për dhënien në shfrytëyim për nevojat që kanë bizneset, por përsëri duhet të bëjmë takime konsultative. Nuk kemi nevoj për

mosmarrëveshje, sepse vendimi ketë thotë "pika e rendit të ditës per caktimin e lokacionit" d.m.th ne veq e caktojmë lokacionit, e më pas e mbrojmë me vendim te kuvendit te komunës, më pas i trajtojmë temat tjera në procedurë.
Prandaj të ftoj për mosvonesë, sepse ne deshirojmë herën tjetër ta shpallim për Xerxë, për Ratkoc, për periferi te qytetit nëse kemi hapsirë, duhet që t'i mundësojmë hapësira te lira bizneseve vendore, por edhe të jashtme.
Shumë mirë që nuk e kemi rastin si me pronën ne Opterushë (zona ekonomike), që e kemi në bashkinvestim me ministrinë, prandaj aty jemi të stagnuar, mjetet janë, por nuk zhvillohet procedura per pjesëmarrje ne 20%, ata 80%, si është e rregulluar me ligj, ndërsa per Krushë, Xërxe, Ratkoc, Çifllak, Kramovik, Fortesë, ku do që të jetë, ne investimet i bëjmë vet si komunë, ose me partneritet publiko-privat e bëjmë zonën fuksionale, për ketë arsye nuk e quajmë "zonë ekonomike" se ky term nënkupton ndërlidhje edhe në investim edhe në qeverisje.
Ju ftoj që edhe si krushianë që mos të vonoheni për ketë pikë se herën tjetër mund të jetë ndonjë pronë tjetër ne Krushe, për shpallje ne interes të përgjithshëm.
**Sejfullah Sejfullahu** – kryetar, t'a kuptova bukfalisht "nietin e mirë", gjithçka është OK, por këto spastrime që i permende duhet të kryhen paraprakisht. Ne kemi shumë probleme, ju e dini shumë mirë për problemin me AKM-në, qëllimin e mirë për mbrojtje e kuptoj, por aty kemi shumë konteste dhe është mirë të bëjmë një bisedë paraprakisht me qytetarë krushianë. Po iu tregoj një pasqyë: aty ekzistojnë toka që janë konfiskuar për pak tatime, aty ka toka qe hasianët iu kanë shitur krushianëve pa dokumentacion dhe sot e kësaj dite nuk i kanë vendosur mbi vete.
Ju e dini problemin e "Komasacionit" qe 30 vite që është në Krushe, deri më sot asnjë iniciativë as nga komuna as nga ministria e bujqësisë, më herët nuk kam qenë i kyçur në politikë, me sa e di dikush e ka fituar tenderin për Komosacion, por nuk ka lëvizur asgjë. Pa tendencë dhe jo si rol opozitarë, kërkojmë kohë dhe të ulemi për bashkëpunim. Sinqerisht qëllimi për biznese është shumë i mirë dhe puna më e mirë që kishit mundur ta bëni është rregullimi i Komosacionit, sepse aty ka uzurpime, ka njerëz që i shfrytëzojnë mbi 2 prona, t'i zbulojmë uzurpatorët. Për fat të mirë gjithçka është në emër te komunës, e jo të AKM-së, andaj kërkojmë informata shtesë dhe me sinqeritetin më të madh kërkojmë shtyrje të mbledhjes.
**Kryetari** – Sefë, ne bazohemi ne dokumentacion Kadastral, nuk është momenti, por e dimë edhe në qoftëse ka uzurpatorë, hapi i parë është që përmes kuvendit ta mbrojmë pronën, pastaj fillojmë me procedura tjera, ne shpesh edhe pronat e AKP-së i kemi shpallë si zona me interes të përgjithshëm, për parandalimin e veprimeve te paligjshme, për detaje ju e dini qe ne cilën rrugë kemi kaluar ne si popull, por une i besoj kadastrës sonë, e saktë me historiate te shkëlqyera. Ideja per shpalljen e zonës ne interes të përgjithshëm është ide e shkëlqyer ne fazën ku jemi, për cdo lloj prone. Psh: në çoftëse ne nuk i shpallim, atëherë vazhdon loja "jo është pronë e imja, jo ma kanë konfiskuar", jo të bëjnë presion ty si përfaqësues i popullit ne kuvend, jo atij tjetrit.
Çdo presion që mundet me të ardhë ty, ose dikujt tjetër këtu, ne i kemi institucionet tona, ne nuk guxojmë të shkelim mbi te drejtën e pronës mbi askënd. Ne çoftëse ka pretendime, ka ndonjë lëndë në gjykatë atëherë ne nuk guxojmë te veprojmë, por mirë është t'i marrim në mbrojtje pronat, që nesër munden me qenë burim konfiktesh. Sa i përket Komosacionit, këtu ka pasë tentativa, këtu komuna, ministria dhe agjensioni kadastral involvohet vetëm nëse ka vullnet te komunitetit, dhe për ketë temë nëse ka vullnet për zgjidhjen e këtij problemi atëherë krushianët përsëri duhet të mbledhen, ti drejtohen komunës, jemi gati me peticion, me nënshkrime dhe gjithçka është në rregull, formohet komisioni i përbashkët, ministria e bujqësisë, komuna dhe agjensioni kadastral dhe i japim zgjidhje këtij problemi bashkë me vullnetin e artikuluar te krushianëve që e shohin si pengesë për realizimin e të drejtave te caktuara, jam krenarë qe jam kaq i saktë.
**Sejfullah Sejfullahu** – kryetar, nuk dyshoj ne saktësinë e kadastrës, po qytetarët kanë blerë toka, duke menduar qe me kohë ta kthejnë në pronë mbi vete, tokat kanë qenë te mbuluara me ujë, qytetari ka bë shpenzime te mëdha për t'a konvertuar në arë, edhe me pas kanë dal në pah problemet e përkthimit sepse

toka figuron në emër te komunës, personalisht une sot e kisha votuar, por kam shumë presion prej komunitetit për shtyetje të votimit, me vullnet. Kaq.
**Kryetari** – Për pronat e komunës bëhen konsultimet publike, këtu pronare është komuna e Rahovecit, qka duhet te bëjmë me ketë pronë e bëjmë si e parasheh ligji.
Në ketë rast nëse ajo pronë është e komunës, krushianët nuk kanë asnjë arsye ta pengojnë vullnetin edhe mos të respektojnë autoritetin komunal. Unë mund te akuzohem edhe për mosveprim, se ndokush thotë: është duhet u keqpërdorur prona komunale, sepse nuk posedojmë vendim të kuvendit për marrje në mbrojtje pronën e caktuar, çfarëdo ndodhie që mund ta kemi duhet shpalosur me komunitet.
Ne edhe mund ta shtyejmë votimin, nuk është problem, por nuk bëjmë zgjidhje. Zgjidhje kemi atëherë kur kuvendi i komunës thotë: pronat e mia i shpalli zona ose parcela me interes të veçantë. Atëherë fillon debati me komunitet, nëse ka pretendime, ka lendë në gjykatë, paraqitje të padisë, që i bie që duhet edhe mirë kish me qenë me fillu me Krushë sepse aty ka hapësira, ka edhe në Xerxe, ka në periferi te qytetit, ka ne Malësi te vogël, në Ratkoc është vetëm një hapësire edhe ajo është e mbrojtur, edhe shume mirë që është.
Ne si kuvend i komunës duhet ti mbrojmë pronat tona, me miratimin e vendimit. Se çka realizohet aty, zone ekonomike, palestër sportive apo diqka tjetër, prap vendoset me kuvend, me konsultime, me ekspertizë ...
Prandaj unë jam per mos mi shty këtëogjëra, se nuk ka nevojë, njejtë ka me ndodhë edhe mbas dy muajve.
**Burim Krasniqi** – Sefa është prej atij komuniteti edhe i njeh rrethanat më specifikisht, prandaj e mbështesë.
Unë si shef i grupit rekomandoj për shtyerjen e pikës 10 dhe 15-të, nën aryetimin se vendimi thotë: "Shpallje e zonës për interes të përgjithshëm për biznes" kjo e ngulfatë aspektin e shfrytëzimit për bujqësi dhe turizëm, këtu rekomandoj shtyerje dhe duke ardhur me një vendim në kuvend pa specifikacion si dhe me plan zhivillmorë komunal prej drejtorisë së urbanizmit ashtu si parashihet kjo zonë për të ardhmen. Nuk i arsyetoj pretendimet e njerëzve për pronat, pronën komunale është mirë të mbrohen, megjithatë ne si asambeistë te LDK-së pajtohemi me Sefën dhe kerkojmë ta shtyejmë pikën 10 dhe 15-të.
Sa i përketë pikës 6-të për bartjen e mjeteve edhe ne si grup pajtohemi me propozimin e Sinanit.
Dua të them që ne kemi votuar me mirëbesim, nuk i kemi hy analizave të thella, përveq që kemi qenë ne dijeni për teprimin e mjeteve, edhe OK.Tash jemi duke e parë që votimi ka qenë veprim i gabuar, veprim i gabuar vendimmarrës i asamblesë komunale.
Nuk e kemi pasë edhe rekomandimin e ministrisë së financave dhe ministrisë së pushtetit lokal pse është gabim? Kryetari është në dijeni, por edhe ne duhet me qenë ne dijeni.
E dyta që dua ta diskutojë është që sipas raportit financiarë të vitit 2021 keni thenë janë shpenzu 98% të mjeteve, ne anën tjetër 600,000eu janë 10% të investimeve kapitale, 600.000eu nuk i ka komuna e Rahovecit të hyra vetanake vetëm për muajin dhjetor (periudha e mbylljes së vitit fiskal). Eshtë mire të jemi në dijeni në cilat projekte kanë mbetë mjetet e pashpenzuara që janë bartë këtu. Sepse këto janë mjete të pashpenzuara të kodeve specifike buxhetore. Pëveq që kerkojmë prej asambleistëve shtyerjen e kësaj pike për seancën e radhës, po kerkojmë të jemi në dijeni se prej cilave kode buxhetore kanë tepru këto mjete, në suaza të mirëkuptimit ta votojmë shtyerjen dhe të na jepni informata plotësuese për ketë pikë. Faleminderit.
**Kryetari** – Burimi nuk e ka të qartë qe mjetet e nëntorit dhe dhjetorit nuk kanë te drejtë shfrytëzimi, këtu bëhet fjalë për tejkalim të hyrave, pra ju nuk e keni të qartë çka keni votu, gabimi qendron te ju, jo te ne.
Ju lutem, barjtja e të hyrave (ka tejkalim bukur të mire të të hyrave) plani i të hyrave ka qenë 1.062.000eu ndërsa kemi 497.000eu më shumë, plus të hyrat që nuk kemi të drejtë ti shpenzojmë në nëntor dhe dhjetor.
Ministria e financave ka thënë qe këto kanë me qenë mallra dhe shërbime, jo investime kapitale, pra ne e kemi vazhdu traditën për 4 vite për të njejtat projekte, psh: një projekt është furnizimi me gypa, kemi kontratë, obligim aty, prej ministrisë kanë thenë qe furnizimi me gypa nuk do te jetë më investim kapital, po do të konsiderohet mallra dhe shërbime, pra votimi ka ndodh shumë në rregull me qëllimin më te mirë në vazhdimësi të traditës së miratimit të vendimeve të kuvendit komunal, ku ministria e financave i ka përfillë duke thenë qe këto projekte: Hartimi i projekteve, furnizimi me gypa dhe intervenimet emergjente, nuk kanë me qenë më investime kapitale, por janë mallra dhe shërbime, pra këtu nuk ekziston asnjë gabim, kemi

vepruar drejtë, mirëpo ministria e financave tani e tutje këto janë mallra dhe shërbime, e jo investime kapitale. Prandaj ju them që nuk ka nevojë për bllokim të procesit.
Unë e ftoj PDK-në dhe VV-në qe ta votojnë pikën e bartjes së mjeteve, sepse mos harroni qe jemi edhe në krizë financiare dhe skemi nevojë për bllokim të mjeteve.
Ne edhe mund ta shtyejmë, por mos harroni se edhe një muaj zgjat, ne qoftëse sot merret vendimi per bartje të mjeteve. Atëherë ju ftoj ta mbështetni ketë pikë, ndërsa sa i përketë pikes së Krushës, nuk më pengon shtyerja e pikës, qëllimi është ta mbrojmë pronën tonë duke e shpallur interes të përgjithshëm sa më shpejtë sepse jam në dijeni të shqetësimeve të krushianëve. Prandaj i drejtohemi Burimit, që nëse keni rol frenues dhe bllokues duhet ta dijnë qytetaret e komunës, nuk ta sygjeroj ketë rol.
Edhe një herë, është shumë e thjeshtë, këto tri projekte që i kemi votu në investime kapitale, ministria na thotë që të kthehen në mallra dhe shërbime, dhe nuk e konsideroj te logjikshme që për ketë gjë të shtyhet votimi sepse do të ishte gabim kardinal politik, atëher reflekto Burim, sepse je perfaqësues, mos e merr pozicionin e bllokimit, sepse janë 600.000eu dhe duhet me i vendosë në punë.
**Kryesuesi** – Fillimishti i kam dy fjalë, pastaj fjalën e kanë kërkuar: Burimi, Bejtullahu, Sinani.
Po besoj që nuk është qështje e kryetarit, se kush e mban primatin e opozitës. Unë si kryesues i kuvendit komunal i mbrojë interesat e anëtareve të këtij kuvendi, çdo ofendim kundër tyre është i papranueshëm dhe i panevojshëm.
**Kryetari** – kryesusesi duhet të ma jep fjalën, e dyta: kryesusi duhet te jetë ne dijeni qe nuk duhet të bejë komente për kryetarin, por ka për detyrë administrimin e seancës, prandaj vetëm asambleistat kanë drejtë për komente. Edhe një herë, ministria e financave thotë; per zhbllokimin e 600.000eu vendosni prej investimeve kapitale, në mallra dhe shërbime, përndyshe nuk mund të përdoren, tri projekte; hartimi i projekteve, furnizimi me gypa, intervenimet emergjente nuk ka asgjë të paqartë këtu, prandaj e ftoj kuvendin mos të vonohet.
**Burim Krasniqi** – janë për keqardhje këto fyerje ndaj asamblesë- mesazhi më i keq i mundshëm.
Bllokues nuk jam as une as LDK-ja, sepse në seancën e pare, bartjen e mjeteve e kemi votuar pa hamendje, pa diskutim me mirëbesim, e tash është bërë ndonjë gabim duke u bazuar në fjalët e ministrisë së financave edhe asaj të pushtetit lokal dhe prap duhet te votojmë, dhe thoni qe ne e dijmë qka kanë thënë ata, e për juve nuk ka rëndësi, mos u tallni me ne. Me profesion jam inxhinier, nuk jam filozof siç thotë kryetari, prandaj i kam fjalimet e shkurtëra dhe të qarta.
**Kryetari** – Burim Krasniqi, askush nuk mundet me marrë përsipër me e fy kuvendin, ne ketë rast ju po talleni me kuvendin. Nuk është qështje mirëbesimi këtu, në rend dite ka qenë votimi, ka vazhduar tradita e votimit, si është votuar çdo here në ketë kuvend, ministria e financave ka thënë qe ky votim për investime kapitale është gabim, duhet me qenë mallra dhe shërbime. Kaq.Fyerje ska këtu, jam një ndër kryetarët e rrallë qe vij në seancë dhe ju e dini qe kam të drejtë një herë në gjashtë muaj. Burimi mundet me pytë kryetarin e komunës Imri Ahmetin, se ne e kemi diskutuar ketë problem në asociacion të komunave se pse hartimi i projekteve nuk është më investim kapital. Ministria e financave shumë projekteve iu ka ndërruar kategorinë buxhetore, prandaj këtu shpesh herë kemi diskutu për keqklasifikim, prandaj në çoftëse nuk e miratojmë bartjen e të hyrave, konsiderohet edhe keqklasifikim edhe bllokim i të hyrave vetanake. Kaq.
**Sinan Kryeziu** – faleminderit kryesues, ketë farë pune po e marr me sportivitet, sepse këto mjete janë tepricë, pa hezitim po e them që kur është propozuar këtu për votim, gjithë grupi i VV-së kemi qenë pro.
Ne nuk po themi qe nuk do ta votojmë kurrë, nuk e di çka është keq qe ne mund ta japim kontributin tonë edhe mbas një muaji, shumë thjeshtë. Ne grupin tonë i kemi disa eksperta, që duhet të konsultohemi, që mos ta kemi problemin e kthimit edhe një herë. Shumë faleminderit, ne jemi per shtyerje për seancën e radhës.
**Bejtullah Deliu** – faleminderit, i nderuar kryetar, kryesus, drejtorë, media.
E mirëkuptoj dhe mishërohem plotesisht me asambleistin Sejfullah Sejfullahu, per vetë faktin me qfarë emocioni dhe shqetësimi bisedoi rreth këtyre pikave, ne e mbështesim asambleistin tonë dhe kërkoj edhe nga kryetari edhe nga kolegët tjerë që keto dy pika të tërhiqen nga rendi i ditës, ndërsa sa i përket pikes 6, është seanca e katërt qe vazhdimisht po kerkojë më tepër materiale dhe po neglizhohet nga secili, nuk jemi

të njoftuar asnjeherë detajisht para seancës se çka bëhet fjalë, te bëhemi gati kur te vijmë ne seancë, së paku materlialet që kthehen nga ministria përkatëse ti kemi edhe ne, pse janë kthy? Arsyeshmëritë ti kemi. Nëse i kemi me kohë ne edhe mund ti përkrahim, e jo gjatë seancës ta kuptojmë arsyen e kthimit nga ministria. Ne po dalim ndoshta edhe keq para votuesve tanë në ketë rast edhe jemi ne lajthitje edhe me ministrinë.
Duhet të debatojmë për këto të holla që duhet të kthehen, e që duhet të shtyhet 1 muaj, 2 ose 3, mirëpo nëse ne nuk jemi të mirëinformuar nuk është etike që vetëm me një ngritje të dorës t'i votojmë pikat.
**Besmire Bytyçi** – Faleminderit kryesues, i nderuar kryetar, nënkryetar, kolegë asambleistë, të nderuar drejtorë. Realisht nuk e kuptoj tendencën për t'a shtyrë pikën, kur në KPF u sqaruan të gjitha dhe zotërinjtë në fjalë nuk i patën të njejtat mendime, nuk e di cili ka qenë ndyshimi prej KPF-së e deri më tani.
Konsideroj që përveq që mos të hiqet kjo pikë nga rendi i ditës, duhet patjetër edhe të votohet, sepse qytetarët e komunës po presin përfundimin e projekteve qe janë të shkruara pikërisht në ketë pike të rendit të ditës. Ju ftoj për konstruktivitet, pa dallime, për opozitë me vend dhe të kemi përkrahje reciproke. Faleminderit.
**Kryetari** – Në bazë te raportit te MAPL-së, ne jemi komuna e vetme qe kemi më pak "shkelje" nga kuvendi i komunës. Unë pajtohem me Bejtullahun që ne duhet t'iu japim informacione vazhdimisht, por ne e kemi edhe një filtër qe quhet komiteti për politika dhe financa (KPF), që besoj drejtori Afrim Limani e ka sqaru. Kjo pike ka ardhë ne kuvend pa deshirën tone që edhe një herë me hy në rend dite. Dëshira jonë e dini qe ka qenë ashtu siç e kemi diskutuar para 2-3 muajve, ti hargjojmë mjetet, por në tri projekte janë blloku 600.000eu, qe po thonë levizi, prej kësaj kategorie në tjetrën, asgjë tjetër nuk ndyshon pos kësaj.
Ju siguroj qe kuvendi i komunës në momentin qe ka votuar për barjten e mjeteve, nuk ka gabuar siç mendohet, pse ka qenë koha kur është dashur të votohet. Arsyeja tjeter qe skemi gabuar në votim ka qenë qe praktikat e mëhershme e kanë dëshmuar qe këto kategori çdo herë kanë qenë investime kapitale, tani nuk e kemi veq komuna jonë ketë problem, por të gjitha komunat e Kosovës, lirisht pyetni kryetarët e partive te juaja për këto probleme qe po flasë në kuvend, e kemi vazhdu traditën, ministria e financave po thotë jo në investime kapitale, bartni në mallra dhe shërbime. Kaq. Sa i përket Sinanit, me respekt: nuk mundemi ti shpenzojmë mjetet vetanake të vitit 2022 kur plani tejkalohet, të nëntorit edhe dhjetorit nuk kemi të drejtë sepse ligji na ndalon, e kur kemi tejkalim nuk mundemi ti shpenzojmë po në atë vit, duhet patjetër të barten në vitin tjetër. Tani qe i kemi 497.000eu më shumë, ne e kemi pyetur kuvendin për vendosje në këto projekte, sa i perketë shpenzimit në atë vit, nuk kemi të drejtë ligjore dhe për ketë arsye bëhet bartja e mjeteve për vitin tjetër, ky sqarim bazohet në ligjin mbi menaxhimin e fincancave publike. Prap po i drejtohem Burimit, se ky e din qe une kam të drejtë në ketë rast e edhe këta duhet me votu, por nuk po e ftoj për votim, le të mbetet ne ndërgjegjen e tij si përfaqësues i zgjedhur dhe si një kryetar i një subjekti politik. Duhet ta kemi të qartë se mjetet e njëjta nuk mund ti shpenzojm pa i bartë ne mallra dhe shërbime si dhe duhet ndërruar vendimi nga kuvendi i komunës. Propozimi im si sponzorizues i dy pikave për Krushe, pa marr parasysh qe arsyetimi nuk është i bazuar deri në fund, por për shkak të shqetësimeve, ne duhet të ulemi per konsulltë me Sefën, Beratin, Arbrin...Kjo neve mund të na vonojë por nuk na shkaton problem, ndërsa pika nr.6 e bartjes është telashe, nuk është mirë që kuvendit te komunës ti ndodh kjo, për arsye të kota.
Unë propozoj që dy pikat me i tërheq, pikat për Krushën. Ndërsa pikën për bartje ju ftoj për votim, na kanë kërkuar ketë korrigjim, ndoshta edhe prap na kthejnë prapa, për ketë arsye ekziston kuvendi i komunës. E teprova, por me qëllim të mire. Ju lutem, une ktu jam bashkë me juve per me i qu proceset përpara.
**Rasim Fazliu** – Faleminderit kryesuse, përshëndetje për kryetarin, nënkryetarin, asambleistat, drejtorët, përfaqësues të mediave. Sa i përketë bartjes së mjeteve vetanake prej vitit në vit edhe une desha të kontribuoj pak me mendimin tim. Po flasë në bazë të punës se i kemi kryer në ligjislatura tjera, pavarësisht se kush ka qenë kryetar i komunës, bartja e mjeteve gjithmonë duhet të bëhet, sepse është në interes te qytetarëve. Kontributi jonë mund të jetë se në cilin vend mund ti shfrytëzojmë ato mjete, nuk po flasë politikisht, por ajo qka duhet të ndodh, pa marr parasysh se kush është në pushtet.
Me kryetarin desha të sqarohem, sepse në mandatin e kaluar për katër vite, çdo herë në shtator për votim të buxhetit, e kemi pasë pikërisht të njëjtin problem. Kemi thëne që disa projekte që i takojnë investimeve

kapitale, nuk duhet të jenë ashtu, por i takojnë mallrave dhe shërbimeve, me pasë kanë ndodhur ngecje e diskutime si dhe mosvotimi i buxhetit për arsye që qeverisja ka pas kundërshtim kategorik në këtë rast per dallim me neve. Kemi bërë edhe pyetje në ministrinë përkatëse, por nuk kemi marr përgjigje, duke na thëne qe nuk mund të na japin përgjigje njëherë. Kjo ishte sa i perketë bartjes së mjeteve, për pikat tjera shefin e grupit të PDK-së bashkë me Sefën, e mbështesim dhe vazhdojmë tutje.
**Burim Krasniqi** – Kryetar, keni ardhë me tendencë në takim, se nuk kam kërkuar asgjë më shumë se Bejtullahi. Kur vijnë dokumentet ne asamble komunale, mos llogaritni që ne i votojmë edhe harrojmë qka ka ndodhë. Raporti financiar per vitin 2021, ne faqe 3 tabela 1.2 thotë: te hyrat janë tejkalu 111.000eu dhe në muajin nëntor dhe dhjetor i kemi vetëm 171.000eu të hyra, kjo nënkupton që nuk janë tejkalime të planifikimeve 600.000, por janë mjete të pashpenzuara në kode të caktuara buxhetore, ne fillim kërkova informatën se qka ka thëne ministria dhe prej cilat kode buxhetore kanë tepru ketë para, thjeshtë po dëshmoj që nuk kam ardhë për të filozofuar, por po ju tregojë se qka keni pru për të votuar në raportin financiar.
**Kryetari** – Burimi le ta mëson qe ekzistojnë te hyrat e rregullta dhe te jashtzakonshme të gjykatave që janë gjobat e trafikut, gjobat nga pyjet. Prandaj këto vijnë çdo tre mujorë. 170.000eu, ju po thoni qe ka tejkalim, por bashkë me gjobat qe dalin kah fundi i janarit, janë 497.000eu, shikoje saktë, por kaq është tejkalimi i planit. Ne nuk kërkojmë që të votoni diqka qe se keni të qartë, Burim. Mos voto bllanko kurrë, as ju as askush. Ideja është qe ne duhet ta tejkalojmë ketë qështje, në rend dite posepo, por edhe për ta votuar.
**Kryesuesi** – Faleminderit kryetar, atëherë po vazhdoj me qështje të votimit, fillimisht për propozimin e Sinan Kryeziut, për shtyerjen e pikës 6, kush është PËR largimin e kësaj pike për seancën tjetër?...
Kundër?... Atëherë në ketë rast, me keqardhje unë duhet t'a shfrytëzoj të drejtën e votës së dyfishtë si kryesues, votoj për shtyerje për këtë pikë për seancën tjetër. Atëherë pika e 6 e rendit te ditës shtyhet për seancën tjetër me 15 vota PRO, 14 KUNDËR, fjalën e ka kryetari Latifi.
**Kryetari** – Mirë, ju e votuat. Sefë seriozisht nuk po të kuptoj pse duhet ta shtyejmë ketë pikë, për kundër dy pikave tjera që të kuptova. Në rregull është e drejtë e juaja. Unë nga sot, me anëtarët e kuvendit për veq qe do sillem me respekt, do mundohem të sillem ndryshe, sepse këtu ka edhe paragjykime, tendenca, pozicion frenues si dhe pozicion inatesh. Unë ndoshta me njërën prej partive politike do ta shikoj mundësinë e bashkëpunimit, e këta të tjerët mund të "rreziten n'dilli", por nuk është mirë që ndodhi, "e bafshi me shnet" Burim, përndryshe zgjedhjet kurr ske me i fitu, të siguroj, jeni duke e komplikuar jetën e qytetarëve.
E ftoj PDK-në për reflektim edhe VV, për kundër Burimit, me ketë negativitet jo korrekt kundrrejtë dy partive tjera.
**Kryesuesi** – faleminderit kryetar, pauzojmë 10 minuta e me pas vazhdojmë... Atëherë, kuorum më duket qe kemi, vazhdojmë ... propozimi i Sejfullah Sejfullahut, largimi i pikës 10 dhe 15 nga rendi i ditës, të dy pikat janë për zonën kadastrale në Krushë, po i vendosi të dyjat në votim...Kush është PËR? kundër, abstenim? Atëherë me shumicë votash aprovohet propozimi i Sefës, për shtyerjen e pikave 10 dhe 15 për seancën e ardhshme. Rekomandimi i sekretarisë se kuvendit është që gjatë votimit dorën mbajeni lartë me shumë sekonda që na ndihmon më lehtë numërimin e votave per dërgim në MAPL.
**Rumir Zhuniqi** – faleminderit të gjithëve. E kam edhe unë një propozim, që pikën 2 (pyetje dhe përgjigje të kuvendarëve) të shtyhet për senacën tjetër.
**Kryesuesi** – për hirë të korrektësisë, po e vendosi propozimin e Rumirit për largimin e pikës 2 në votim:
Kush është PËR? (janë 5 vota PËR), kundër? Abstenim? Atëherë po e vendosim në votim miratimin e rendit të ditës me gjithësej 16 pika: fjalën e ka kryetari Latifi.
**Kryetari** – Unë propozoj rikthimin në rend të ditës të pikës 6 edhe i ftoj asambleistët ta votojnë propozimin tim.
**Kryesuesi** – Meqenëse anëtarët e kuvendit kanë votu një herë kundër edhe propozimi ka qenë një herë prej ekzekutivit për ketë pikë të rendit të ditës, duhet të marrim një interpretim prej një zyrtari ligjorë, a ka të drejtë që një pikë që është votuar kundër, të propozohet prej ekzekutivit, nëse ka mundësi bazimi të jetë ligjorë. Në momentin që vjen miratimi prej zyrës ligjore, ne e vendosim në rend dite.

**Kryetari** – e di që është votuar një herë, por kuvendi ka rregullore dhe ju ftoj për mos të vonohemi, ndoshta po e teproj, por seanca tjetër bëhet në maj, e per ketë pikë të bartjes të mbajmë seancë të jashtzakonshme, nuk është e arsyeshme. Ju ftoj me mirëkuptim, le të rikthehet pika, përgjegjësitë i ka prap kuvendi, sepse jemi shumë vonë jemi ne muajin e pestë të vitit, e mjejtet janë të vitit 2021, kjo vështirëson pozicionin e komunës. Unë e kuptoj mendimin ndryshe, por ne nuk jemi ministria e financave, ne e kemi pritur sqarimin në muajin mars, kemi pas vonesë sepse ka probleme në të gjitha komunat, ju kisha lut rikthejeni pikën në rend dite.
**Kryesuesi** – e mirëkuptoj kryetarin, por kërkojmë një interpretim brenda 10 minutave nga zyrtarët ligjorë, që është e drejtë që për pak minuta një pikë e rendit të ditës të rikthehet menjëherë, në momentin qe e kemi interpretimin e vendosim në rend të ditës edhe votohet.
**Bejtullah Deliu** – jemi konfuz pak në ketë pikë, kisha pas qejf të dalim në pauzë pasi edhe e kemi kohën.
E me pas edhe vendosim.
**Kryesuesi** – Atëherë shkojmë me një pauzë deri ne ora 13:30...
E kemi miratimin e rendit të ditës, kush është PËR miratimin me përmbajtje prej 16 pikave? Me shumicë votash miratohet rendi i ditës. Vazhdojmë te pika e parë e rendit të ditës "shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar" Kush është PËR?... Me shumicë votash aprovohet edhe pika e parë e rendit të ditës. Kalojmë te pika e dytë e rendit të ditës, a ka ndokush prej kuvendarëve ndonjë diskutim?
**Lirigzon Kastrati** – Faleminderit kryesus, te nderuar drejtorë, kolegë asambleistë.
I kemi tri pyetje për ekzekutivin, projekti i shtratit të lumit për fshatrat Brestoc, Hoçë e vogël, Nagac dhe Krushë e Madhe, është një projekt që është lenë në gjysëm, kompania kontraktuese qe i ka fillu punimet aty, banorëve iu ka vështirësu punimin e pronave të tyre, kërkojm sqarim për këtë qështje. Projekti tjetër për fshatrat e njejë është për ndriçim, ka fillu por nuk e dijmë kur përfundon? Ju faleminderit.
**Kryetari** – Une e dhashë një propozim edhe një herë për rikthimin në rend të ditës nr 6 kërkoj të hidhet në votim, ju ftoj për mirëkuptim duke filluar nga kryesuesi e shefat e grupeve ta rikthejmë, është kerkesë shumë e arsyeshme dhe është shumë mirë me respektu, me rikthy në rend dite dhe sinqerisht po flasë ta kalojmë ketë pikë, sepse kemi edhe tema tjera, i kemi edhe ditët e pushimit andaj ju ftoj kushdo që e propozon vetëm ta kalojmë, mjafton vullneti ta rikthejmë në rend dite.
**Kryesusi** – Faleminderit kryetar, pa marr parasysh bisedat ose sygjerimet e tuat me shefat e grupeve, unë po besojë që është mirë të shtyhet për një seancë tjetër, me ardhë me një vendim, pasi edhe është miratuar rendi i ditës nuk jam për me vendosë sot ne votim, por ende nuk e kemi interpretimin e zyrës ligjore a lejohet apo jo. Kjo është për ketë qështje. Këtu jemi si institucioni më i lartë brenda komunës dhe në rast jemi duke rënë ne lajthitje. Kryetari i komunës është mysafir këtu dhe nuk ka të drejtë t'i përzihet kuvendit në punë të brendshme. Të paktën injorimi i kryetarit të komunës që po i bëhet asamblesë komunale, prej fillimit të mandatit të ri është i paprecedent, rasti i sotëm-kryetari po dëshiron t'a rikthejë një pikë që është votuar për largim, dëshiron ta rikthej prapë edhe një herë në po të njejën seancë dhe vonohet 40 minuta në pauzë, prandaj është e paarsyeshme une të ju pres dhe e vazhdova seancën.
**Kryetari** – më fal, së pari kryetari i komunës nuk është mysafir këtu, e dyta, asnjë seancë e kuvendit të komunës nuk mund të mbahet pa konsulltë me kryetarin e komunës, me ligj po të flasë.
Shumë korrekte është sjellja ime, ju e miratuat rendin e ditës me arsyetimin vonësës dhe pamundësisë për pritje, nuk bën kështu, kuvendi i komunës nuk bën me injoru kryetarin e vet me arsyetime shterpe, me mirëkuptim fola me të gjithë, qe mos ta shtyejmë sepse ka mundësi edhe sot me u kry.
Paralajmërim, me çdo alternativë do ta bejë shumicën në kuvend, dhe mund të jetë seanca e fundit qe kuvendi e ka ketë kryesus, shkruajeni ketë në procesverbal. Edhe një herë ju them, une jam i vetdijshëm që propozimin po e kërkoj me e rikthy në kuvend, një punë qe duhet ta kryejmë sot, skemi nevoj ta lëmë mbas një jave. Imagjino tash kuvendi i komunës ti vonoj të hyrat e veta, skemi nevojë për vonesa, ju tregva qe çdo herë ministria i ka pranu kategoritë buxhetore njejtë si cdo herë. Ketë herë ka pas ndryshim në të gjitha komunat e Kosoves, hallin e kam unë sepse jam përgjegjës me u siguru qe komuna megjithatë po funksionon mirë me kuvendin e vet. Nuk është puna me e vu në lajthitje askë, sepse u konsultova me zyrën

ligjore dhe më thanë që është në rregull, duhet ta rikthejmë në rend të ditës, sepse une as në ëndërr nuk e ka pa që do të ndodhë kjo situatë. Këto pare nuk i shkojnë ekzekutivit, po janë kontrata janë operatorë që presin, janë borgje financiare. Mirëkuptone, nuk është në rregull që kjo pikë te shtyhet për muajin maj, duhet ta përfundojmë tash, sepse të gjitha komunat janë në hall të njejtë me këtë qasje të re të ministrisë.

**Kryesuesi** – kjo qasje e kryetarit para meje në ketë foltore është e papranueshme për kuvendin komunal edhe për mua si përfaqësues i këtij kuvendi. Unë jam anëtar i kuvendit komunal, nuk e kam me patjetër të qëndroj në krye të kuvendit, jam i zgjedhur nga ky kuvend dhe do të qëndroj deri në momentin qe ky kuvend mendon ndryshe. Do ta kryej punën me përpikmëri të madhe dhe do ti mbrojë kuvendarët nga "ofendimet" që munden me ardhë prej ekzekutivit. Dua të dal te qështje e KPF-së, të paktën e kam për llogari ta raportojë këtu për raportet qe i kemi pasë me ekzekutivin si zyrë e kryesuesit. Një shembull konkret: vetëm një herë ne formë jozyrtare kryetari më ka ftuar për konsultim për pika të rendit të ditës, për ftesën që i dërgohet anëtarëve të KPF-së. Qështja tjetër është që kryesuesi i kuvendit po vendoset para aktit të kryer, ku nënshkrimi i ftesës për thirrjen e seancës të KPF-së është i domosdoshëm, nëse jo, atëherë kryesuesi del keq para KPF-së, para asambleistëve por edhe para qytetarëve te komunës se Rahovecit. Pra, të gjithë asambleistët meritojnë ta dijnë raportin kryesuse-ekzekutiv, e kam një thirrje tjetër për zyrtarët ligjorë që operojnë ne komunën e Rahovecit, në këto 4 seanca jo çdo herë kemi marr vendime në përputhje ose në shpjegimet e zyrtareve ligjorë, kjo i bjen qe kuvendi ka vepruar drejtë sepse asnjë vendim nuk është kthyer nga MAPL. Përkundrazi MAPL ka kthyer vendime të cilat i ka përpiluar zyra ligjore. Tjetër qështje, kryetari i tha Burim Krasniqit protagonist i opozitës, që nuk është e vertetë sepse protagonist nuk kemi, këtu kemi kuvend komunal kryetar, si tërësi. Unë përveti nuk i dalloj si pozitë si opozitë. Po kthehna edhe një herë te qështja e kryesuesit, nëse mendon që unë si kryesues kam frikë prej shkarkimit, mendon gabim. Nuk e kam domosdo të mbesë kryesues i kuvendit, po më e rëndësishmja është qe kuvendi nuk mbetë pa kryesues. Kushdo që bëhet nuk ka fare rëndësi. Ky kuvend komunal vepron në bazë të një rregulloreje që ka dal po prej këtij kuvendi dhe ka marrë miratimin prej MAPL-së, nëse kjo rregullore nuk respektohet, atëherë nuk po respektohet asambleja komunale. Faleminderit për vëmendje.

**Kryetari** – kryetari i komunës asnjëherë nuk e refuzon asamblenë komunale, nga 12 takimet qe janë mbajte në të gjitha kam marrë pjesë, asnjëherë ska ndodh mos me i respektu vendimet e kuvendit të komunës, asnjëherë nuk ka ndodh qe kryetari me ik prej ballafaqimeve në kuvend. Kryesues, e para une nuk ti tregoj detyrat qe të takojnë si kryesues i kuvendit, por as ju nuk ka nevoj të më tregoni se cilat detyra me takojnë si kryetar komune, une i respektoj vendimet e kuvendit sepse kështu ma kërkon ligji. Nëse unë si kryetar i komunës, kam deshirë që ta kem shumicën në kuvend, kjo nuk është kercënim, ska nevojë për frikë, ti e din qe po të kisha pas mundësi si kryetar i komunës me vendos se kush bohet kryesuse, ti nuk do të ishe berë kurrë. Po në ketë rast je berë kryesues sepse kuvendi i komunës ka vendosë ashtu. Pse ti vjen te sekretatria, e nuk vjen në zyrë te kryetari i komunës për bashkëpunim? Ose pse ti nuk e thirr ne telefon kryetarin e komunës? Nëse mendon që e kam gabim, pse spo konsultohesh për rend dite? Pra, në qoftëse ky kuvend vendosë per inicim të procedurës për lirim nga detyra për kryesues, nuk duhet të të vie keq, prandaj po të ftoj për seriozitet për punë. Janë rreth 600.000eu të cilat po kërkohen me zhblloku e që janë vonu, dhe një kryesues është njeriu nr.2 i komunës zyrtarisht, dhe nuk duhet me shfaqë animе në ketë situatë ku jemi për moment. Nuk e kom pas idenë më të vogël që në ketë pikë të rendit të ditës të kemi telashe, sepse kjo pika ka kaluar nëper filtra, është votu më herët dhe tani po kërkohet ndrrimi i kategorisë. Mos e ngarkoni komunën se komuna ka lajme të mira, kemi shpërblim 1.148.890eu jemi nr.1, i dyti është Ramiz LLadrovci, i treti Imri Ahmeti, kështu që mos ti njollosim si kuvend lajmet e mira që ka komuna jonë, jam bashkëpunues, ju shërbejë te gjithëve, nuk bëj dallime, kryetari me ekzekutivin gjithmonë nga ne kërkohet llogaria, kjo është arsyeja që unë duhet ta marr fjalë shumë shpesh në kuvend dhe në momentin qe unë kërkoj ta marrë fjalën, duhet ta marr për demantimin e gjërave që nuk qëndrojnë. Sa i përketë zyrës, zyra ligjore është institucion i cili i përgatit vendimet që i propozon kryetari ose ekzekutivi për kuvendin e komunës. Nuk bëhet asgjë edhe nëse gabojnë, pse ja keni marrë inatin Mirsadit edhe Isakut, këta janë institucion që kanë përgjegjësi për hartimin e këtyre dokumenteve, mos harroni kuvendi i komunës se

Rahovecit është ndër kuvendet më të mira në Kosovë, dhe cdo vendim që është kërkuar për rikthim në kuvend, e kemi rikthy. Pra jemi komunë bukur normale dhe mos e prishni këtë normalitet. As nuk ju fyej as nuk ju ofendoj ashtu si mendoni ju, se fyerja më e madhe është mos me ardh mu ballafaqu këtu, me i pas 2 pika në rend dite dhe kuvendi i komunës mos të ketë material për shqyrtim. Kemi ardh në pushtet për punë, për ketë arsye i kemi 20 pika në rendi dite sot, se po punohet. Edhe një herë ju ftoj të gjithëve, mos të vonohemi, mos ti grumbullojmë punët nesër e mbasnesër, propozoj edhe një herë me e rikthy në rend dite pikën, me mirëkuptim nuk është mirë me u blloku kuvendi, e as pikat e rendit të ditës sepse me këso gjërash nuk ka prespektivë në planin afatgjatë.

**Kryesuesi** – nuk d.m.th. që kuvendi komunal ka stabilitet vetëm atëherë kur i shkon përshtati kryetarit të komunës, asambleja komunale si tërësi e kryen punën e vet, kryetari të veten. Fjalët e kryetarit i marr si kërcenim, po jo asi lloji i kërcënimit qe me e dërgu në gjykatë, në fund nuk ka nevoj të më drejtohesh me "nuk e ki gat" thjesht janë procedurat, janë elementet, i ki mundësitë. Vazhdo, kaq.

**Kryetari** – jam duke e shqyrtuar mundësinë me arritë shumicën, ndoshta e bëj edhe me juve edhe ti vazhdon të mbetesh kryesues. Jam i interesuar sepse ekziston një bllokadë në kuvend. Të ftoj që mos mendo që institucioni i kuvendit të komunës është krejtësisht i pavarur nga ekzekutivi i komunës, janë disa relacione që duhet të ruhen dhe bazohen në ligj dhe mos harroni qe keni të bëni me një kryetar që deri më tani nuk ka asnjë aferë, bile bile jam më i fortë se Albin Kurti, sepse atij cdo ditë po i dalin skandalet, nuk udhëheqi unë me qeveri të skandaleve. Kështu qe prap po ju them, qysh u mirëkuptuam për ato dy pikat e Krushës, ju lus ta rikthejmë pikën e bartjes, sepse është veprimi më i mirë për ketë kuvend komune, sepse kemi pika tjera në seanca tjera, nuk e di pse ka kaq shumë nevoj për kësi lloj ligjëratash.

**Kryesuesi** – e kanë kërkuar fjalën disa prej asambleistave, por unë e kisha bë një konsulltë me sekretarinë e kuvendit, për një propozim, që këtë seancë ta lëmë të hapur dhe të vazhdojmë javën tjetër për shkak të ecurisë që e kemi marr një farë rruge pa përfundim. Nëse hasim në mirëkuptim te anëtarët e kuvendit, një datë e përshtatshme mundet me qenë sot një javë (e premte), ok vazhdojmë me këta që e kanë kërkuar fjalën, Besë Bytyqi, Hasani, Sinani, Isaku etj...okej me tolerim, fjala për Isakun.

**Isak Hoti** – Përshëndetje kryesues(me zë të madh) kryetar, anëtarë dhe drejtora.

Nën 1, zyra ligjore asnjëherë askënd nuk e vë në lajthitje, nën 2, më shumë se dy herë të kam thënë, kur ti kemi pikat e rendit të ditës me pas takime më të shpeshta, kur të konvenon ty, qoftë edhe në dy e tre të natës, në shtëpi apo zyrë. Neni 81 i LVQL- shqyrtimi i detyrueshëm i ligjshmërisë së aktit, ndër tjera neni 82 thotë; nëse autoriteti mbikëqyrës se një vendim apo akt i komunës nuk është në përputhje me kushtetutën dhe ligjet, komuna duhet të rishqyrtoj vendimin apo aktin e tillë, për më poshtë i kemi edhe afatet ligjore, organi i njësisë për VQL i përgjigjet kërkesës për shqyrtim brenda 30 ditësh, nëse komuna nuk i përgjigjet brenda afatit, refuzon kërkesën, apo mbështet vendimin apo aktin e kontestuar, autoriteti mbikëqyrës mund të kundërshtoj aktin me një fjalë në gjykatën e qarkut (tash janë gjykatat tjera, pasi e qarkut nuk ekziston), d.m.th nëse ju nuk veproni, me ketë punë mirret gjykata. Argumente për kryetarin qe e ka vendosë në propozim ka me bollëk, nënshkrues i vendimit ka qenë kryesuesi i kuvendit. Kaq pata, ju përshëndes.

**Besmire Bytyqi** – Faleminderit kryesues, është diskutuar shumë rreth rendit të ditës, kush kënd e ka vë në lajthitje, nuk po mirremi vesh, i vetmi qe kuvendin e ka vë në lajthitje me ketë rend dite jeni ju kryesues i nderuar. Fillimisht kur seanca nisi the kështu, unë propozoj ta heqim pikën 5 "Raporti vjetor i Punës së Komitetit të Auditimit për vitin 2021" pse ta heqim? Pa konsulltë me neve dhe pa e pyetur kuvendit, dëshironi apo jo? Për tre pika që ju keni pasë interes keni pyetur, për këtë pikën tjetër jo, pse kryesues? Pse i ke vë ne lajthithje kolegët e mi? Ne si grup i Aleancës, propozojmë që pika e 6-të "Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për bartjen e mjeteve vetanake nga 2021 në 2022" me të gjitha gjërat qe i tha kryetari i komunës, zyrtari ligjorë dhe qe e diskutuam së bashku të futet në rend dite për në seancën në javën e ardhshme. Gjithashtu në KPF, në këtë rast Burimi (më vjen keq që po ta përmendi emrin), por ke thënë në rregull është, meqenëse e kemi votuar një herë, e vetojmë sepse nuk paska asnjë problem, këto janë fjalët e tua Burim, i kemi edhe në procesverbal, e mbajë në mend shumë mirë. Faleminderit.

**Sejfullah Sejfullahu** – ju falenderojë për pikat, kjo i bie që më unifikues se unë nuk po del askush.

E dyta, kryetar, ftoji shefat e grupet parlamentare, diskutoni rreth këtij problemi me MAPL-në, që mos të mbesim edhe në në pozitë të keqe, për nder nuk ka ndonjë efekt që edhe tash të votojmë, por më herët e ngrita dorën, tash ta bëj të kundërtën, atëherë dyshojnë votuesit e mi, kështu që po ndihem shumë mire, merruni me shefa të grupeve parlamentare, Faleminderit.
Për fund kam kënaqësinë për një lajm të mirë, heroina jonë Fahrije Hoti- drejtoresha e kooperativës, është shpallë "Gruaja europiane e vitit 2022"- e meritojmë një duartrokitje ne si krushianë...
**Kryetari** – Unë fjalën e mbajë, kur kemi dakordim jemi unifikues, nuk kemi qëllim me vë në lajthitje askush njëri-tjetrin, nëse tani kemi votuar pro, nëse kemi dakordim mundemi mbas dy ore të votojmë kundër. Në këtë rast unë kërkoj dakordim me të gjithë shefat e grupeve, për pikën për të cilën sot "kemi ça drrasa" është mirë t'a tejkalojmë, e nesër mos ta kemi barrën e vonesës sepse ky është proces, jemi ne muajin e pestë të vitit dhe ne ende se kemi bërë bartjen e të hyrave vetanake, ju lutem këtë pikë ta kalojmë sot, sepse drejtoria e financës nesër duhet ta dërgojë dokumentin – javën tjetër e vazhdojmë pjesën tjetër të mbetur të seancës.
**Sinan Kryeziu** – Faleminderit kryesues, kur zyrtari ligjorë i lexoi ligjet, unë si jurist mendoj që leximi edhe interpretimi dallojnë duke u drejtuar të unë me një vrazhdësi. Unë ligjin di ta interpretojë vet, por kur jemi te interpretimi i ligjit, te njerëzit e profesionit mendoj që kemi lloje të ndyshme të interpretimit të ligjit.
Kemi interpretim logjik- përmes logjikës e marrim interpretimin se a është i mirëqenë zbatimi i normës juridike apo jo. Te rasti në fjalë që po flasim, këto janë pretendime të palëve të cilët kanë të drejtë ligjore të pretendojnë a kanë të drejtë apo jo. Nëse kryesuesi në këtë rast ka bërë shkelje procedurale siç tha nga shefja e grupit të aleancës, mendoj që nuk është ajo me dal me konkluzion, e ka mirë apo keq, por nëse mendoni qe keni të drejt, atëherë e keni të drejtë qe në instanca më të larta të bëni kallëzim, ligjin nuk e njoh mirë, por e njoh shumë mire. Faleminderit.
**Hasan Përboqi** – Përshëndetje kryesues, të nderuar asambleistë, ekzekutiv i komunës. Kryesues, pa dashtë të replikoj askënd tjetër, me sinqeritetin më të madh, parimisht rendin e ditës e keni nënshkruar ju, dhe ju na keni bërë ftesën për sot në seancë dhe në moment që kryesuesi del kundër nënshkrimit të vet, nuk më duket aspak e ligjikshme, nuk është në rregull dhe mbi të gjitha në situata kur kemi vota të barabarta, kryesusi e shfrytëzon votën e dyfishtë edhe prap i bie që po del kundër nënshkrimit të vet duke thënë që duhet ta heqim nga rendi i ditës, kur ka dyshime duhet para nënshkrimit ta heqim një pikë nga rendi i ditës. Kjo është situata më e qartë ku ne asambleistat jemi vu në lajthitje, prap po them situatë jo e mirë kur kryesuesi del kundër nënshkrimit të tij, faleminderit.
**Kryesuesi** – Unë i qendrojë mbrapa këtij nënshkrimi, une i nënshkruaj edhe vendimet për dërgim në MAPL, por shumica në asamblenë komunale ma zhbëjnë edhe nënshkrimin, Hasan. Shumica e asamblesë komunale mendon ndryshe. Qështje tjetër është po të refuzoja të nënshkruaj rendin e ditës duke kërkuar të heqim një pikë prej rendit të ditës, është e paarsyeshme dhe e ndihshme.
**Hasan Përboqi** – këtu nuk ka vendosë shumica, votat ishin 14 – 14, kryesuesi kur të del kundër vetes është interesant si në këtë rast, vota juaj vendosi. Keni pasë mundësi mos ta shfrytëzoni votën, të kërkoni konsultim si me pozitë si me opozitë, si të veprojmë se kemi mbetë të bllokuar në situatë të palakmueshme. Më pengoi që vota juaj vendosi në këtë rast, faleminderit.
**Kryesuesi** – Qështja e votimit tim është shumë personale, por bazohet në legjislacionin në fuqi dhe nuk mundem të të jap llogari ty, faleminderit.
**Edona Kryeziu** – Përshëndetje për të gjithë që janë ne përcjellje të kësaj seance, pa dashur ta zgjasë shumë sepse bashkëbisedimet na shyjnë kohën, keqkuptimet me njëri tjetrin besoj që në kuvend nuk zgjidhen, ftojeni njëri tjetrin për kafe dhe gjejeni zgjidhjen e duhur. Sa i perketë vazhdimit të seancës, duket të keni konsideratë pak sepse të gjithë punojmë nëpër sektorë private, nganjëherë është e pamundur me qenë të lirë, po mendoj edhe jam për vazhdimin e seancës pavarësisht qe kemi keqkuptime, faleminderit.
**Samir Mustafa** – Përshëndetje për të gjithë, duke debatuar këtu jemi gati pesë orë, si kryesues i kuvendit ftoji shefat e grupeve, luaje rolin e unitetit dhe vazhdojmë tutje.

**Kryesuesi** – Përshëndetje edhe njëherë anëtarë të kuvendit komunal, i nderuar kryetar, nënkryetar, drejtorë të drejtorive, po vazhdojmë me seancë.
E kemi një propozim nga shefja e grupit të aleancës për kthim në rend dite të pikës "Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për bartjen e mjeteve vetanake nga viti 2021 në 2022" po e vendosi në votim !
Kush është PËR? Atëherë me 25 vota për, aprovohet shtimi i një pike të rendit të ditës, d.m.th kjo është pika e 17 e rendit të ditës, me propozimin tim do të vazhdojmë ditën e enjte. Unanimisht vendoset që seanca të mbetet e hapur dhe të vazhdojmë të enjten prej orës 10. Shfrytëzoj rastin për urim të Bajramit si dhe përfundimin e muajit të shenjtë te Ramazanit, deri në javën tjetër mirëmbetshi.
Vazhdimi i seancës së datës 29.04.2022 e cila është mbajtur me 05.05.2022 me fillim në ora **10:00**. Mbledhjen e kryesoi: Kryesuesi i Kuvendit z. Defrim Kafexhiu. Konstatojm se kuorum, për mbajtjen e mbledhjes ka pasur:
**Kryesuesi** – Fillimisht më lejoni t'iu përshëndes, i nderuar nënkryetar i Komunës z. Fatmir Iska, të nderuar kuvendarë, drejtorë të drejtorive komunale, përfaqësues te OJQ-ve, përfaqësues të mediave, qytetarë të Komunës së Rahovecit dhe gjithë ju të pranishëm! Ky seancë është vazhdim i seancës së datës 29.04.2022. Po ju njoftojë edhe një herë me pikat e rendit të ditës i cili i ka gjithsej 17 pika:

**Rend Dite**

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar**
2. **Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;**
3. **Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Rahovec (QKMF);**
4. **Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt Planit Komunal për Integritet 2022-2026;**
5. **Shqyrtimi i Raportit financiar janar – mars 2022;**
6. **Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për formimin e komisionit për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve, rrugicave, parqeve, shesheve, lagjeve në komunën e Rahovecit;**
7. **Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve, rrugicave, parqeve, shesheve, lagjeve, në komunën e Rahovecit;**
8. **Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave Komunale për bujqësi;**
9. **Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P- 00054-0, 00265-0, 00498-0, 02909-0, 03015-0, 03016-0, 00251-0;**
10. **Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale për blegtori;**
11. **Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P- 02302-0 dhe P-00250-0;**
12. **Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shpalljen me interesi të përgjithshëm publik parcelën P-71510033-00527-1 në Zonën Kadastrale Xërxë;**
13. **Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shpalljen me interesi të përgjithshëm publik parcelën P-71510033-00527-2 në Zonën Kadastrale Xërxë;**
14. **Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për vazhdimin e kontratës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës;**
15. **Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për themelimin e Komitetit Konsultativ për Arsim në Komunën e Rahovecit;**

16. **Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim vendimit për themelimin e Komitetit Konsultativ për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në Komunën e Rahovecit.**
17. **Shqyrtimi dhe miratimi propozim vendimit për bartjen e mjeteve vetanake nga viti 2021 në vitin 2022;**

**Kryesuesi** – Pikën e parë e kemi aprovuar, kemi mbetur tek pyetja e dytë, por fillimisht fjalën e ka kërkuar z. Feriz Thaqi si përfaqësues i OVL-UÇK, i cili do na njoftoj për një ngjarje e cila do të ndodhë gjatë kësaj jave në Komunën e Rahovecit.
**Feriz Thaqi** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, tani në këtë moment jam duke folur në emër të organizatave të dala nga lufta, sot është data 5 majë dita e dëshmorëve të kombit, është ditë e cila përkujton të rënët e të gjitha luftërave për lirinë e kombit, kjo datë është një datë shumë e rëndësishme për shqiptarët pasi në këtë datë kujtohen dhe nderohen të gjithë ata që dhanë jetën për lirinë e atdheut. Bota e qytetëruar shoqëritë e rritura përmes vlerave ku janë themeluar parimet themelore për ecurinë e brezave mes tjerash kanë mësuar kombin të kthejnë rregullisht kokën mbrapa që të shohë rrugën e përshkruar, të di sa nga vjen, të kujtojnë dhe të respektojnë historinë e të parëve dhe të mësojnë nga ajo rrugë se ku do të shkojë. Është kjo arsyeja që pothuajse të gjitha shtetet dhe kombet e kanë një ditë në vit që i përkujtojnë të rënët dhe dëshmorët në betejat për atdheun e tyre. Me 24 prill të vitit 2000 pas shumë përpjekjeve u miratua ligji për statusin e dëshmorit të atdheut në të cilën përfshihen të gjithë dëshmorët e periudhave historike dhe të rënët në luftën e UÇK-së. Kjo datë përkon edhe me fillimin e javës së dëshmorëve të komunë së Rahovecit e cila fillon sot dhe përfundon me 12.05.2022, mirënjohje dhe respekt të pafund për të gjitha ato djem dhe vajza që me gjakun e tyre vunë themelet e këtij shteti, nuk mjafton të përulemi përpara sakrificës së tyre, ata dhënë për këtë vend për një Kosovë dhe për një Shqipëri më të mirë dhe nuk ka mënyrë më të mirë dhe më të denjë për ti respektuar dëshmorët në këto ditë dhe çdo ditë sepse për të punuar fortë për të bërë realitet atdheun që ata e ëndërruan, lavdi dëshmorëve të kombit. Të nderuar kisha kërkuar nga ju që të ngritëni në këmbë dhe të mbajmë 1 minutë heshtje për të gjithë të rënët për lirinë e atdheut, Lavdi.
**Kryesuesi** – Ju faleminderit i nderuari z. Feriz Thaqi për këto fjalë të mirë që i the për nderim të gjithë dëshmorëve të kombit. Vazhdojmë aty ku kemi mbetur tek pika e dytë e rendit të ditës.
**Ilir Pallqa** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, pyetja ime shkon për Drejtorin për Shpëtim z. Kujtim Dina, i nderuari drejtor po ju bëjë thirrje që të i mbroni të drejtat e zjarrfikësve, e di që i keni kompetencat e kufizuara, por të paktën rregullimi i objektit ku ata funksionojnë është nën kompetencat komunale. Gjendja në atë objekt është e mjerueshme, drejtori e dinë sepse e ka zyrën në atë objekt, poashtu edhe kryetari e dinë sepse është duke shkuar gjatë festave që ti vizitojë, mos marrja e masave për intervenim në atë objekt tregon se vizitat që është duke i bërë kryetari i komunës festë pas feste nuk janë asgjë tjetër veçojë fasadë politike, kurse ata në atë objekt nuk kanë as fasadë bazike, ju kisha lutë që të merrni masa.
**Burim Krasniqi** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, fillimisht të gjithë veteranëve, familjareve të dëshmorëve urime dita e dëshmorëve sepse dëshmorët kanë vetëm ditëlindje dhe dite feste e nuk kanë ditë morti ose ditë vdekje sepse ata e kanë dhënë jetën për liri. Çështja e bujqve në komunën e Rahovecit është bërë temë në të gjitha mediumet lokale dhe ato nacionale, nuk mundem të kuptoj lojën e cila bëhet në kurriz të bujkut, nëse themi se jemi për bujqësinë dhe për bujqit duhet të jemi me të vërtet, e them këtë sepse ka më pak se një muaj drejtoria për inspektoriat e ka pasur një aksion në fshatin Xërxe ku ka ardhur deri tek konfiskimi i mallit, bujkut Sadri Morinës ju është konfiskuar malli. Prandaj ne duhet të kemi mirësjellje ndaj bujqve, ata ndoshta janë duke shitur në vendet jo të duhura, por ne gjithmonë jemi duke proklamuar se jemi në krizë. Nuk është mirë të i thuhet bujkut largohu nga këtu por është mirë të i gjendet një zgjidhje, pra ti jepet një opsion pra nëse është në pronë publike ekziston rregullore komunale për dhënie në shfrytëzim të pronës publike, pra duhet të njoftohet bujku që ka të drejtë të bëjë kërkesë për shfrytëzim të hapësirës publike paguan disa tarifa dhe e merë në shfrytëzim. Që nga paslufta nuk e di që ndonjë bujku ju është konfiskuar malli, por ka ndodhur para një muaji në fshatin Xërxe, ne kemi me qindra e mijëra objekte pa leje, është mirë të i bëhet zgjidhje, të i ofrohet mundësia e jo të i konfiskohet malli dhe

është diskriminim që dikujt të i konfiskohet malli e dikujt jo. Ajo që është më e keqe se në zhvillimet e fundit nacionale lista Guxo asnjë parti politike nuk e ka dëmtuar më shumë se LDK-në, kryetari i Junikut i cili vije nga LDK-ja, ka shkuar dhe e ka takuar ministrin z. Peci, që ti bëhet zgjidhje bujqve të Junikut, pse kryetari jonë nuk shkon ta takojë ministrin e bujqësisë, drejtësisë dhe odën e noterëve ti thotë zotëri ministër çështja e noterisë është problem për komunën e Rahovecit, ti thuhet është një vendim sillna një vendim për 1 muaj që ti kryejmë shërbimet bujqve, nëse doni edhe sallën e asamblesë komunal ju lirojmë, nuk luhet me bujqit të nderuar dhe të dilet në mediume të thuhet se qeverisja qendrore po i bënë keq dhe ne mirë. I bëjë apel kryetarit të komunës që mos të bëjë lojëra politike me bujqit e komunës së Rahovecit, kur është nevoja shkojmë cep enë cep të Kosovës me nevojë e pa nevojë duhet edhe tani të shkojmë ta takojmë ministrin.

**Sinan Kryeziu** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, dua të flasë sa i përket investimeve që janë bërë nga komuna e Rahovecit me theks të veçantë në fshatin Xërxe, në seancën e fundit të datës 29.04.2022, e që realisht është vazhdimësi kjo seanca e sodit. Kam propozuar që të shtyhet pika e dytë bartja e mjeteve financiare për një mbledhje të radhës, jam munduar në formon time ta arsyetoj pse duhet të shtyhet kjo pikë, por fatkeqësisht drejtori i ekonomisë i cili është edhe vendasi imë z. Erhan Morina, e ka bërë një shkrim në faqen e tije zyrtare dhe pastaj ja dërgon portaleve të fshatit Xërxë ku u mundua që ti jep informacion sa i përket rrjedhave të seancës, në vend që të jep informata të sakta ai ka bërë dezinformomë, do mundohem ta citojë atë se çka ka thanë: Është fatkeqësi e faktit se asamblistët e fshatit nuk e kanë mbështetur vendimin për bartje të mjeteve ku në veçanti është destinuar buxheti për shkollën fillore dhe çerdhe të fëmijëve në Xërxe, për shkollë janë destinuar 60,000.00 € kurse për çerdhe 13,000.00 €, e thotë se është fatkeqësi fakti se asamblistët tanë për poenë politikë votojnë kundër interesave të fshatit dhe komunitetit. I nderuari drejtor unë nuk kam votuar kundër poashtu ju garantoj se nëse nuk votoj për diçka të mirë për komunën tonë nuk votoj as për keçë. Dua të flasë për fshatin tim disa fjalë dhe të ju njoftoj sa i përket investimeve që janë bërë në fshatin Xërxe, di të them se fshati Xërxe ofron një ambient të mirë për jetesë pa dallim dhe për arsye të pozitës gjeografike që e ka është vend me perspektiv në biznes. Fshati Xërxe është taksapaguesi më i madhe në komunë pas qytetit, duke u nisur nga kjo konsideroj se është bërë shumë pak në fshatin tim nga ana e ekzekutivit, këtë e arsyetoj si në vijim, që nga paslufta dhe deri më tani në fshatin time si investime më të madha që janë bërë rrjeti i kanalizimit ku pe nënvizojë se 50 % e buxhetit është mbledhur nga vetë qytetarët, janë shtruar rrugët me kubëza ku poashtu participues kanë qenë qytetarët e fshatit Xërxë. Në qeverisjen e kaluar është bërë ndriçimi publik i rrugëve kryesore të fshatit vlera e investimit rreth 80,000.00 €, mos të i hy në hak kryetarit dhe qeverisjes së tij në vitin e kaluar ka filluar implementimin projektit të ndërtimit të çerdhes për fëmijët e fshatit por fatkeqësisht ende nuk është realizuar poashtu arsyen nuk e dimë pse. Fshati Xërxë funksionon me këshillin e fshatit dhe kryetarin e sajë dhe kanë legjitimitet të plotë sepse zgjidhen drejt nga banorët e këtij fshati dhe ata mirën drejtpërdrejtë me problemet dhe nevojat e këtij fshati, ku kërkesat e tyre pastaj i shndërrojnë në prioritete ku pastaj i dërgojnë me shkresë zyrtare Komunës së Rahovecit. Këtë e argumentoj me kërkesën e fundit që ju është bërë me datë 27.07.2021, ku në parashtresë janë 14 pika ose kërkesa, këtë e them që ta dinë drejtori Morina, njëra nga pikët është që banorët kërkojnë që të bëhen rrethojat e fshatit ku kanë kërkuar përsëri që të jenë ata participues të 50% të shumës, por fatkeqësisht me datën 03.08.2021, drejtoria e shërbimeve publike merë një vendim ku thuhet kështu: Aprovohet pjesërisht kërkesa e z. Murat Kryeziut nga fshati Xërxë.......... dhe në arsyetim ceket kështu: Pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe daljes në teren, komuna e Rahovecit kërkesën tuaj e aprovon pjesërisht, të nderuar nëse dëshironi të përdorni gjuhë institucionale administrative juridike, kur parashtrohet një kërkesë zyrtare nga komuniteti nëse aprovoni pjesërisht duhet të ceket se cilën pikë e ke aprovuar dhe pse e ke aprovuar dhe cilën pikë e ke refuzuar dhe pse e ke refuzuar. Kërkojmë që të bëhen investime në mënyrë të drejtë dhe proporcionale në të gjithë komunën tonë, duke u nisur nga qyteti dhe fshatrat e komunës sonë.

**Kryesuesi** – Jam duke parë disa mimika që më janë duke u bërë nga kuvendarët, të nderuar unë jam udhëheqësi i seancës, z. Sinani e shfrytëzoi edhe minutat e shefit të grupit, më vije keq por shefi i grupit të

VV-së nuk ka më hapësirë. Nëse ka nevojë mu shpreh njëri nga kuvendarët atëherë unë do ja lejojë sikurse Sinanit poashtu edhe të tjerëve që dëshirojnë të shprehin ndonjë shqetësim.

**Afrim Berisha** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, nuk dua të kundërshtoj shumë shefin e grupit të LDK-së, por aq sa kam informata unë edhe kryetari poashtu edhe drejtori i bujqësisë kanë qenë në ministrinë e bujqësisë dhe kanë kërkuar që të kontaktojnë me ministrin Peci. Nuk e di se si mundet të thotë një shef i grupit që le të shkojnë ta takojnë, i nderuar këta kanë shkuar ta takojnë dhe poashtu mbajnë kontakte me ministrinë e bujqësisë, mua më vije shumë keq për situatën e krijuar kur të gjithë e dimë që në komunën tonë ka 2 vite që nuk kemi noter, por problemi nuk është në komunë por tek qeverisja qendrore.

**Bejtullah Deliu** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, pyetje ime shkon për drejtoreshën e shëndetësisë, të gjithë e dimë që ka ekzistuar një sektor i fizioterapisë në QKMF, ky sektor ndoshta në mënyrë jo të duhur ishte shpallur dhe sa kemi informata është mbyllur. Por forma ose njoftimi i cili ju është bërë punonjësve të këtij sektori ka qenë ju i rregullt ose jo i mirë, pra ju është ndërprerë kontrata pa paralajmërim edhe pse ligjërisht së paku një muaj përpara njoftohet punonjësi, mendoj se kjo është një shembull shumë i keq për të punësuarit në komunën tonë nëse vazhdohet në këtë formë. Kurse sa i përket diskutimit të bërë për bujqësinë, në kohë pandemie është bërë një propagandë e madhe kishe se për interes të bujqve duhet të gjendet një formë për shitjen e produkteve të tyre, në pjesën e bërnjakes janë ndërtuar disa baraka nga drunjtë për shitjen e produkteve, por tani kush e ndalon komunën që të organizohet me bujqit sikurse gjatë pandemisë dhe të i ofrohen ato baraka për shfrytëzim dhe nëse mendohet që është larg atëherë pse mos të i gjendet ndonjë hapësirë tjetër.

**Vlora Vuçitërna** - Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha të diskutoj sa i përket konkurseve të shpallura në muajin shkurtë nga drejtoria e shëndetësisë. Ky konkurs është shpallur për dy pozita, ku është kërkuar një teknik i farmacisë dhe një infermier, që të dy këto kandidatë të pranuar për çudi janë nga fshati Ratkoc dhe që të dy janë të afërm me kryetarin e komunës. Tekniku i pranuar më herët ka qenë shofer i urgjencës në Ratkoc dhe për çudi shumë shpejtë bëhet infermier. Poashtu tani është shpallur e4dhe një konkurse po nga kjo drejtori për 12 vende pune, ku kërkohen 12 infermier dhe një teknik i farmacisë, pyetje ime është kështu, a dihen kandidatët të cilët do të pranohen në këtë konkurs ose ka shpresa edhe për profesionistët e tjerë shëndetësorë që të hynë në këto pozita por që nuk i takojnë partisë në pushtet. Poashtu pozita e teknikut të farmacisë, kandidati i cili do të pranohet ose dihet se kush do të pranohet a do të mbetet në pozitën e teknikut ose edhe ky person me një strategji më vonë do të kalojë në pozitën e farmacistit në fshatin Drenoc, pasi dihet që në këtë fshat shumë shpejtë farmacisti do të dele në pension. Kam edhe një propozim ose sugjerim për drejtorin e shëndetësisë, a ka mundësi që të sigurohet QKMF-së dhe AMF-ve ujë të distiluar në një sasi pak më të madhe ose ndonjë aparat i cili e distilon ujin, këtë e propozove në mënyrë që mos të detyrohen pacientët nga barnatorja e QKMF-së të shkojnë në barnatore private për tretje të një shurupi sa më të thjesht.

**Merisa Sharku** – Përshëndetje për të gjithë, para disa ditësh është mbajtur një takim publik me qytetarët e komunës sonë sa i përket ndërtimit të sheshit në qendër të qytetit, jam bërë pjesë e këtij konsultimi publik me një entuziazëm se me të vërtet do të behët një takim publik për një punë të mirë për atë pjesë të qytetit e cila është lënë aq shumë pas dore, ku kjo pjesë është qa e rëndësishme për qytetin e Rahovecit. Në takim u njoftuam që komuna ka fituar një grand nga MZHR-ja, në vlerën prej 75,000.00 €, kurse vlera totale e këtij projekti është 112,717.00 €, ku pjesa shtesë është participim nga Komuna e Rahovecit. Në këtë projekt parashihet ndërtimi i pllakave në qendër të qytetit , rregullimi i trotuareve, ndriçimi publik, vendosja e disa ulëseve, drunjtë dekorativ , trajtimi i asfaltit në qendër, rregullimi i rrethit, shirit për çiklizëm, lyerje dhe fasadim i objekteve banesore përreth sheshit, ky është citat i prezantuar nga prezantuesi i takimit. Pyetja ime është se a do të mjaftojnë këto mjete për të gjitha këto pika që i ceka. Pas këtij prezantimi në monitor na u shfaqen dy slajde amatoreske ku ishin shfaqur dy ide të propozuara, ku njëri ishte që të vazhdohet me rreth rrotullim kurse tjetri me ishuj, një projekt kaq i rëndësishëm dhe të tentohet që të kalohet ashtu kalimthi për mua është shumë shqetësuese. Në këtë takim kishte shumë pak të pranishëm , salla ishte pothuajse e zbrazët dhe shkak i kësaj mendoj se ishte organizimi i dobët i komunës, i kisha lutur që në këto takime ku

diskutohen çështjet e këtij lloji të mos trajtohet pa seriozitet. Këto lloje takime nuk bëhet vetëm me një njoftim në veb faqe të komunës sepse ko formë e njoftimit nuk sjellë qytetar, prandaj kishte me qenë mirë që të nderoni formën. Në pyetjen time drejtuar kryesuesit të këtij takimi se a do të ketë takime tjera për këtë projekt, përgjigja ishte jo sepse sipas tij nuk kemi kohë sepse afati ligjor është vetëm edhe 14 ditë, procedurat marrin kohë dhe është e pamundur. Pas insistimit se ky projekt nuk duhet të kalohet në këtë mënyrë të nesërmen u ftua edhe një takim me ekspertët të fushave përkatëse ku bëjë pjesë edhe unë, por papritur na dol në projektor projekti me të cilin është fituar grandi, ky projekt është punuar pa u konsultuar askush, mendoj se gjatë projektimit të këtij projekti ideor është dashur të konsultohen ekspertë dhe qytetar të cilët kishin me pas mundësi me dhënë kontribut. Ju kisha sugjeruar që të i jepen më shumë vëmendje projekteve të këtij niveli, është mundësi shumë e mirë që të kemi një projekt i bukur dhe funksional poashtu projekt i cili do ti jep një imazh të mirë qytetit të Rahovecit.

**Sejfullah Sejfullahu** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, Pyetje ime është se në kuadër të zgjerimit të rrugëve fushore dhe shtruarja e tyre me zhavorr, dua ta di se si janë mundësitë buxhetore që edhe në pjesën në mes dy pllakave përkujtimore në trekëndëshin Nagavc – Randobrav – Krushe e Madhe, të shtrohet sepse kjo rrugë frekuentohet në ditët përkujtimore. Pyetje tjetër është po e njëjta pyetje të cilën e ka parashtruar kolegu Lirigzon Kastrati, procka e cila ja fillon nga fshati Brestoc e deri në Krushe kur do të përfundoj sepse ka filluar të kundërmojë një erë shumë të keqe.

**Leonard Morina** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, shqetësimi imë është sa i përket cilësisë së arsimit në komunën tonë, drejtori i DKA-së i cili e ka për detyrë që të kujdeset për cilësinë në arsim e ai është duke u kujdesur për mos cilësi në arsim. Do ja fillojë me Malësin e Vogël, nxënësit e kësaj shkolle qe 4 muaj nuk mbajnë lëndën e fizikës, pra rreth 400 orë janë humbur në këtë lëndë, e njëjta situatë është edhe në shkollën fillore në fshatin Polluzhë ku qe 4 muaj nuk ka edukatore për parashkollor, për lëndën e edukatës qytetare qe 3 muaj, matematik qe 4 muaj, pra të gjitha këto janë orë të humbura. Por drejtori i DKA-së kujdeset se si i ka ra mirë fasada e çerdhes e jo cilësia e arsimit. I nderuari drejtor nëse nuk ke aftësi që të menaxhosh DKA-në mundesh të shkosh që ti mbash orët të cilët i ke në shkollën 12 maji në lëndën e fizikës, këto orë që 4 vite sillen sikurse topi i pimpongut dhe asnjëherë nuk hapë konkurse për lëndën e fizikës, por më e keqja e kësaj është se orët e fizikes i mbanë mësimdhënësi i cili e ka të kryer teknologjinë dhe të gjitha këto dëme që janë duke ju bërë nxënësve të cilët janë para studimeve është shumë e dëmshme për ta. Kemi mësimdhënës që jep mësim në gjuhën angleze kurse ka të kryer gjuhen gjermane, drejtori është në gjendje me i sakrifikua të gjithë ata nxënës vetëm që ti ruaj orët e tij në mënyrë që kur nesër të mos jetë drejtor të kthehet aty si mësimdhënës. Poashtu në Malësin e Vogël ku orët e matematikës i mbanë mësimdhënësi i cili është me teknologji, drejtor nëse i ke borxhe ti këtij mësimdhënësi mirë kishte me qenë që ti lashë në kurriz tëndin e jo me kurriz të nxënësve të malësisë ose të Ratkocit. Në këtë seancë i kam përmendur disa shkolla, kurse në seancën tjetër do ju japë informata për disa shkolla tjera. Paramendoni se çka ka ndodhur me konkursin ku janë kërkuar 3 edukatorë, publikohet lista e kandidateve të cilët kanë kaluar testin me shkrim, kurse në konkurse ceket që kandidati duhet të i ketë 59 pikë në mënyrë që të fitojë të drejtën për intervistë me gojë. Për çudi kandidatja e cila nuk e kalon testin me shkrim mbetet në listë të pritjes dhe e kalon testin me gojë, njësoj e kemi edhe një kandidate tjetër e cila është po në këtë listë. Por më keqja është se kemi kandidat të cilët nuk kanë ardhur në test me shkrim fare dhe dalin që janë në listë të pritjes,, janë duke u munduar që të imitojnë klanin Pronto që pa konkuru fare të i fusin njerëzit në punë, por si duket janë duke dështuar , ma shumë janë nëpër gjykata se sa në zyrat e DKA-së. I nderuari drejtor dua një përgjigje si ka mundësi që mësimdhënësit të cilët punësohen me kontrata të përkohshme si zëvendësim të i kalohet në kontrata të rregullta pa i përfillur procedurat e konkursit.

**Kryesuesi** – ju faleminderit të gjithëve për pyetjet e parashtruara, tani fjalën e ka nënkryetari i komunës i cili do ju përgjigjet disa nga pyetjet e parashtruara.

**Nënkryetari** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, do i përgjigjem pyetjes së z. Burim Krasniqit, kurse përgjigjet e tjera do i keni në mbledhjen e radhës. I nderuar e përmendet të apostrofuarin z. Sadri Moina, ka qenë tek ne në takim, ne ja kemi ofruar mundësit ligjore, të nderuar i sapo përmenduri është e vërtet që është

bujk sikurse unë që jam bujk, jam i regjistruar me certifikatë si bujk por në këtë rast që ju jeni duke e cekur personi është tregtar, disa nga këta tregtar shesin mallin në pronë publike kurse qiranë e paguajnë aty personit që është përball, nuk e di a je i njoftuar me këtë i nderuar, ne të gjitha këto i kemi diskutuar. Prandaj nuk është mirë që të përdoret Sadria në këtë rast si bujk sepse në këtë rast problematike është se ai është si tregtar. Kur të bëhet koha e shitjes së produkteve tona bujqësore atëherë në këtë pjesë është tregu në Xërxe besoj se e dinë sepse je nga ky fshat. Sa i përket kontakteve me ministrin e bujqësisë, të gjitha shkresat ekzistojnë që ne kemi kërkuar takim me ministrin e bujqësisë dhe asnjëri nuk është përgjigjur, ministri i bujqësisë vjen në Rahovec dhe asnjëherë nuk vjen ë në komunë, komuna është institucion dhe duhet respektuar pavarësisht kush e udhëheq, qytetarët e komunës sonë përveç zgjedhjeve lokale votojnë edhe në zgjedhje qendrore poashtu edhe ministri ka marr vota nga qytetarët e komunës sonë, prandaj ai e ka obligim ligjor që të takohet me ne sepse ne si person nuk na duhet fare që të takohemi, prandaj raporti komunë – ministri dhe anasjelltas duhet të jetë në rregull sepse jemi institucione. Prandaj ai duhet të pranojë kryetarin e komunës në takim sepse në fund të fundit ne diskutojmë për interesa të bujqve e jo për interesa private. Prandaj askush nuk ka nevojë ta luaj rolin e avokatit të ministrit të bujqësisë apo cilido ministër të kësaj qeverie sepse kryeministri dhe ministrat janë edhe të mitë sepse ata janë ligjërisht aty me votat e qytetarëve dhe ne duhet që ti respektojmë.

**Burim Krasniqi** – Jam i vetëdijshëm për rolin tim që e kamë në asamblenë komunale, nuk jam duke e luajtur rolin e avokatit të askujt dhe as të ministrit, por jam duke e luajtur rolin time si asamblistë, si do le të vlerësohet por këtë janë duke e vuajtur bujqit. Duhet të mësoni ta e respektoni rolin e asamblistit e jo në çdo mbledhje të thoni avokat, filozof etj.

**Nënkryetari** – Maksimum respekt për 31 kuvendar nga ana ime, është mandati i katërt i imë herë si kuvendar e herë si pjesë e ekzekutivit, asnjë kuvendar nuk e kamë ofenduar deri në ditën e sodit në këtë orë që jemi me datë 05.05.2022.

**Kryesuesi** – Ju faleminderit të gjithëve për diskutimin e zhvilluar, po e përmbyllim këtë pikë, vazhdojmë në pikën e radhës:

**3. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Rahovec (QKMF).**

**Elbonit Kryeziu, Drejtor i QKMF-së** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, më lejoni që para jush të prezantoj statutin unik të QKMF-së i cili është përpiluar nga Ministria e Shëndetësisë dhe më pastaj ju është dërguar kuvendeve komunale për miratim. Qëllimi i statutit është përcaktimi i institucioneve të kujdesit parësor shëndetësor dhe standardeve të organizimit, funksionimit, veprimtarisë, shërbimeve shëndetësore dhe kuadrit profesional për ofrimin ne shërbimit shëndetësor në kujdesin parësor shëndetësor si pjesë e sistemit unik shëndetësor në Republikën e Kosovës. Me statute rregullohen dispozitat e përgjithshme si emërtimi, selia, veprimtaria e QKMF-së, statusi juridik, përfaqësimi dhe prezantimi struktura e institucionit, udhëheqja dhe trupat e institucionit, zhvillimi i vazhdueshëm profesional, mbikëqyrja e QKMF-së, aktet e përgjithshme, pronësia, financimi, transparenca në punë, konfidenca profesionale dhe afariste. Pastaj organizimi sindikal, mbikëqyrja e brendshme, dispozitat kalimtare dhe përfundimtare lidhur me ushtrimin e veprimtarisë së kujdesit shëndetësor në QKMF. Organizimi i QKMF-së sipas këtij statuti të ri organizohet me këto njësi përbërëse, Departamenti i mjekësisë familjare i cili përbëhet si në vijim: Sektori i mjekësisë familjare, njësia e SISHIT, njësia e vaksinimit dhe imunizimit, sektori i shëndetit oral preventiv, sektori i kujdesit urgjent, sektori konsultativ dhe diagnostik, shërbimet konsultative, kabineti radiologjik dhe laboratori. Departamenti i administratës në QKMF përbëhet si në vijim: Zyra e personelit, zyra juridike, zyra për buxhet dhe financa, zyra e prokurimit, zyra për shërbime teknike dhe barnatorja qendrore që është njësi organizative e QKMF-së e cila themelohet dhe funksionon sipas ligjeve dhe akteve ligjore që e rregullojnë veprimtarinë farmaceutike. jeta e institucioneve shëndetësore sipas paragrafit 5 do të jetë objekti i revidimit periodik i cili do të ndërmerret nga kuvendi komunal Rahovec me pëlqim të ministrisë së shëndetësisë. Këshilli drejtues i QKMF-së do ti ketë 7 anëtar, ku bëjnë pjesë: Drejtori i QKMF-së, udhëheqësi i departamentit të mjekësisë familjare, kryeinfermieri i QKMF-së, udhëheqësi i departamentit të

administratës, koordinatori për ngritje të cilësisë dhe shërbimeve shëndetësore, përfaqësuesi i sindikatës në cilësinë e vëzhguesit,, një e dhënë tjetër që është risi në nivel vendi ajo është se do të ketë përfaqësues nga këshilli i pacienteve, ne jemi njëra nga dy komunat e para në Republikën e Kosovës që jemi duke krijuar këshillin e pacienteve. Jemi të hapur që të gjitha ndryshimet të cilat mendoni se janë të nevojshme të bëhen në këtë statut mundeni të i drejtoni në DSHMS, ku pastaj DSHMS-ja i dërgon në Ministri të Shëndetësisë për aprovim.

**Samir Mustafa** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, në material nuk e pashë askund që ky statut është dërguar në Ministrinë e Shëndetësisë për aprovim paraprak, sepse paraprakisht statuti duhet të merë aprovim nga Ministria e Shëndetësisë dhe vije në kuvend për miratim formalisht.

**Burim Krasniqi** – Nuk jam duke e diskutuar statutin në pjesën profesionale sepse nuk jam mjekë, por gjatë leximit më ka rënë të shohë shumë mangësi të cilat nuk e bëjnë ri rregullimin e tij, e tha edhe drejtori se në QKMF ku funksionon materniteti është e domosdoshme gjinekologu, inhatologu dhe pediatri. Të njëjtën gjë e thotë edhe udhëzimi administrativ se në QKMF-të ku funksionojnë maternitetet është e domosdoshme të jenë gjinekologu nenhatologu ose pediatri, kjo nënkupton që udhëzimi ta ka lënë mundësinë. I nderuar në momentin që ti e ke funksional duhet të shkruar që funksion njësia e maternitetit me këtë këtë, jo të jetë mundet por duhet. Edhe tek neni 7 ku ceket se specializant nga lëmit e tjera munden të vazhdojnë punën në KPSH, përsëri të njëjtën gjë e thotë edhe udhëzimi, pra të specifikohet se çfarë specialistë kemi dhe të lihet e drejta për të vazhduar punën. Tek mjeku familjar ceket që duhet të jetë i certifikuar për ofrimin e shërbimeve me ultrazë, nuk e di që oda e mjekëve e lëshon ndonjë certifikatë për shërbime të veçante me ultrazë, mjeku familjar ultrazërin e mëson nga studimet e kryera ose specializim. Tek neni 9 i statutit janë shërbimet që duhet të listohen, jo të jenë mundet por të thuhet funksionon ky dhe ky shërbim, pra të listohen cilat shërbime. Këshilli drejtues, udhëheqësit e departamentit të administratës, nuk e di që ka departament të administratës QKMF-ja, pra në këshillin drejtues duhet të jetë udhëheqësi i departamentit i cili nuk ekziston, mendoj se ko është lëshim që duhet përmirësuar, përfaqësuesi i sindikatës e ceket së është në cilësinë e vëzhguesit, nëse është në cilësinë e vëzhguesit atëherë këshilli drejtues nuk i ka 7 anëtar por i ka 6 sepse vëzhguesi nuk voton. Neni 13 pika 4 QKMF-të që kanë një personal mbi 100 të punësuar kanë deh zëvendësdrejtorin, nuk ka nevojë të ceket në statut sepse ceket në udhëzim. Në projekt statut nuk potencohet se sa është mandati i drejtorit dhe zëvendësdrejtorit, nuk potencohet se cilat janë detyrat që duhet të i kryej zëvendësdrejtori, pra ka mangësi të llojit të vetë. Tek çështja e zhvillimit profesional avancimi i vazhdueshëm me qenë proporcional për të gjithë mjekët që luajnë rolin e vetë qoftë mjekë ose infermier. Ju jeni thurur në një strategji SSSH 2017/2021, tani jemi në vitin 2022, pse duhet të ketë zyre të prokurimit QKMF-ja, ose është bërë sa për të punësuar dike, sa ka investime QKMF-ja në Rahovec, pse duhet të ketë një zyrtar të prokurimit kur këto munden të kryhen përmes zyrës së prokurimit që ekziston në komunë të Rahovecit. Në fund potencohet që duhet të mirët pëlqimi i Ministrisë së Shëndetësisë, pra pas dhënies së pëlqimit nga Ministria e Shëndetësisë pastaj bëhet aprovimi nga kuvendi komunal, në fund të shkresës së këtij statuti nuk jam duke parë që Ministria e Shëndetësisë ka kthyer ndonjë përgjigje rreth këtij projekt statutit, pra ne nëse e votojmë sot bëjmë shkelje në hapa. Propozoj që kjo pikë të shtyhet për një seancë të radhës, të bëhen këto plotësime të vije përgjigje nga MSH dhe pastaj të vije në kuvend.

**Samir Mustafa** – Të nderuar ky statut është unik dhe e dërgon Qeveria e Republikës së Kosovës, konsultimi publik është mbajtur diku me 28 korrik 2021, por ky statut që ne sot e kemi nuk ka marrë pëlqimin e MSH, pasi të vije pëlqimi nga MSH pastaj në kuvend miratohet formalisht. Propozoj sponzorizuesin e kësaj pika që të tërheq këtë pikë të rendit të ditës sepse nëse e votojmë sot bëjmë shkelje procedurale.

**Nënkryetari** – Pajtohem me parafolësit në mënyrë që mos të krijojmë huti dhe shkelje ligjore me votim të këtij statuti, meqenëse me qarkore të vitit 2021 kërkohet edhe pëlqimi paraprak nga ministria, ndodhin këto gabime edhe ne jemi njerëz dhe jemi të gabueshëm, propozoj që kjo pikë të tërhiqet nga rendi i ditës.

**Kryesuesi** – Meqenëse ekzekutivi është propozues i kësaj pika, nënkryetari kërkoj që kjo pikë të hiqet nga rendi i ditës poashtu besoj se pajtohemi të gjithë me këtë propozim dhe me këtë po e përmbyllim diskutimin sa i përket kësaj pike. Kalojmë në pikën e radhës:
**4. Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt Planit Komunal për Integritet 2022-2026.**
**Arben Gashi** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, Plani për integritet 2022-2026 është një plan unik i cili na është dërguar të gjitha komunave të republikës së Kosovës nga MAPL-ja, ku si kërkesë është dalë nga raporti i komisionit evropian për hartimin e këtij plani. Kryetari i komunës pas pranimit të këtij plani ka themeluar grupin punues në përbërje prej 18 anëtarë, më pastaj ky plan ka dalë edhe në konsultim publik nga data 02.02.2022 deri me 04.03.2022, poashtu edhe konsultimi publik me qytetarë është mbajtur në sallën e kuvendit me 16.02.2022. Ky planë është një dokument strategjik dhe operativ i cili konsiderohet si një mjet i rëndësishëm për fuqizimin e integritetet institucional, ky planë kupton respektimin e vlerave morale, standardet profesionale dhe rregullat e zbatueshme të normativit. Qëllimi i këtij plani është ndërtimi i një administrate profesionale të modernizuar dhe të qëndrueshëm dhe ofrimin e shërbimeve sa më cilësore për të gjithë qytetarët. Ky planë është i harmonizuar me strategjinë kundër korrupsionit dhe planin e veprimit kundër korrupsionit, ky planë poashtu përbëhet nga dy elemente kryesore, elementi i parë është regjistrimi i rreziqeve të identifikuara dhe të vlerësuara për të gjitha fushat e funksionimit të një komune dhe elementi i dytë është përcaktimi i masave për përmasimin e integritetit i cili përshkruan në detaje të gjitha masat që duhet zbatuar për zvogëlimin e rreziqeve të integritetit si dhe afati kohorë përkatës dhe përgjegjësit organizativ për zbatimin e këtyre masave. Për më shumë nëse keni ndonjë pyetje jam këtu për të ju përgjigjur.
**Kryesuesi** – A keni ndonjë pyetje ose ndonjë vërejtje sa i përket këtij plani, nëse jo atëherë po e hedhë në votim Projekt Planit Komunal për Integritet 2022-2026: Konstatoj se me 29 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim është aprovuar pika e katërt e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:
5. **Shqyrtimi i Raportit financiar janar – mars 2022;**
**Afrim Limani** – Përshëndetej për të gjithë të pranishmit, ky raport përbehet prej dy pjesëve kryesore, pjesa e të hyrave dhe pjesa e shpenzimit të buxhetit. Në këtë raport nuk kanë qenë të përfshirë aktivitetet nga zyra e prokurimit sepse gjatë kësaj periudhe nuk ka pasur ndonjë aktivitet. Të hyrat në këtë periudhë tre mujore në total kanë qenë 255,331.00 €, nëse e bëjmë një krahasim me 3 mujorin e vitit të kaluar na dele që kemi një ndryshim negativ ose më pak në këtë vite në shumën prej 26,155.00 €. Poashtu edhe gjobat e gjykatave nuk janë të përfshira sepse pas përpilimit të raportit kanë ardhur gjobat e gjykatave, por në raportin 6 mujorë do të përfshihen. Sa i përket planifikimit dhe realizimit të tatimit në pronë është një ndryshim negativ prej 47,000.00 € kjo si pasojë e vendimit të qeverisë së republikës së Kosovës, që mos të kufizohen për të paguar tatimin në pronë në kohën kur e regjistrojnë makinat. Sa i përket shpenzimit të buxhetit sipas kategorive ekonomike në kuadër të programeve, përqindja e shpenzimit të buxhetit për këtë periudhë është 23.48 % ose në vlerën prej 3,565,554.04 €, pra ne sa i përket shpenzimit të buxhetit qëndrojmë mirë.
**Bejtullah Deliu** – I nderuari drejtor nëse ju kujtohet në seancën e parë gjatë prezantimit të plan programit për buxhet për vitin 2022, pata potencuar edhe atëherë që me vendimin e kryeministrit që heqja obligative për regjistrim të makinave dhe veprimtarive tjera për pagesën e taksave ose tatimit në pronë, ku kam ceku se komuna do të ketë vështirësi në inkasim të të hyrave. Poashtu me këtë disa qytetarë edhe ngarkohen sepse ata që nuk janë të saktë në pagesë kanë rritje në përqindja pra kamatë, nëse flasim sa i përket përvojës që kemi pasur unë si përgjegjësi i Post Telekomit, ku kemi bërë shpërndarjen e faturave për tatimin në pronë dhe vetëm në këtë fazë është një iniciativë e qytetarëve që të bëjnë pagesat por më vonë edhe ko iniciativë zbehet. Pyetja ime për ju është: a është menduar nga komunë ose nga ju ndonjë plan strategjik i cili jo vetëm që do të krijonte të hyrat në komunë, por poashtu edhe mos të dëmtohen qytetarët nga mos pagesa. Mbetem moralisht obligues që të ja japë një përgjigje Leonard Morinës, i nderuar nuk e di se sa je në dijeni por në OSHP mbi 1 vit nuk është duke funksionuar asnjë tender dhe kjo si pasojë e keq qeverisjes që e keni proklamuar se që 20 vite hajni. Prandaj e keni shansin që të tregoni veten në qendër dhe ju nuk jeni duke e treguar, në OSHP nëse ju kujtohet përgjigja e kryeministrit tonë e posaçërisht i juaji është që 2 zyrtarët që i

ka marrë në organin shqyrtues vetëm me telefon i ka thirr që të vinë, dallimi është vetëm pronto nuk i ka thënë, përgjigja e tije ka qenë keni me pa ju se këta janë më profesionistë se ata që kanë qenë deri tani.
**Afrim Limani** – I nderuari. Deliu keni bërë pyetje me vend, në momentin kur e ka nxjerrë kryeministri këtë vendim kemi marrë një rekomandim nga Ministria e Financave se tani e tutje obligimin për inkasim të të hyrave do ta kenë ata përmes Administratës Tatimore të Kosovës, jemi në proces dhe jemi duke pritur. Nëse ata nuk veprojnë ne jemi të detyruar që lëndët e qytetarëve të i dërgojmë tek përmbaruesi edhe pse kosto por borxhet në tatim në pronë janë shumë të mëdha mbi 1,200,000.00 €. Pres që edhe ju si kuvendar të jepni kontributin tuaj në këtë drejtim që qytetarët të bëjnë pagesat e tatimit në pronë.
**Leonard Morina** – Jam duke parë që tek taksat e legalizimit të objekteve janë planifikuar rreth 38,500.00 € kurse janë realizuar rreth 1,793.00 €, njëjtë kemi edhe në bujqësi ku si totalë i keni planifikuar rreth 1,350,000.00 €, kurse realizimi është bërë rreth 255,000.00 €, pra një vlerë shumë e ulet. I nderuari drejtor tek zyra e kryetarit janë rreth 41,554.86 €, pyetja ime është a ka mundësi të ndahen mëditjet nga paga apo duhet të shkojnë bashkë, kishte me qenë mirë të dihet se sa janë mëditjet dhe sa janë pagat.
**Afrim Limani** – Në bazë të analizave tona si Drejtori e Financave në këtë tre mujorin e parë të vitit 2022 në raport me planifikimin trendi është duke shkuar mirë, shpresoj dhe besoj se në fund të vitit do të arrihet përqindja e planifikuar, i nderuar ky është 3 mujori i parë dhe realizimi është për 3 mujorin e parë. Sa i përket taksës së ulët për legalizim, të ju them të drejtën nuk ka pasur edhe pse ne e kemi bërë një planifikim të mirë, por qytetarët nuk janë duke ardhur të bëjnë legalizimin e pronës. I nderuar në kuadër të zyrës së kryetarit janë edhe disa sektorë tjera e jo vetëm stafi i kryetarit, janë zyra ligjore, sektori i auditimit të brendshëm, zyra e prokurimit dhe zyra e personelit.
**Burim Krasniqi** – I nderuari drejtor gjobat nga gjykata dhe gjobat nga trafiku janë zero, nuk e di a j vinë më vonë apo si qëndron puna, tek të hyrat e tatimit në pronë po e citoj: Numri i objekteve të reja është 90, numri i faturave të shpërndara është 15109 fatura, që do të thotë se 1189 fatura janë më shumë se sa objektet e reja, kjo nënkupton se këto tjera janë objekte pa leje që janë ndërtuar në periudhën 3 mujore në komunën Rahovecit. E ka shpreh një shqetësim kuvendari z. Sinan Kryeziu sa i përket çështjes së avokatit, keni thënë se është vetëm 20.00 € një ankesë por i nderuari drejtor në raport po del që shërbimet përfaqësimit dhe avokaturës për 3 mujorin e parët ë vitit 2022 vetëm zyra e kryetarit ka paguar 6,033.00 €. Tek shpenzimet e vendimeve të gjykatave e kemi tek zyra e kryetarit dhe administrata 2,436.00 €,, pra përveç që e kemi paguar avokatin ne kemi paguar edhe shumë tjera të shpenzimit të gjykatave, por sa është gjoba që e ka pësuar komuna nga këto nuk e di. Tek shërbimet publike kemi shërbimet e përfaqësimit dhe avokaturës 1,920.00 €, poashtu përsëri kemi edhe 17,984.00 € shpenzime dhe vendimet e gjykatave, pra avokati mjete është duke marr por edhe komuna po paguan gjoba. Drejtor nuk e di se kur i kanë tërhequr mjekët 80,000.00 € por në këtë raport nuk është duke figuruar, e di që i kanë marrë ato mjete përmes përmbaruesit, mirë kishte me qenë të ishin paraqitur në këtë raport, ka edhe disa gjëra tjera por nuk dua ta zgjasë më shumë, vetëm desha ta rikujtoj drejtor që na ke premtuar që në muajin shkurtë do na vije një raport mbi borxhet dhe obligimet që i ka komuna e Rahovecit, por deri më sot ky raport nuk na ka ardhur, kërkoj nga ti që të na vije ky raport sepse kur të vije rishikimi i buxhetit kjo informatë shumë do na kishte ndihmuar.
**Afrim Limani** – Sa i përket të hyrave nga gjobat e gjykatave dhe gjobat e trafikut e dhashë në fillim sqarimin pas dorëzimit të raporti për tek ju, mua më ka ardhur raporti i gjobave të gjykatave dhe të trafikut, pra raporti ka ardhur me vonesë, por kjo do të figurojë në raportin 6 mujorë. Sa përket tatimit në pronë numri 90 është numri i objekteve të reja që i kemi regjistruar, kurse verifikimi i objekteve në raport me vitin e kaluar ka qenë i mirë pra vitin e kaluar ka qenë 136, kurse tani është 717. Sa i përket shpenzimeve të avokaturës, ne tani kemi një operator, kurse sa i përket shpenzimeve të gjykatave janë lëndë përmbarimore, kryesisht për investime kapitale, ka pasur operator që e ka dërguar lëndën tek thesari ose përmbaruesi dhe janë krijuar këto shpenzime. Sa i përket asaj që e kam premtuar po ju them se sinqeritetin e kam dhe kam me pas në maksimum për ju, kam premtuar se kur të bëhet publikimi i raportit vjetor në veb faqe të komunës do të jetë i korrigjuar sepse ka pasur disa gabime teknike ku ju më keni kërkuar që ti përmirësoj,

për këtë ju falënderoj. Kam premtuar që në atë raport do të jenë të gjitha obligimet kontraktuale dhe financiare të komunës.

**Kryesuesi** – Të nderuar kuvendar/e, tani po e bëjmë një pausë deri në orën 13:30, pastaj kthehemi dhe e vazhdojmë seancën me pikat e mbetura të rendit të ditës. T; nderuar/a kalojmë në pikën e radhës:

**6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për formimin e komisionit për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve, rrugicave, parqeve, shesheve, lagjeve në komunën e Rahovecit.**

**Albnor Mullabazi** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, në mbështetje të ligjit për vetëqeverisje lokale, ligjit për sistemimin e adresave dhe statutit të komunës, para jush keni propozim vendimin e kryetarit të komunës për formimin e komisionit për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve, rrugicave, parqeve, shesheve, lagjeve në komunën e Rahovecit. Ky komision do të përbëhet nga 5 anëtar, 3 anëtar do të jenë nga kuvendi dhe 2 anëtar nga ekzekutivi.

**Kryesuesi** – Të nderuar tani do të vazhdojmë me propozimet nga grupet e kuvendarëve, do të veprojmë ashtu siç e kemi bërë praktik pas çdo propozimi do të hedhim në votim edhe emrin e propozuar.

**Besmire Bytyqi** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, ne si grupe i AAK-së propozojmë arkitektin Arbër Zenuni, konsideroj se do ti shërbej përvoja e tije këtij komisioni.

**Kryesuesi** – E vendos në votim propozimin e grupit të AAK-së, me 18 vota për dhe 10 abstenime është votuar Arbër Zenuni që të jetë anëtar i këtij komisioni. Vazhdojmë me propozimin e grupit të VV-së.

**Leonard Morina** – Ne si grupe i VV-së propozojmë z. Ilir Pallqa.

**Kryesuesi** – E qes n ë votim emrin e Ilir Pallqes, 9 vota për, 12 vota kundër dhe 5 abstenime, emri i propozuar nga VV-ka nuk kalon. Kalojmë tek propozimi i LDK-së.

**Lirigzon Kastrati** – Përshëndetje për të gjithë, ne si grupe i LDK-së propozojmë z. Eqrem Saphiu.

**Kryesuesi** – E qesim në votim emrin e propozuar nga LDK-ja, me 20 pro dhe 7 abstenime është votuar emrin grupit të LDK-së. Kalojmë tek propozimi i PDK-së.

**Bejtullah Deliu** – Ne si grupe i PDK-së, propozojmë z. Armir Vuçitërna.

**Kryesuesi** – E qes në votim emrin e propozuar nga PDK-ja, me 23 vota për dhe 5 abstenime është votuar emri i propozuar nga PDK-ja. Pra Arber Zenuni, Eqrem Spahiu dhe Armir Vuçitërna janë anëtar të këtij komisioni të votuar nga ky kuvend, anëtarët e tjerë do të emërohen nga ekzekutivi. Teni po e vendosi për miratim pikën e rendit të ditës me këto 3 emra të propozuar: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e 6 e rendit të ditës Kalojmë në pikën e radhës:

**7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve, rrugicave, parqeve, shesheve, lagjeve, në komunën e Rahovecit.**

**Albnor Mullabazi** – Në mbështetje të ligjit për vetëqeverisje lokale, ligjit për sistemimin e adresave dhe statutit të komunës, para jush keni propozimin e kryetarit të komunës për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve, rrugicave, parqeve, shesheve, lagjeve, në komunën e Rahovecit. Edhe ky komision do të përbëhet njëjtë sikurse komisioni që e patëm më parë 3 nga kuvendi dhe 2 nga ekzekutivi.

**Kryesuesi** – Të nderuar vazhdojmë edhe për këtë komision njëjtë sikurse për komisionin që e patëm më parë, po ja fillojmë me grupin e AAK-së:

Besmire Bytyqi – Ne si grupe i AAK-së propozojmë znj. Shukrije Himaj.

**Kryesuesi** – E qes n ë votim propozimin e grupit të AAK-së, me 13 vota për, 3 kundër dhe 10 abstenime, është votuar propozimi i AAK-së. Kalojmë tek grupi i VV-së.

**Leonard Morina** - Ne si grup i VV-së propozojmë z. Ilir Pallqa.

**Kryesuesi** – E qesim në votim propozimin e VV-së, 13 vota për, 1 kundër dhe 8 abstenime është votuar propozimi i VV-së. Kalojmë tek propozimi i LDK-së.

**Lirigzon Kastrati** – Ne si grupe i LDK-së propozojmë juristen Edona Kryeziu.

**Kryesuesi** – E qes në votim propozimin e LDK-së, me 18 vota për, 1 kundër dhe 5 abstenime është votuar propozimi i LDK-së. Pra emrat e anëtarëve të këtij komisioni janë: Shukrije Himaj, Ilir Pallqa, Edona

Kryeziu, tani i qes në votim pikën e 6 të rendit të ditës: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e 7 e rendit të ditës, kalojmë tek pika e 8:

**8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave Komunale për bujqësi.**

**Afrim Oruçi –** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, para jush keni propozimin vendimin sipas ligjit dhe akteve të tjera nënligjore për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të parcelave komunale për 15 vite, këtu bëhet fjalë për 7 parcela të cilët janë në një vendim të përbashkët, këtu kemi të bëjmë për parcelën P-00054-0 në Hoçë të Madhe, në sipërfaqe prej 2 ari e 56 $m^2$. Poashtu parcelën 265-0, gjithashtu edhe kjo në Hoçë të Madhe në sipërfaqe prej 8 ari e 55 $m^2$, të gjitha këto prona janë prona komunale, pastaj P- -00498-0 në zonën kadastrale Xërxe në sipërfaqe të përgjithshme 4487 $m^2$, pronë e komunës së Rahovecit. Parcela - 02909-0, në zënën kadastrale Rahovec,, me një sipërfaqe të përgjithshme prej 4510 $m^2$, pronë e komunës. Parcela - 03015-0 në zënën kadastrale Rahovec në sipërfaqe të përgjithshme prej 290$m^2$, pronë e komunës. Pastaj Parcela - 03016-0 në zënën kadastrale Rahovec, në sipërfaqe të përgjithshme prej 650$m^2$ poashtu pronë e komunës. Parcela 00251-0 në zënën kadastrale Çifllak, në sipërfaqe të përgjithshme prej 114230$m^2$, në shfrytëzim jepet vetëm pjesa e parcelës në sipërfaqe prej 100000$m^2$, pronë e komunës. propozojmë para jush që të merret një vendim që të jepen të gjitha këto prona me qira në bazë të ligjeve dhe akteve të tjera në fuqi për periudhë prej 15 viteve. Të gjitha këto parcela destinimi e kanë të njëjtë bujqësinë, këto parcela do të jepen përmes ankandit publik. Ftojë anëtarët e kuvendit që të votojnë propozim vendimin të cilin ju prezantova.

**Burim Krasniqi –** Kërkoj që tek pika 1 të kate një plotësim, aty ku ceket për dhënie të pronës në shfrytëzim të shtohet edhe fjalia për bujqësi, në mënyrë që të kemi të qartë që jemi duke votuar pronat që jepen për bujqësi.

**Kryesuesi –** I nderuar besoj se ky propozim do të merret parasysh nga drejtoria përkatëse. Nëse nuk ka askush të shtoj diçka atëherë po e vendosi në votim pikën e 8 të rendit të ditës: Konstatoj se me 25 vota për asnjë kundër dhe 2 abstenime është votuar pika e 8 e rendit të ditës, kalojmë tek pika e radhës:

**9. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P- 00054-0, 00265-0, 00498-0, 02909-0, 03015-0, 03016-0, 00251-0.**

**Afrim Oruçi –** Të nderuar para jush e keni propozim vendimin për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P-00054-0, 00265-0, 00498-0, 02909-0, 03015-0, 03016-0, 00251-0. Pra ne sa herë që sjellim propozime për dhënie të pronës në shfrytëzim duhet të krijohet edhe këto komisione. Komisione sipas pikës 1 të këtij vendimi përbëhen prej 5 anëtarëve, 2 anëtar nga kuvendi, 2 anëtar i propozon ekzekutivi dhe një anëtar vije nga sektori joqeveritar.

**Kryesuesi –** Po fillojmë që të marrim emrat e anëtarëve të kuvendit, ftojë grupin e AAK-së që të propozoj emrin e anëtarit.

**Besmira Bytyqi –** Ne si grupe i AAK-së propozojmë z. Feriz Thaqi.

**Kryesuesi –** E qes në votim emrin e propozuar nga AAK-ja, konstatoj se 14 pro, asnjë kundër dhe 12 abstenime është votuar emri i propozuar nga AAK-ja. Fjalën e kanë grupi i VV-së.

**Leonard Morina –** Ne si grupe i VV-së propozojmë z. Sinan Kryeziu.

**Kryesuesi –** E qes në votim emrin e propozuar nga VV-ja, konstatoj se me 25 vota për, dhe 2 abstenime është votuar emir i propozuar nga VV-ja. Fjalën e kanë grupi i LDK-së.

**Lirigzon Kastrati –** Ne si grupe i LDK-së nuk kemi emër për këtë komision.

**Bejtullah Deliu –** Ne si grupe i PKD-së propozojmë znj. Melinda Iska.

**Kryesuesi –** E qes në votim emrin e propozuar nga radhët e PDK-së, me 25 vota për asnjë kundër dhe 2 abstenime është votuar emri i propozuar nga PDK-së. Anëtarët e këtij komisioni që janë votuar nga kuvendi janë Sinan Kryeziu dhe Melinda Iska, e qes në votim tani pikën 9 të rendit të ditës me këto 2 emra, kurse

emrat nga ekzekutivi dhe sektori joqeveritar do të vinë më vonë. Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e 9 e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

**10. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale për blegtori.**

**Afrim Oruçi** – Të nderuar anëtar të kuvendit para jush keni propozim vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës komunale për blegtori, kërkesa është në shfrytëzim të personave fizik dhe juridik dhe zhvillimin e procedurave për ankandin publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër prej 15 vite, pronat e cekur në pikën 1 të këtij propozim vendimi janë në zonën kadastrale Rahovec në vendin e quajtur Ravne Shume, me kulturë kulosë. Sipërfaqja e përgjithshme e kësaj parcele është 15000m$^2$, pronë e komunës. qëllimi i dhënien është blegtoria. Kurse parcela e dytë është në zonën kadastrale në Çifllak, me një sipërfaqe të përgjithshme prej 91939m$^2$, ne kërkojmë nga ju që të na mundësoni që nga kjo sipërfaqe të marrim në shfrytëzim 12000m$^2$, prona është e komunës së Rahovecit, qëllimi i dhënies edhe i kësaj prone është i njëjtë për blegtori. Ftoj anëtarët e kuvendit që ta përkrahin këtë propozim vendim në një afat prej 15 vite.

**Kryesuesi** – E qes në votim pikën e 10 të rendit të ditës, konstatoj se me 26 vota për asnjë kundër dhe 2 abstenime është votuar pika e 10 e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës.

**11. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P- 02302-0 dhe P-00250-0.**

**Afrim Oruçi** – Të nderuar kuvendar para jush e keni propozim vendimin për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës P- 02302-0 dhe P-00250-0. Edhe ky komision përbëhet nga 2 anëtar të kuvendit, 2 anëtar nga ekzekutivi dhe 1 anëtar nga sektori joqeveritar.

**Kryesuesi** – Të nderuar edhe ky propozim vendim ka të bëjë me formimin e komisionit, atëherë po ja fillojmë përsëri me propozimet e emrave, fillojmë me grupin e AAK-së.

**Besmire Bytyqi** – Propozojmë z. Feriz Thaqi.

**Kryesuesi** – E qes në votim propozimin e grupit të AAK-së, konstatoj se me 14 vota për, asnjë kundër dhe 12 abstenime është votuar propozimi i AAK-së. Ftojë grupin e VV-së që të propozoj një emër.

**Leonard Morina** – Ne si grupe i VV-së nuk kemi emër për këtë komision.

**Eqrem Spahiu** – Ne grupi i LDK-së propozojmë Lirigzon Kastratin.

Kryesuesi – E qes në votim emrin e propozuar nga LDK-ja, Konstatoj se me 18 vota për, asnjë kundër dhe 5 abstenime është votuar emri i propozuar nga LDK-ja. Forj PDK-në që ta jep një emër për këtë komision.

**Bejtullah Deliu** – Ne si grupe i PDK-së propozojmë Sejfullah Sejfullahun.

**Kryesuesi** – E qes në votim propozimin e PDK-së, konstatoj se 19 vota për asnjë kundër dhe 5 abstenime është votuar emri i propozuar nga PDK-ja. Pra të nderuar 2 emrat e votuar nga ana e kuvendit prë këtë komision janë Lirigzon Kastrati dhe Sejfullah Sejfullahu. E qes në votim pikën e 11 të rendit të ditës: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar pika e 11 e rendit të ditës.

**Merisa Sharku** – Të nderuar kam një pyetje rreth komisioneve, ju e thatë që 2 vinë nga kuvendit, 2 nga ekzekutivi dhe 1 nga organizatat joqeveritare, pyetje ime është kush e cakton këtë nga organizata joqeveritare. Ne gjithmonë e kemi ditur se kush janë anëtar të komisionit nga kuvendi kurse nga ekzekutivi dhe organizatës joqeveritare nuk e kemi ditur se kush janë.

**Afrim Oruçi** – Në praktikat e kaluara kur janë formuar këto komisione gjithmonë organizatat joqeveritare njoftohen nga komuna, komuna e Rahovecit ka më shumë se 1 organizatë joqeveritare, pastaj ata delegojnë përfaqësuesit t tyre dhe ne si ekzekutiv kujdesemi që jo gjithmonë në komisione të jenë personat e njëjtë ose organizatat e njëjta, mundohemi që të jenë me rotacione, pastaj me vendim njoftohet edhe komisioni për emrin e personit të deleguar nga organizata, pra ata caktohen nga kryetari i komunës.

**12. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për shpalljen me interesi të përgjithshëm publik parcelën P-71510033-00527-1 në Zonën Kadastrale Xërxë.**

E ftojmë drejtorin përkatës për prezantimin e kësaj pike

**Afrim Oruqi** – Faleminderit kryesues, une jam drejtori përkatës, të nderuar anëtarë të kuvendit para jush kemi vendimin për shpalljen me interes të përgjithshëm publik të parcelës nr.527-1, bëhet fjalë për zonë kadastrale në Xerxë, me 11 ari e 43m katror, ne vendin e quajtur Luga, e evidentuar si pronësi shtetërore e Kosovës KK Rahovec-shfrytëzues NBI. Aktualisht me këtë parcelë menaxhon agjencioni kosovarë i privatizimit (AKP). Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik të kësaj parcele në pikën 1 të këtij vendimi është ndërtimi i një objekti-depo për magazinimin e produkteve bujqësore.
Drejtoria për kadastër dhe gjeodezi pas vendimit të kuvendit do të kujdeset që të vazhdoj procedura dhë të zbatoj dokumentacionin e nevojshëm për regjistrimin në librat kadastral. Ftoj anëtarët e kuvendit që të votojnë propozim vendimin për shpalljen me interes të përgjithshëm të kësaj parcele.Faleminderit.
**Kryesuesi** – Faleminderit drejtor, diskutimi është i hapur për ketë qështje, Burim Krasniqi e ka fjalën.
**Burim Krasniqi** – Meqenëse është në Xërxe, tash po shprehi pak lokalizëm, pika 2 e kufizon mundësinë e qfarëdo aktiviteti tjetër përpos depos për magazinimin e produkteve bujqësore. A ekziston orientimi se kujt do ti jepet në shfrytëzim? Apo është vetëm vullnet i komunës, nëse është kjo e fundit, unë kërkoj që pika nr.2 të hiqet, të shpallet vetëm interes të përgjithshëm, nuk jam për tjetërsim por nuk kam deshirë qe kjo t'i takoj një individi, kërkoj mirekuptimin e asamblesë komunale të kaloj, por pa pikën 2, të shpallet në interes të pergjithshëm, për natyrën se për çka jepet në shfrytëzim, mund të vertetohet gjatë procedurave tenderuese, shikohen ofertat cila e ka destinimin më të mirë, çka ofron kjo zonë edhe qartësohen punët.
**Sinan Kryeziu** – Faleminderit kryesues, jam në të njëjtën linjë me Burim Krasniqin, për shkak se edhe une jam nga fshati Xërxë. E kemi një model të keq aty te Elkosi, është favorizuar një oligark për grumbullimin e pemëve dhe perimeve dhe qe nuk mirret hiç me bujqit aty dhe për këtë arsye edhe unë jam kundër këtij fenomeni, dhe jam pro heqjes së paragrafit aty ku është "depo për grumbullimin e pemëve dhe perimeve". Faleminderit shumë.
**Afrim Oruqi** – Faleminderit kryesus, në pyetjen e kuvendarëve Burim Krasniqi dhe Sinanit, mas paku kemi të drejtë të lëshojmë prona me qera që menaxhohen nga AKP, nuk ka kërkesë konkrete prej askujt dhe ne nuk kemi të drejtë t'ia japim askujt këtë pronë me qera. E tëra që po bëjmë është që po kalojmë në një rrugë që parashihet me ligj, fillimisht po i shpallim me interes të përgjithshëm për arsye që është nën menaxhim të AKP-së. Qëllimin duhet ta kemi të precizuar patjetër, pas vendimit të kuvendit po përgatitemi ta dërgojmë te bordi i AKP-së e më pas në qeverinë e Kosovës të na e kthej pronësinë. Qëllimi na duhet patjetër duke u bazuar në praktikat e mëhershme, në mandatin e kaluar në AKP ne kemi procedu kërkesa për disa parcela, pa qëllim. Përgjigja e tyre ishe refuzuese, me rekomandim që duhet të tregojmë arsyen se për qfarë na duhet, shkollë, depo etj...Pra duhet patjetër qëllimi, qoftë edhe i modifikuar, pa qëllim nuk ka përgjigje pozitive nga bordi i AKP-së dhe nga qeveria e Kosovës.
**Sinan Kryeziu** – Meqë drejtori i arsyetoj procedurat ligjore, ne si grup i VV-së jemi Pro.
**Kryesuesi** – Nëse nuk ka ndojnë gjë tjetër rreth këtij diskutimi, atëherë po e vendosim në votim!
Kush ëshë PËR? Me shumicë votash aprovohet pika e 12 e rendit të ditës, kalojmë te pika e 13-të:
**13. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shpalljen me interesi të përgjithshëm publik parcelën P-71510033-00527-2 në Zonën Kadastrale –Xërxë.**
**Afrim Oruqi** – Faleminderit kryesues, këtu bëhet fjalë për parcelën që është pronë shtetërore e Kosovës, nën menaxhim të AKP-së, është në kufi me parcelën që biseduam më herët, këto dy parcela janë përballë M-Sillosit, sipërfaqja e kësaj parcele është 5 ari e 3 metra katror, e gjatë e ngushtë. Prej komunitetit aty është shfrytëzuar si rrugë, kurse me kadastër nuk është rrugë. Këtu kemi pas telashe pronësore prej njerëzve që kanë pasur pretendime për blerje prej agjencioneve në fjalë në mënyrë të padrejtë, ne kemi ndërhy dhe kërkojmë prej juve për shpallje në interes të përgjithshëm.
**Kryesuesi** – Nëse nuk kemi ndonjë diskutim, atëherë po e vendisim në votim pikën e 13-të të rendit të ditës, shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për shpalljen me interesi të përgjithshëm publik parcelën në fjalë, kush është PËR? Me shumicë votash aprovohet edhe pika e 13-të e rendit të ditës, para se të kalojmë në pikën tjetër, pauzojmë 5 minuta ...

**14. shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për vazhdimin e kontratës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës;**

**Mirsad Shala –** Faleminderit kryesues, i nderuar nënkryetar, drejtorë, asambleistë. Komuna e Rahovecit, respektivisht përfaqësuesi i ministrisë së zhvillimit të shkencës dhe kulturës në Rahovec (e ashtu quajtur në atë kohë) Esat Haxhijaha, e ka dhënë në shfrytëzim pronën e paluajtshme të komunës në sipërfaqe prej 500m në katror, organizatës "Shulfer helfenen liben" e që është Qendra Rinore në Rahovec. Këtë pronë drejtori i drejtorisë e ka dhënë për shfrytëzim me kontratë prej datës 01.01.2001 - 31.12.2021, duke u bazuar në ligjin dhe rregulloren për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, pas përfundimit të afatit të dhënies së pronës në shfrytëzim (neni 28), kuvendi mund të vazhdojë afatin e shfrytëzimit në bazë të performancës: përmbushja e kontratës, vlera e investimit, përputhshmëria me planet hapësinore etj...Pika 2 e këtij neni thotë; se pas vlerësimit të performancës, bazuar në raportin e kryetarit të komunës, kuvendi i komunës merr vendim për vazhdimin apo mosvazhdimin e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të komunës për një periudhë tjetër kohore të njejtë. Prandaj kuvendi i komunës në mbledhjen e kaluar ka marrë vendim, për themelimin e komisionit për vlerësimin e performancës së kësaj kontrate, ky komision në tri takimet e mbajtura ka qenë ne vend të ngjarjes te organizata SHL Kosova dhe ka marrë të gjitha informacionet e nevojshme për vazhdimin e kësaj kontrate, andaj duke u bazuar në ketë ligj dhe në këtë rregullore, ju ftoj që të vazhdojmë kontratën e dhënies në shfrytëzim për këtë pronë për SHL Kosova, e cila është organizatë që mirret ekskluzivisht me organizime rinore në komunën e Rahovecit, faleminderit.

**Besë Bytyqi –** faleminderit shumë, falënderoj gjithashtu Mirsadin si anëtar i komisionit dhe të gjithë të tjerët për punën e tyre. Ka mbi 20 vite që SHL Kosova ndikon jashtëzakonisht shumë në përmirësimin e jetës së të rinjëve, në ngritjen e mirëqenies së jetës kulturore dhe edukativo-arsimore në Rahovec.

Konsideroj që vendimi më i mirë i yni do të ishte ky, pra vazhdimi i shfrytëzimit të pronës për SHL Kosova, sepse jemi deshmitarë që puna e tyre është jashtëzakonisht e nevojshme për të rinjët e të rejat ne komunën tonë, që gjithmonë kanë deshirë te mësojnë gjera shtesë jashtë mësimit formal, ju ftoj kolegë asambleistë të votojnë pro. Faleminderit.

**Bejtullah Deliu –** Në këtë pikë desha të ndalem te vitet e cekura, për 20 vitet e ardhshme. Jam i mendimit që për këto aktivitete rinore janë të mjaftueshme 5-10 vite dhe të rishqyrtohet vazhdimisht. Në ketë rast ndoshta për 20 vite ky aktivitet mund edhe të pasivizohet, e në anën tjetër kur janë më pak vite edhe menaxhmenti stimulohet për aktivizim më shumë. Ky është arsyetimi im personal, nëse e shihni të arsyeshme edhe e votojmë kështu si është, por pjesë fillestare e kësaj qendre jam edhe vet dhe e di shumë mirë qfarë intenziteti të punës është bërë, me kalimin e kohës nuk është që kanë dal fjalë të mira, ndërkohë është aktivizuar sado pak, prap e përsëris për dy dekada për këso lloje aktivitetesh nuk është e arsyeshme, por nëse vitet e shfrytëzimit janë më pak besoj qe do të ishte bërë punë më shumë.

**Kryesuesi –** Faleminderit Bejtullah, zyra ligjore ka një replikë.

**Isak Hoti –** Faleminderit kryesues, delegatë, drejtora. Bejtë, ligji i ri na jep mundësinë për vazhdimin e kontratave vetëm për ato kontrata afatgjate kjo d.m.th që ne nuk kemi të drejtë që kontratën afatgjate, ta bëjmë afatshkurtë sepse atëherë nuk konsiderohet si vazhdim kontrate, por duhet filluar procedurën prej pikës zero. Që mos te hyjmë në procedurë në ketë rast për Qendrën Rinore dhe të mbesim pa të, sepse del ndokush edhe mund ta fitoj kontratën. Sipas ligjit formë tjetër nuk kemi, nuk guxojmë t'i zbresim vitet në kontratë (neni 23 i ligjit dhe neni 28 i rregullores).

**Bejtullah Deliu -** deshta të bashkangjitem në argumentimin e Isakut, unë po flasë nga përvoja aty, nuk u bazova në bazë të ligjit, personalisht mendoj që për 20 vite për këtë lloj aktiviteti, mendoj që është një akomodim për menaxhmentin e tyre sepse çdo 5 vite aktiviteti i tyre kish me qenë më i duhur dhe më i mirë, pa keqkuptime. Nëse me ligj nuk lejohet më pak, atëherë nuk kemi pse diskutojmë.

**Kryesuesi –** Faleminderit Bejtullah, ndonjë pyetje rreth kësaj qeshtjeje? Nëse jo, atëherë po vazhdojm me pikën e 14-të të rendit të ditës, e vendosim në votim! Kush është PËR?...Atëherë unanimisht miratohet pika e 14-të e rendit të ditës shqyrtimi dhe miratimi i vendimit për vazhdimin e kontratës për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës. kalojmë në pikën e radhës të e rendit të ditës,

**15. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim – vendimit për themelimin e dy komiteteve:**
**Kryesuesi** - Ka qenë propozim në KPF. Eshtë bërë një lëshim në përpilimin e vendimit sepse propozimin ishte ndryshe, e ftoj zyrtarin ligjorë të na informojë më shumë për qështje të formimit të komiteteve joobligative apo komiteteve tjera siç përcaktohet në bazë të udhëzimeve administrative.
**Isak Hoti** – Faleminderit kryesues, përshëndetje kryetar. Ndonjëherë edhe drejtorave ju them duhet të dini qka doni, qe ne të dijmë qka të bëjmë. Në këtë rast ne nuk e kemi ditë qfarë keni dashtë edhe skemi ditë qfarë të bëjmë. Sot e marrim një propozim, qfarë dëshironi? Më pas e kemi lehtë ta përgatisim vendimin, kemi afat kohorë 7 ditë.
**Kryesuesi** – Isak, t'u kisha lutë për korrektësi, ju nuk keni marrë pjesë në mbledhjen e KPF-së, është dashur ta lexoni procesverbalin, aty specifikohet kërkesa apo propozimi i një anëtari të komitetit d.m.th këtu dihet çfarë po kërkojmë!
**Isak Hoti** – I kemi dy udhëzime administrative, udhëzimi administrativ 05-2020 për procedurën e themelimit për bërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë.
Udhëzimi tjetër administrativ për procedurën e themelimit të komitevete konsultative në komunë, ju e dëshironi konsultativ apo obligativ?
**Kryesuesi** – Fjalën e ka propozuesi i kësaj pike në mbledhjen e KPF-së, Burm Krasniqi.
**Burim Krasniqi** – I nderuar kryesues, unë në KPF, jam munduar të jem i qartë dhe besojë në mbledhjen tjetër të KPF-së vjen transkripti i diskutimit, aty kam propozuar themelimin e dy komiteteve jo obligative që rregullohen me udhëzim administrativ 05-2020.
**Kryesuesi** – Faleminderit Burim, një pyetje nga unë për zyrtarin ligjor, a është mundësia që sot të procedojmë për themelimin e këtyre komiteteve, apo janë procedurat që duhet ta bëjmë në seancën tjetër.
**Isak Hoti** – Faleminderit kryesues, në asnjërin udhëzim nuk po e shoh "komitete jo obligative", këtu thotë "komitete tjera", sepse ju jeni thirrur në udhëzimin administrativ 05-2020 për procedurën e themelimit dhe për bërjen e kompetencave të komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera të komunës. Nëse është ky udhëzim, ky përbehet ndryshe. Nëse dëshironi ekspert të fushës atëherë bëhet me udhëzim administrativ të 2016-tës që shkon nëpërmjet konkursit të hapur. Ketë nuk përcaktohet qartë, nëse thua komitete jo obligative, nuk përputhet me udhëzim administrativ. Komitet jo obligativ nuk ka, nuk ekziston, thuhet "komitet tjetër" në komitete tjera keni të drejtë ti bëni në bazë të këtij udhëzimi administrativ, kjo i bie që ne nuk kemi gabuar kryesues, e as qe gabojmë sepse edhe tash është e paqartë se çka po kërkohet.
**Kryesuesi** – Isak, kam qenë prezent në mbledhjen e KPF-së dhe jam në dijeni se çka po kërkohet dhe çfarë forme. Në këtë rast a është mundësia të formohen dy komitete tjera në baze të nenit 14 të udhëzimit administrativ 05-2020.
**Isak Hoti** – Po kryesues, përderisa shkruan në udhëzim keni të drejtë. Është e drejtë e këtij kuvendi të themelojë edhe komitete të tjera. Nëse flasim për arsim, kisha pas deshirë me qenë ekspert të jashtëm me udhëzimin administrativ të 2016-tës, me konkurs dhe pjesë e atij konkursi në komision janë edhe kuvendarët.
**Kryesuesi** – Atëherë kërkoj nga zyra ligjore të filloj inicimin e procedurave për përpilimin e vendimit për themelimin e "komiteteve tjera" dy komiteteve; për shëndetësi dhe arsim. Atëherë meqenëse rendin e ditës e kemi të miratuar, si kryesues i kuvendit propozoj që këto dy pika, e 15-të dhe e 16-të e rendit të ditës, për themelimin e dy komiteteve tjera nga kuvendi i komunës, t'i shtyejmë për seancën tjetër, i vendosim të dyjat bashkë në votim!
**Besë Bytyqi** – Falenderoj zyrtarin ligjor për spjegimet. Personalisht mendoj që një komitet konsultativ do të duhet të përbëhej nga ekspert të fushave të shëndetësisë dhe arsimit, me persona qe nuk janë të ndikuar politikisht në asnjë lloj forme, në menyrë që të na ndihmojnë të gjithëve pa dallim.
Edhe një herë e falënderoj Isakun për shpjegimet, në përgatitjen e këtyre komiteteve ne duhet të dakordohemi që komiteti konsultativ të jetë me ekspert të fushave nga jashtë.
**Kryesuesi** – Propozimet e anëtarëve të komitetit për politik dhe financa barten në seancën e rregullt të kuvendit komunal, propozimi ishte i qartë për fillimin e procedurave për themelimin e dy komiteteve tjera të

bazuara në udhëzimin administrativ 05-2020, me përbërje nga kuvendi komunal, ky ka qenë propozimi, Burimi e ka fjalën dhe po e vendosim në votim!

**Burim Krasniqi** – Atëherë unë kërkoj kështu; me mundësi, sot ta vendosim në votim propozimin për themelimin e dy komiteteve të tjera që rregullohen me udhëzim administrativ 05-2020, për kohën dhe emrat vendosim në seancën tjetër, sot dakordohemi që në seancën tjetër t'i kemi propozim vendimet për komitetet sipas udhëzimit në fjalë.

**Kryesuesi** – Atëherë propozimin e Burim Krasniqit po e vendosim në votim, propozimi është për inicimin e procedurave për themelimin e dy komiteteve të tjera, njëri për shëndetësi tjetri për arsim sipas udhëzimit administrativ 05-2020 me përbërje nga kuvendi komunal. Kush është Për?...kundër?...abstenim?...Atëherë me shumicë votash aprovohet propozimi për inicimin e procedurave për themelimin e dy komiteteve tjera njëri për shëndetësi dhe tjetri për arsim. E lus zyrën ligjore që në seancën tjetër të rregullt vendimi të jetë gati. E vazhdojmë seancën pas pauzës...

**15. Shqyrtimi dhe miratimi propozim vendimit për bartjen e mjeteve vetanake nga viti 2021 në vitin 2022.**

**Afrim Limani** – Përshëndetje edhe një herë, të nderuar kuvendar/e paraprakisht ju kërkoj falje sepse jeni detyruar edhe një herë një pikë e cila ka kaluar në fakt para 2 muajve, arsyeja e vonesës është për shkak të mos barazimit të departamentit të buxhetit dhe thesarit. Arsyeja pse është rikthyer në kuvend ky vendim janë tre projektet kapitale të cilat ne i konsideru kapitale tani në fakte këto projekte janë në rezerve. Ke mi të bëjmë me projekte për intervenime emergjente në infrastrukturë, projekti furnizim me gypa PVC dhe projekti për hartime të projekteve të ndryshme. Për mua ende është e pakuptimtë pse këto 3 projekte kanë kaluar tek rezervat, por 3 këto projekte janë të lidhura në vitin 2021 dhe janë projekte në vazhdim dhe ne për këto 3 projekte kemi pasur detyrime financiare, prandaj ne i kemi futur në vendimin për bartje të mjeteve duke e ditur që kemi obligim financiar. Ne me këtë vendim jemi shumë me vonës dhe ne kemi presione nga operator etj. Prandaj kërkoj nga ju që të votoni këtë pikë të rendit të ditës sepse kemi të bëjmë me një shumë prej 592,276.00 €. Nëse nuk votohet kjo pikë e rendit të ditës, atëherë këto mjete mbesin të stagnuar deri në vitin 2023.

**Bejtullah Deliu** – Drejtor faleminderit nga ana juaj për sqarimin e dhënë pse është kthyer ky vendim në rishqyrtim, por propozimi që vije nga ju për bartje të mjeteve në disa pika të këtij vendimi mendoj se do të ishte më mirë nëse do të kishim ndonjë konsultim të përbashkët dhe nëse ulemi dhe bisedojmë pozitë opozitë, mendoj se do të gjejmë ndonjë konsensus që në disa pika të ndryshohet shuma e mjeteve. Nëse jeni të pajtimit që të bisedojmë sa i përket disa pikave atëherë unë jam pro, nëse jo mendoj se kështu si është kjo formë nuk është mirë të kalohet nga opozita.

**Burim Krasniqi** – Në seancën e fundit që e kemi pasur dhe sot është vazhdimësia e asaj seance, kemi kërkuar informata shtesë që të kemi arsyeshmërinë pse vendimi është kthyer nga MF, falënderoj drejtorinë financave i cili sot e ka sjellë arsyeshmërinë nga MF. Por ajo që është shqetësuese, joparimore është ajo që kërkohet konsensus ose mirëkuptim por në anën tjetër provohet të bëhet edhe shantazh. Shpesh herë thuhet në këtë foltore së unë jam filani, por po e them edhe unë që unë jam Burim Krasniqi, nuk jetoj nga politika por jetoj nga profesioni. Kur marrë qëndrime politike si LDK nuk ma ndien se cili drejtor shkon në Xërxe dhe bënë zhurmë, është dashur së pari të i thoni banorëve të fshatit Xërxe që i keni mashtruar sepse kodin buxhetor për shkollë në Xërxe e kemi planifiku me zero €, shkolla e Xërxe nuk ka projekt fare, nuk e dini as sa kushton projekti, nuk e dinë se kur do të ndërtohet. Nuk mundeni të dilni të proklamoni këso situata që ta dëmtoni Burimin politikisht, pastaj Burimi kur të kthehet do të trembet, duhet të dini se LDK-ja ka kandidat sa të doni, nëse unë dëmtohem vjen dikush tjetër. Dilni ditë e natë ftoni të gjitha mediat, shkoni derë me derë dhe thoni që Burimi po ju mashtron,, por ju duhet të tregoni që ju i keni mashtruar paraprakisht. Nëse bëhet një shkollë për 60,000.00 € atëherë unë ja kam jetën borxh dikujt, po ethëm edhe një herë kur marrë qëndrime politike nuk ma ndien për askënd dhe asgjë. Pajtohem me propozimin e z. Bajtullah që të ulemi dhe të i shikojmë kodet dhe pozicionet buxhetore.

**Kryetari** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë – Në disa raste duhet të ketë edhe konsensus nëse është i nevojshëm dhe në interes të qytetarëve, por konstruktiv së paku duhet të përpiqesh të jesh në vazhdimësi. E mirëkuptova Burimin është e vërtet që në përbërjen e kaluar të kuvendit ne vetëm e kemi hapur kodin për rregullimin e shkollës në Xërxë, aneksin e shkollës në Ratkoc dhe shkollën Bekim Sylka me shpresën që do të marrim ndonjë donacion ose do të jetë pjesë e buxhetit të kuvendit të Republikës së Kosovës. Në planin e bartjes së mjeteve në shkurt ne kemi vendosur që nga 60,000.00 € sepse kaq kanë qenë mundësitë financiare, poashtu jam dakord me Burimin që thotë me 60,000.00 € nuk bëhet shkolla por nëse nuk kemi kontratë në plan të prokurimit atëherë nuk mundemi të bëjmë asgjë, ne edhe për shkollën fillore në Fortesë nuk kemi pasur në fillim as 50,000.00 € por tani kjo shkollë është ndërtuar, prandaj edhe shkolla në Xërxe do të ndërtohet. Sot e kam marrë konfirmimin se jemi komuna e parë në grand për performances ku kemi fituar rreth 1,148,000.00 €, prandaj mundet edhe një pjesë e këtyre mjeteve të shfrytëzohet. Edhe një herë po ju ftojë që të mbështesni këtë propozim vendim, nëse jeni që të bisedojmë atëherë pajtohem por mirë kishte me qenë që kjo pikë të kalojë sot. Ftojë shefat e grupeve nëse kanë ndonjë propozim konkret atëherë mundemi të bisedojmë, por duhet të dini se nuk kemi mundësi të bëjmë lëvizje të mëdha.
**Leonard Morina** – Ekzekutivi gjithmonë ju ka drejtuar opozitës se ju nuk keni përvojë e ne kemi përvojë, tani këtu po del që pozita përvojë ka por jo të mirë, nga afro 600,000.00 € , shuma prej 120,000.00 € është e destinuar gabimisht nëpër kode, kjo nuk është profesionalizëm dhe as përvojë. Ne si opozit mundemi të ju mbulojmë gabimet e juaja edhe me kompromise, pajtohem me propozimin e Bejtullahut që të shkojmë me një paus.
**Kryesuesi** – Pajtohem edhe unë me propozimin e Bejtullahut, por të kemi një pauzë më të shkurtër e jo prej 1 ore por gjysmë ore.
**Bejtullah Deliu** – Desha të ndërlidhëm me kolegun nga radhët e grupit të AAK-së, kërkesa ime për një pauzë 1 orësh nuk ka qenë për ti rritur pazaret, nuk e di a isha i qartë për ju por unë kam thanë brenda kësaj kornize mjetet janë të pakta për aty ku ne mendojmë. Aty ku unë mendoj dhe dua të mbrojë pikën time është sporti, kërkesa ime është që në sporte të ritet shuma edhe një herë minimumi të jetë 100,000.00 €, dola këtu të ju tregoj sepse shprehja juaj shumë keq ka tingëlluar, qëllimi nuk është këtu i kurrfarë pazareve, qëllimi i vetëm është destinimi i duhur i mjeteve.
**Kryetari** – E kuptoj kërkesën e z. Bejtullah, poashtu edhe unë jam që të ritën subvencionet në sport por në këtë rast ne nuk mundemi, me rishikim të buxhetit besoj se po, kam kërkuar edhe unë që të ritet kjo kategori por nuk na është lejuar tani, por me rishikim po dhe në vitin tjetër mundet dhe ne do të risim subvencionet në përgjithësi.
**Bejtullah Deliu** – Kryetar unë për vete nuk kam dëshirë që të keqkuptohet ajo që kam kërkuar një pauzë për 1 ore, qëllimi imë ka qenë vetëm që ne të merremi vesh sa i përket këtij vendimi, nëse jo atëherë hidheni në votim dhe ne do të shprehim përmes votës mendimin tonë.
**Afrim Limani** – Desha të ja japë një përgjgije z. Bejtullah, i nderuar këtu kemi të bëjmë me një shumë prej 592,000.00 € për investime kapitale nga pjesa e tejkalimit të të hyrave vetanake, këto do të bartën në kuadër të projekteve kapitale. Prioritetet më së mirë i dinë drejtoria e financave sepse e dinë se ku janë borxhet dhe ju garantoj se ne e kemi bërë në mënyrën më të mirë dhe më të sinqertë, prioritet i kemi dhënë borxheve të vjetra. Obligime me këto barte nuk do të kemi deri në vitin 2017, prioritet i kemi dhënë disa projektet të pa buxhetuara si këto që diskutuam deri më tani shkolla në Xërxe, Ratkoc dhe Rahovec. Po ju japë edhe një informatë sa i përket hapjes së këtyre kodeve nga struktura e kaluar e kuvendit, ata kanë qenë në dijeni se në këtë kodë nuk ka mjete, por premtimi ka qenë qemë bartje të mjeteve ne kemi me buxhetu dhe ne e kemi mbajtur këtë premtim. I nderuari Leonard e pranoj që nuk jam më i miri, por unë ende nuk mundem të bindem pse janë duke na bërë këtë ministria sepse këto projekte rezerva janë projekte të viti 2022 dhe ne jemi duke vënë me bartje nga projektet e vitit 2021 me bartje të të hyrave vetanke sepse në vitin 2021 ka qenë një kod sepse ngjarja ka ndodhur në vitin 2021, por ne duhet të i respektojmë vendimet e ministrisë.

**Bejtullah Deliu** – I nderuari drejtor asnjëherë deri më tani nuk kam dyshuar në sqarimin që e jep,, poashtu nuk dua të hy në atë se sa je profesionist, por unë kam të drejtë të kërkoj diçka dhe unë kam kërkuar që brenda këtaj kornize nëse gjejmë hapësirë dhe mundësia që të ndihmohet sporti, nëse nuk ka mundësi ligjore atëherë do të marrim edhe opinione nga zyra ligjore a kemi të drejtë apo jo, unë vetëm kam kërkuar vetëm që të bisedohet sepse i përkas një subjekti politik që me vite është formuar me konstruktivitet. Të nderuar blanko votë ndoshta ka pasur më herët, por tash e tutje nuk do të ketë këtë ta keni të qartë.
**Kryesuesi** – Besoj se më së mirë kishte me qenë që të shkojmë me një pauzë prej 30 minuta, ku pastaj rikthehemi për të vazhduar seancën. Atëherë fillimisht po iu kërkojë falje për zgjatjen e kësaj pauze, por situata ishte e tillë që është dashur patjetër të zgjaste kaq shumë.
**Kryetari** – Përshëndetje edhe një herë kryesues, anëtarë të kuvendit, drejtorë të drejtorive, nënkryetar.
Biseduam me shefat e grupeve për këtë temë për të cilën jemi duke u perballë, që të arrijmë të bejmë punë të mira, duhet patjetër të kemi compromise. Me vëmendje e kam dëgjuar kërkesën e Bejtullah Deliut, kur ka thënë q ë duhet më shumë të investohet në sport, në të ardhmen duhet të rriten subvencionet dhe të kemi mbështjetje më të madhe në sport, ne disiplina të ndryshme sportive. Ne pas konsultimeve të përbashkëta, është e arsyeshme që nga kodi i investimeve kapitale, ndërtimi i aneksit të shkollës në Ratkoc që parashihen me ketë vendim 60.000eu, t'i hiqen 10.000eu (këtu mbesin 50.000) dhe 70.000eu bëhen për ndërtimin e shkollës fillore në Xërxë. Nga kodi për rrugë fushore për bujqësi nga 50.000eu që janë të parapara për rrugë fushore, poashtu kemi pranuar që edhe këtu të hiqen 10.000eu dhe të shtohen përseri te objekti i ri i shkollës fillore në Xërxë, nga 60.000eu sa ka kjo shkollë nga propozimi aktual, bëhen 80.000eu. Ndoshta ekziston deshira të bejmë levizje edhe në drejtime të tjera, meqenëse nuk kemi shumë problem me rrugë fushore, e objekti i ri në Xërxë parashihet për standarte të larta, mendojmë që është një start i mirë me 80.000eu. Aneksit të shkollës fillore në Ratkoc po i mbesin 50.000eu, sepse aty është vetëm aneks.
Aktualisht levizje tjera nuk kemi mundësi të bejmë, sepse të gjitha të tjerat janë obligime. Meqenëse këtu bëhet fjalë për investime kapitale dhe bëhet fjalë për mirëkuptim midis ekzekutivit dhe juve, dhe ju ftojë ta miratojmë vendimin për bartjen e të hyrave nga viti 2021 në 2022, me zotimin që do të ketë më shumë subvencione, por ju e dini që aktualisht subvencione për këtë vit kemi vetëm 361.000eu. Ekziston mundësia reali që t'i rrisim subvencionet, jam konsultuar edhe me Afrimin sepse është e quditshme se si psh; Obiliqi ka 1.000.000eu subvencione e ne i kemi vetëm 361.000eu. Ne me rishikim të buxhetit dhe ndihmen e kuvendit duhët ta bejmë të mundshme dhe jam i bindur që do të ketë rritjet të subvencioneve për vitin e ardhshëm. Ju ftojë per konsensues në kuvend, t'a hedhim këtë pikë në kuvend dhe t'a votojmë, vlerësojeni vet sit ë doni por me ketë pozicione kemi arritë të ndahemi me nder të dy palët.
Pas konsultimeve me më shumë se gjysmë ore, me Burimin, Leonardin, Bejtullahin dhe Besmiren po mendoj qe ka ardhë koha për dakordim.
**Bejtullah Deliu** – Faleminderit zotëri kryesues, pak e stërzgjatëm këtë pauzë që unë e kërkova, por besoj që jemi brenda kornnizave që kam kërkuar edhe pse jo kënaqshëm, po pasi qe nuk kemi zgjidhje ligjore për ndryshim, kërkova nga ju që të zotoheni këtu në rishikim të buxhetit që kërkesat tona të hasin në mirëkuptim, dhe rishikimi i buxhetit të bohet me opozitë, komuna është edhe e pozitës edhe opozitës, prandaj konsiderojë që ky të jetë një mësim i vogël për një të ardhme që mos të hasim në kësi pozicione, por për hirë të qytetarëve, për hirë të bizneseve që paratë e tyra janë stagnu dhe presin me muaj të tërë për pagesa për punën që është bërë. E kemi ndëgju shpesh fjalë borgj, borgj, borgj, disi ka ardhë ky borgj, ndoshta vëllimi dhe rritja enorme e punës para fushatës ka bërë që të jetë ky efekt. Prandaj është mirë të mendohet paraprakisht çka punohet. Në rishikim të buxhetit ju lus që me shefat e grupeve të opozitës të ulemi dhe në secilën pike t'i kemi kërkesat tona. E dijmë që ekzekutiv jeni ju dhe i keni gjërat në dorë por, së paku të respektohet edhe vullneti i këtyre votuesve të opozitës sepse nëse i mbledhim faktikisht del më shumë se 50% si opozitë, e kam fjalën për raundin e parë të zgjedhjeve. Prandaj për hire të biznevese është ky mirëkuptim i opozitës që duhet të ju përkrahim në këtë pikë, të kalojë kjo pikë, përndryshe ndoshta nuk është me meritë forma apo qasja se si kemi ardhë në ketë pikë të votimit. Me kaq po e përmbylli dhe urojë që këto fjalë të kryetarit të gjejnë bazë në praktikë duke na ftuar për kontribut të gjithëve. Faleminderit.

**Sinan Kryeziu** – Faleminderit kryesues, për shkak se une kam sponzorizu që kjo pike të shtyhet për seancën e radhës, detyrohem që fillimisht për hire të qytetarëve, ne grupi i VV-së do të votojmë pro, për arsye se kryetari së paku reflektoi pozitivisht në ndërrimin e destinacioneve ku edhe bëri rritje për shkollën e fshatit Xërxe.
**Burim Krasniqi** – Faleminderit kryesues, e kam vetëm një kërkesë, mos të vijmë në situatë të tillë te buxheti i vitit të ardhshëm sepse mund të detyrohemi të votojmë kundër, do të kemi paraprakisht dakordim të përbashkët, me mirëkuptim do të ecim tutje, faleminderit.
**Kryetari** – Besoj qe e dini qe komiteti për politikë dhe fincanca (KPF) bën dëgjime buxhetore, unë besoj që asgjë nuk do të shkoj keq. Realisht procesin e buxhetimit ose hartimit të buxhetit e udhëheq një në far mënyre KPF, i kanë qarkoret buxhetore, merr pjesë drejtori për politikë dhe financa etj...Unë besoj që problemi po krijohet më pas, se nuk ekziston procesi i rishikimit të buxhetit pa dakordim, e sa për dijeni rishikimi nuk varet prej neve por prej ministrisë së financave. Ideja është që unë asnjëherë nuk e kam patur problem ti takoj shefat e grupeve, por kerkoj pak më shumë transparencë, pasi edhe jemi komuna më transparente në Kosovë. Faleminderit shumë për qëndrimin dhe konstruktivitetin tuaj dhe kompromise në interes publik.
**Kryesuesi** – Atëherë nesë askush nuk ka diqka për të shtuar, pikën për shqyrtimin dhe miratimin e propozim-vendimit për bartjen e mjeteve vetanake nga viti 2021 në vitin 2022, po e vendosim në votim!
Kush është Për? kundër? abstenim? Me 25 vota për, 3 kundër dhe 1 abstenim, miratohet shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për bartjen e mjeteve vetanake nga viti 2021 në vitin 2022, kështu më përfundimin e kësaj pike përfundon edhe seanca e sotshme e rregullt, deri në seancen e radhës, mirupafshim.

| **Procesmbajtësi:** | **K R Y E S U E S I** |
|---|---|
| **Agim Hoti** | **Defrim Kafexhiu** |

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria –Vlada-Government***

*Ministria e Financave*
*Ministarsvo za Finansije – Ministry of Finance*

---

# UDHËZIM ADMINISTRATIV MF - NR.04/2019 PËR DEFINIMIN E PROJEKTEVE KAPITALE DHE KLASIFIKIMIN E SHPENZIMEVE TË PROJEKTEVE KAPITALE

# ADMINISTRATIVE INSTRUCTION MoF - NR. 04/2019 ON DEFINITION OF CAPITAL PROJECTS AND CLASSIFICATION OF CAPITAL PROJECTS EXPENDITURES

# ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO MF - BR. 04/2019 O DEFINICIJI KAPITALNIH PROJEKATA I KLASIFIKACIJI TROŠKOVA KAPITALNIH PROJEKATA

| **Ministri i Ministrisë së Financave** | **Minister of Ministry of Finance** | **Ministar Ministarstva Finansija** |
|---|---|---|
| Në mbështetje të Nenit 80B të Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007 (Gazeta Zyrtare nr. 13/21 prill 2016)**,** të nenit 8 nën paragrafi 1.4 të Rregullores Nr.02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive si dhe nenit 38 paragrafit 6 të Rregullores së Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 (Gazeta Zyrtare nr.15, 12.09.2011), | Pursuant to Article 80B of Law no. 03/L-0048 on Management of Public Finance and Accountabilities, amended and supplemented by Law no. 03/L-221, Law no. 04/L-116, Law no. 04/L-194, Law no. 05/L-063 and Law no. 05/L-007 (Official Gazette No. 13/21 April 2016), Article 8 subparagraph 1.4 of Regulation No. 02/2011 on Areas of Responsibilities of the Office of Prime Minister and Ministries, pursuant to Article 38 paragraph 6 of Rules and Procedures of Government No. 09/2011 (Official gazette No.15, 12.09.2011), | U prilog člana 80B Zakona br. 03 / L-048 o upravljanju javnim finansijama i odgovornosti, dopunjen i izmenjen Zakonom br. 03 / L-221, Zakon br. 04 / L-116, sa Zakonom br. 04 / L-194, sa Zakonom br. 05 / L-063 i Zakonom br. 05 / L-007 (Službeni glasnik br.13/21 april 2016), člana 8 podstav 1.4 Uredbe br. 02/2011 o oblastima administrativne odgovornosti Kancelarije premijera i ministarstava i član 38 stava 6 Uredbe Pravilnika o radu Vlade br. 09/2011 (Službeni glasnik br.15, 12.09.2011), |
| **Nxjerrë:** | **Issues:** | **Idaje:** |
| **UDHËZIM ADMINISTRATIV MF - NR. 04/2019 PËR DEFINIMN E PROJEKTEVE KAPITALE DHE KLASIFIKIMIN E SHPENZIMEVE TË PROJEKTEVE KAPITALE** | **ADMINISTRATIVE INSTRUCTION MoF - NR. 04/2019 ON DEFINITION OF CAPITAL PROJECTS AND CLASSIFICATION OF CAPITAL PROJECTS EXPENDITURES** | **ADMINISTRATIVNO UPUTSTVO MF - BR. 04/2019 O DEFINICIJI KAPITALNIH PROJEKATA I KLASIFIKACIJI TROŠKOVA KAPITALNIH PROJEKATA** |
| **KAPITULLI I<br>DIPOZITAT E PËRGJITHSHME** | **CHAPTER I<br>GENERAL PROVISIONS** | **POGLAVLJE I<br>OPŠTE ODREDBE** |
| **Neni 1<br>Qëllimi** | **Article 1<br>Purpose** | **Član 1<br>Svrha** |
| Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim definimin e projekteve kapitale dhe klasifikimin e shpenzimeve të projekteve kapitale. | This Administrative Instruction aims definition of capital projects and classification of capital project expenditures. | Ovo Administrativno uputstvo ima za cilj definisanje kapitalnih projekata i klasifikaciju troškova kapitalnih projekata. |

| | | |
|---|---|---|
| **Neni 2**<br>**Fushëveprimi** | **Article 2**<br>**Scope** | **Član 2**<br>**Delokrug** |
| Dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ janë të obligueshme për të gjitha organizatat buxhetore dhe për të gjitha projektet kapitale, pavarësisht vlerës së projektit apo burimeve të financimit të projektit kapital. | Provisions of this Administrative instruction are mandatory to all budgetary organizations and to all capital projects, regardless of the value of the project or funding sources of capital project. | Odredbe ovog Administrativnog uputstva su obavezne za sve budžetske organizacije i za sve kapitalne projekte, bez obzira na vrednost projekta ili izvor finansiranja kapitalnog projekta. |
| **Neni 3**<br>**Përkufizimet** | **Article 3**<br>**Definitions** | **Član 3**<br>**Definicije** |
| 1. Shprehjet e përdorura në këtë udhëzim administrativ kanë këto kuptime: | 1. The expressions used in this Administrative Instruction have following meanings: | 1. Izrazi korišteni u ovom Administrativnom uputstvu imaju sledeća značenja: |
| 1.1. **Projekt Kapital** – një investim afatgjatë që përdoret për të ndërtuar, rritur ose përmirësuar asetet, sipas kritereve të përcaktuara në këtë Udhëzim Administrativ; | 1.1. **Capital Project** – A long-term investment used to construct, enhance or improve assets, according to the criteria stipulated in this Administrative Instruction; | 1.1. **Kapitalni projekt** – dugoročna investicija koja se koristi za izgradnju, rast ili poboljšanje imovine, u skladu sa kriterijumima navedenim u ovom Administrativnom uputstvu; |
| 1.2. **Shpenzim kapital i Projektit Kapital** – shpenzim që i atribuohet drejtpërdrejti sjelljes së një aseti në shërbim apo funksion, me mundësinë e përfshirjes këtu edhe shpenzimet që zakonisht do të klasifikoheshin si shpenzime rrjedhëse, por që trajtohen si shpenzime kapitale në përputhje me këtë Udhëzimin Administrativ; | 1.2. **Capital expenditure of capital project** – Expenditure that is directly attributable to bringing the asset into the service or function, with the possibility of including here even expenditures that would usually be classified as current expenditure, but which are addressed as capital expenditure pursuant to this Administrative Instruction; | 1.2. **Kapitalni rashodi kapitalnog projekta** – rashodi koji se mogu direktno pripisati donošenju imovine u usluzi ili funkciji, sa mogućnošću obuhvaćanja troškova koji bi se obično klasifikovali kao tekući troškovi, ali se tretiraju kao kapitalni izdaci u skladu sa ovim Administrativnim uputstvom; |
| 1.3. **Shpenzim Rrjedhës i Projektit Kapital –** shpenzim që lidhet me menaxhimin, riparimin, mirëmbajtjen apo aktivitetet minore të asetit, përfshirë këtu | 1.3. **Current expenditure of capital project –** Expenditure which is related to management, repair, maintenance or minor asset activities, including here even | 1.3. **Tekući troškovi kapitalnih projekata** – troškove koji se odnose na upravljanje, popravak, održavanje ili manje aktivnosti imovine, uključujući troškove nastale nakon |

| | | |
|---|---|---|
| shpenzimet që ndodhin pas përfundimit të projektit e që kanë të bëjnë me operimin dhe mirëmbajtjen e asetit, dhe përjashtuar shpenzimet që trajtohen si kapitale në përputhje me këtë Udhëzim Administrativ; | expenditure incurred after the completion of the project, which are related to the operation and maintenance of the asset, and excluding expenditure addressed as capitals pursuant to this Administrative Instruction; | završetka projekta, koji se odnose na rad i održavanje imovine, i isključujući troškove tretirane kao kapital u skladu sa ovim administrativnim uputstvom; |
| 1.4. **Aset** - një resurs me vlere ekonomike në pronësi të shtetit/organizatës buxhetore, që rrit vlerë e pasurisë dhe që pritet të ofroje përfitime në të ardhmen; dhe | 1.4. **Asset** - A resource of economic value owned by the state/budgetary organization, which increases the value of the asset and is expected to provide future economic benefits; and | 1.4. **Imovina** - resurs ekonomske vrednosti u vlasništvu države / budžetske organizacije, koji povećava vrednost imovine i za od koje očekuje da će osigurati buduće koristi; i |
| 1.5. **Kapitalizimi i asetit** - regjistrimi i asetit në Regjistrin e Pasurisë dhe Regjistrin Kontabël (Sistemi Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës) me vlerën e investuar, duke përjashtuar shpenzimet e palejuara). | 1.5. **Asset capitalization** – Registering of the asset on assets register and accountant register (Kosovo Finance Management Information System) with invested value, excluding unallowed expenditure). | 1.5. **Kapitalizacija imovine** - upis imovine u Registar imovine i Računovodstveni registar (Informacioni sistem za finansijsko upravljanje na Kosovu) po uloženoj vrednosti, isključujući nedozvoljene troškove. |
| 2. Të gjitha shprehjet tjera të përdorur në këtë Udhëzim Administrativ kanë kuptimin e njëjtë me termat e përdorur në Ligjin Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike, me plotësim ndryshimet e tij, dhe në Ligjin vjetor të Buxhetit. | 2. All other expressions used under this Administrative Instruction have same meaning with expressions used in Law No. 03/L-048 on Public Finance Management, with its amendments and supplements, as well as in Annual Law on Budget. | 2. Svi drugi izrazi koji se koriste u ovom Administrativnom uputstvu imaju isto značenje kao i pojmovi korišćeni u Zakonu br. 03 / L-048 o upravljanju javnim finansijama, sa njegovim izmenama i dopunama kao i u Zakonu o godišnjem budžetu. |

| | | |
|---|---|---|
| **KAPITULLI II<br>KRITERET DHE SHPENZIMET LIDHUR ME PROJEKTET KAPITALE** | **CHAPTER II<br>CRITERIA AND EXPENDITURE RELATED TO CAPITAL PROJECTS** | **POGLAVLJE II<br>KRITERIJI I RASHODI KOJI SE ODNOSE NA KAPITALNE PROJEKTE** |
| **Neni 4<br>Kriteret për  i projektet kapitale** | **Article 4<br>Meaning of capital projects** | **Član 4<br>Značenje kapitalnih projekta** |
| 1. Një projekt kapital ka këto karakteristika: | 1. Capital project has the following features: | 1. Kapitalni projekat ima ove karakteristike: |
| 1.1. Ndërlidhet me investimet që ndikojnë në zhvillimin e përgjithshëm shoqëror dhe ekonomik të vendit apo/dhe arritjen e objektivave strategjike të organizatës buxhetore; | 1.1. It deals with investments that impact the overall social and economic development of the country and/or the achievement of the strategic objectives of budgetary organization; | 1.1. Povezan je sa investicijama koje utiču na ukupan društveni i ekonomski razvoj zemlje i / ili postizanje strateških ciljeva budžetske organizacije; |
| 1.2. Investimi pritet të ofrojë një përmirësim ose përfitim të ri të tillë siç janë zgjerimi i kapacitetit, ulja e shpenzimeve apo përfitime të ngjashme; | 1.2. Investments in the asset are expected to provide an improvement or new benefit as capacity expansion, reduction of expenditures or similar benefits; | 1.2. Od projektnih investicija se očekuje da pruže novo poboljšanje ili koristi kao što je proširenje kapaciteta, smanjenje troškova ili slične koristi; |
| 1.3. Investimi pritet të ofrojë përfitime gjatë shumë viteve; | 1.3. Investments in the project are expected to provide benefits over many years; | 1.3. Očekuje se da će investicije kroz projekat obezbediti koristi tokom mnogih godina; |
| 1.4. Shpenzimet e investimit janë mbi njëmijë (1,000 €) euro dhe zgjasin mbi një (1) vit; | 1.4. Investment costs are over one thousand (1,000€) Euro and duration is over one (1) year; | 1.4. Investicioni troškovi projekta su više od hiljadu (1.000 €) evra i trajaju preko jedne (1) godine; |
| 1.5. Definon pronarin dhe menaxherin e asetit; dhe | 1.5. Defines the owner and the manager of the asset; and | 1.5. Definiše vlasnika i rukovodioca imovine; |
| 1.6. Paraqet një aktivitet zhvillimor apo investiv brenda një kohe të caktuar, me datë të fillimit dhe mbarimit. | 1.6. Is a development or investing activity within a defined time, with the start and the end date. | 1.6. Je razvojna ili investiciona aktivnost u određenom vremenu, sa datumom početka i završetka. |

| Neni 5<br>Klasifikimi i shpenzimeve të projekteve kapitale | Article 5<br>Expenditure classification of capital projects | Član 5<br>Klasifikacija rashoda za kapitalne projekte |
| --- | --- | --- |
| 1. Shpenzimet e projektit i përfshijnë të gjitha shpenzimet që lidhen me projektin. | 1. Project expenditure includes all expenditure related to the project. | 1. Troškovi projekta uključuju sve troškove vezane za projekt. |
| 2. Shpenzimet e projektit ndahen në shpenzimet kapitale dhe në shpenzimet rrjedhëse. | 2. Project expenditure are separated into capital and current expenditures. | 2. Troškovi projekta su podeljeni na kapitalne izdatke i tekuće izdatke. |
| **Neni 6**<br>**Kriteret e përgjithshme për klasifikimin e shpenzimeve të projektit kapital** | **Article 6**<br>**General criteria on expenditure classification of capital projects** | **Član 6**<br>**Opšti kriterijumi za klasifikaciju troškova kapitalnih projekata** |
| 1. Shpenzimet e mëposhtme të projekteve klasifikohen si shpenzime kapitale: | 1. Following expenditure of projects are classified as capital expenditure: | 1. Sledeći troškovi projekta su klasifikovani kao kapitalni izdaci: |
| 1.1.Shpenzimi për çmimin e blerjes së asetit apo shpenzimi i këmbimit të asetit, i cili përcaktohet nga shuma e paguar për asetin ndaj një pale të tretë; | 1.1.Expenditure on purchase price of the asset or the exchange price of the asset, which is determined by the amount paid for the asset to a third party; | 1.1.Troškovi na nabavnu cenu imovine ili trošak razmene imovine, koji se utvrđuje od iznosa koji je plaćen za imovinu trećem licu; |
| 1.2. Shpenzimet lidhur me pagat, mëditjet dhe përfitimet tjera të nëpunësve të punësuar në njësinë për zbatimin e projektit, të cilët në mënyrë të drejtpërdrejtë janë të përfshirë në ndërtim të asetit; | 1.2. Expenditure related to wages, salaries, and other benefits of staff employed at project implementation unit, which directly are involved on construction of the asset; | 1.2. Troškovi vezani za plate, dnevnice i druge beneficije državnih službenika zaposlenih u jedinicu za implementaciju projekta, koji su direktno uključeni u izgradnji imovine; |
| 1.3. Shpenzimet që janë të lidhur me përgatitjen e asetit për vënien në përdorim, që përfshijnë: | 1.3. Expenditure which are related to preparation of asset for putting on use, which includes: | 1.3. Troškovi koji se odnose na pripremu imovine za upotrebu, uključujući: |

| | | |
|---|---|---|
| 1.3.1. Shpenzimet e përgatitjes së vendit/lokacionit të asetit;<br><br>1.3.2. Shpenzimet e ngarkimit apo transportit për dërgimin fillestar dhe trajtimin e asetit;<br><br>1.3.3. Tatimet e pagueshme lidhur me transferin apo përvetësimin e asetit, përjashtuar zbritjen e çmimit apo rimbursimi i atyre tatimeve, nëse aplikohet;<br><br>1.3.4. Shpenzimet e instalimit dhe montimit gjatë përgatitjes së asetit për përdorim;<br><br>1.3.5. Shpenzimet e testimit nëse aseti funksionon siç duhet, pas zbritjes së të ardhurave neto nga shitja e çdo artikulli të prodhuar gjatë sjelljes së asetit në atë gjendje dhe lokacion;<br><br>1.3.6. Shpenzimet profesionale që ndërlidhen me dizajnimin, zhvillimin, ndërtimin ose lëshimin e asetit në përdorim; dhe<br><br>1.3.7. Shpenzimet e bartjes së pronësisë lidhur me shpronësimin e asetit me kusht që kompensimi i është paguar pronarit të asetit.<br><br>1.4. Shpenzimet lidhur me vendimet gjyqësore të formës së prerë apo vendime ekuivalente që kanë të bëjnë me | 1.3.1. Expenditure on preparation of location of asset;<br><br>1.3.2. Loading or transport expenditure for initial delivery and asset handling;<br><br>1.3.3. Payable tax related to the transfer or appropriation of the asset, excluding price deduction or reimbursement of those tax, if applicable;<br><br>1.3.4. Mounting and installation expenditure while preparing the asset for putting on use;<br><br>1.3.5. Testing expenditure if the asset functions properly, after deduction of net revenues from the sale of each item produced while bringing the asset into that condition and location;<br><br>1.3.6. Professional expenditure related to design, development, construction, or putting the asset on use, and<br><br>1.3.7. Property transfer expenditure related to the expropriation of asset, with a condition that compensation is paid to the original owner of the asset.<br><br>1.4. Expenditure related to final court decisions or equivalent decisions related to the expropriation of the asset, with a | 1.3.1. troškove pripreme mesta / lokacije imovine;<br><br>1.3.2. troškovi utovara ili transporta za početnu isporuku i rukovanje imovinom;<br><br>1.3.3. poreze koji se plaćaju u vezi sa prenosom ili sticanjem imovine, isključujući odbitak od cene ili povrat tih poreza, ako je to primenjivo;<br><br>1.3.4. troškovi instalacije i montaže prilikom pripreme imovine za upotrebu;<br><br>1.3.5. troškove testiranja ako imovina funkcioniše ispravno nakon odbijanja neto prihoda od prodaje bilo koje stavke proizvedene tokom donošenje imovine u tom stanju i lokaciji;<br><br>1.3.6. profesionalni troškovi u vezi sa projektovanjem, razvojem, izgradnjom ili puštanjem imovine u upotrebi; i<br><br>1.3.7. troškove prenosa imovine u vezi sa eksproprijacijom imovine pod uslovom da je nadoknada isplaćena vlasniku imovine.<br><br>1.4. Troškovi koji se odnose na konačne sudske odluke ili ekvivalentne odluke koje se odnose na eksproprijaciju imovine, pod |

| | | |
|---|---|---|
| shpronësimin e asetit, me kusht që kompensimi i është paguar pronarit origjinal të asetit. | condition that compensation is paid to the original owner of the asset. | uslovom da je nadoknada isplaćena vlasniku imovine. |
| 2. Kur kompensimi për shpronësimin e asetit nuk është paguar siç përcaktohet në paragrafin 1.4. Të këtij neni, atëherë shpenzimet duhet të trajtohen si shpenzime rrjedhëse. | 2. When the compensation for the asset expropriation isn't paid, as stipulated under paragraph 1.4 of this Article, then expenditure should be considered as current expenditure. | 2. Kada se nadoknada za eksproprijaciju imovine nije plaćeno kako je definisano u stavu 1.4. ovog člana, onda se rashodi trebaju tretirati kao tekući izdaci. |
| 3. Shpenzimet kapitale për një aset specifik do të jenë akumulimi i shpenzimeve nga secila prej këtyre kategorive siç përcaktohet në paragrafin 1.3 të këtij neni. | 3. Capital expenditure for a specific asset will be accumulation of expenditure from each of these categories as stipulated by paragraph 1.3 of this Article. | 3. Kapitalni izdaci za određenu imovinu će biti akumulacija troškova iz svake od ovih kategorija kako je definisano u stavu 1.3 ovog člana. |
| 4. Në raste të caktuara, përbërësit kryesorë të një aseti, përveç aseteve të ndërlidhura, mund të regjistrohen si të ndarë në regjistrin e aseteve dhe jo si një aset i vetëm. | 4. In certain cases, main components of an asset, except related assets, can be registered separately in assets register and not as a single asset. | 4. U određenim slučajevima, glavne komponente imovine, osim povezanih imovina, mogu se registrovati kao odvojene u registru imovine, a ne kao pojedinačna imovina. |
| 5. Ndarja e asetit në pjesë apo komponentë të ndryshëm mund të bëhet vetëm nëse kjo ndarje ofron informatë të vlefshme dhe kuptimplote nga perspektiva e transparencës apo menaxhimit. | 5. Asset componentization can be done only if it might provide valuable and significant information with regard to transparency and management perspective. | 5. Razdvajanje imovine u delovima ili raznim komponentama može se izvršiti samo ako ova podela pruža vredne i smislene informacije iz perspektive transparentnosti ili upravljanja. |
| **Neni 7**<br>**Shpenzimet kryesore lidhur me asetin ekzistues** | **Article 7**<br>**Main expenditure related to existing asset** | **Član 7**<br>**Glavni rashodi koji se odnose na postojeću imovinu** |
| 1. Në rastin e realizimit të një projekti lidhur me asetin ekzistues, kur shpenzimi është i rëndësishëm dhe domethënës krahasuar me koston e asetit origjinal, ai shpenzim trajtohet si shpenzim kapital nëse është projekt përmirësimi që: | 1. In the case of realizing a project related to the existing asset, when the expenditure is important and significant compared to the cost of the original asset, that expense is considered as a capital expenditure, if it is an improvement project that would: | 1. U slučaju izvršenja projekta koji se odnosi na postojeću imovinu kada je trošak značajan i značajan u odnosu na trošak originalne imovine, taj trošak se tretira kao kapitalni trošak ako je to projekat poboljšanja koji će: |

| | | |
|---|---|---|
| 1.1. Do të ngritë kapacitetin e një aseti; | 1.1. Increase the capacity of an asset; | 1.1. povećati kapacitet imovine; |
| 1.2. Do të rritë jetëgjatësinë e përdorimit të një aseti; apo | 1.2. Increase asset's useful life, or | 1.2. povećati životni vek imovine; ili |
| 1.3. Do të zvogëlojë shpenzimet rrjedhëse të një aseti. | 1.3. Reduce current expenditure of an asset. | 1.3. smanjiti tekuće troškove imovine. |
| 2. Shpenzimi pasues në përsëritjen e aktivitetit/procesit të projektit ose korrigjimin e aktivitetit, i cili nuk siguron përfitim ekonomik në të ardhmen përtej atij që ndërlidhet me shpenzimin origjinal, trajtohet si shpenzim rrjedhës. | 2. The subsequent expenditure of repeating the project activity/process or correcting the activity, which does not provide future economic benefit beyond the one related to the original expenditure, is considered as current expenditure. | 2. Naknadni troškovi ponavljanja projektne aktivnosti / procesa ili korekcije aktivnosti, koja ne obezbeđuje buduću ekonomsku korist izvan one koja se odnosi na prvobitni trošak, tretira se kao tekući rashod. |
| **Neni 8**<br>**Klasifikimi i shpenzimeve që ndërlidhen me aktivitetet kyçe të projektit** | **Article 8**<br>**Expenditures' classification related to key activities of the capital project** | **Član 8**<br>**Klasifikacija troškova vezana za ključne projektne aktivnosti** |
| 1. Shpenzimet në fazën e identifikimit të projektit: stafi i ekipit të projektit, shpenzimet e udhëtimit që ndërlidhet me vlerësimin e lokacionit, aktivitetet kërkimore, raportet preliminare të vlerësimit, studimet e fizibilitetit dhe asistenca teknike, klasifikohen si shpenzime rrjedhëse. | 1. Expenditures in the project identification stage: project team staff, travel related to location assessment, research activities, preliminary assessment reports, feasibility studies and technical assistance, are classified as current expenditures. | 1. Troškovi u fazi identifikacije projekta: za osoblje projektnog tima, putovanja vezana za lokaciju, istraživačke aktivnosti, izveštaje preliminarne procene, studije izvodljivosti i tehničku pomoć, klasifikuju se kao tekući troškovi. |
| 2. Shpenzimet në fazën e formulimit të projektit: shpenzimet për stafin e ekipit të projektit, konsulentët, shpenzimet e udhëtimit të ekipit të projektit, përgatitjen e tenderit, tarifat ligjore, tarifën e analizës së vlerësimit afarist | 2. Expenditures at project formulation stage: project team staff, consultants, travel of project team, tender preparation, legal fees, due diligence fees, and technical assistance, are classified as current expenditures. | 2. Troškovi u fazi formulacije projekta: za osoblje projektnog tima, konsultanti, putovanja projektnog tima, priprema tendera, pravne naknade, naknada za analizu poslovne procene |

| | | |
|---|---|---|
| dhe asistenca teknike, klasifikohen si shpenzime rrjedhëse. | | i tehnička pomoć, klasifikuju se kao tekući troškovi. |
| 3. Shpenzimet në fazën e zbatimit (faza e projektimit, planifikimit dhe prokurimit): shpenzimet për konsulentët, tenderi, tarifat ligjore, tarifa e analizës së vlerësimit afarist, përfshirë reklamimin e tenderëve, negocimi dhe përgatitja e kontratës, asistenca teknike dhe shpenzimet e bartjes së pronësisë lidhur me shpronësimin e asetit, me kusht që kompensimi i është paguar pronarit origjinal, klasifikohen si shpenzime kapitale. | 3. Expenditure in the implementation stage (project design, project planning and procurement): consultants' fees, tender fees, legal fees, due diligence fees, including tender advertisements, negotiation and contract preparation, technical assistance and property transfer expenditures related to the expropriation of the asset, with a condition that the compensation is paid to the legitimate owner, are classified as capital expenditures. | 3. Troškovi u fazi implementacije projekta (izrada projekta, planiranje i nabavka projekta): konsultanti, tender, pravne troškove, naknada za analizu poslovne procene, uključujući oglašavanje na tenderu, pregovaranje i priprema ugovora, tehnička pomoć i troškovi transfera vlasništva u vezi sa eksproprijacijom imovine, pod uslovom da je nadoknada isplaćena prvobitnom vlasniku, klasifikuju se kao kapitalni izdaci. |
| 4. Shpenzimet në fazën e zbatimit (faza e realizimit/ndërtimit të projektit): shpenzimet për blerjen apo përvetësimin e tokës, prishjen e ndërtimeve ekzistuese, tarifat ligjore, tarifën e analizës së vlerësimit afarist, taksat/tatimet administrative lidhur me blerjen apo përvetësimin e asetit, punët përgatitore të tokës, punimet infrastrukturore, punimet ndihmëse, pagesat për progresin lidhur me fazat kyçe të ndërtimit, stafi i njësisë për implementimin e projektit, menaxhimi i tenderit/kontratës, klasifikohen si shpenzime kapitale. | 4. Expenditures in the implementation stage (project execution/construction phase: purchase or expropriation of land, demolition of existing constructions, legal fees, due diligence fees, administrative fees related to the purchase or appropriation of the asset, land preparation works, infrastructural works, auxiliary works, payments for the progress related to key stages of the construction, staff costs for the project implementation unit, management of tender/contract, are classified as capital expenditure. | 4. Troškovi u fazi implementacije (realizacija/izgradnja imovine): otkup zemljišta, rušenje postojećih objekata, pravne troškove, naknada za procenu vrednosti poslovanja, administrativna taksa / porezi koji se odnose na nabavku ili nabavku imovine, pripremne radove zemljišta, radovi na infrastrukturi, pomoćni radovi, plaćanja za napredak u vezi sa ključnim fazama izgradnje, troškovi jedinice za implementaciju projekta, upravljanje tenderom / ugovorom, klasifikuju se kao kapitalni izdaci. |

| Neni 9<br>Trajtimi i granteve për qëllime të shpenzimeve kapitale | Article 9<br>Treatment of grants for capital expenditure purposes | Član 9<br>Tretman grantova za potrebe kapitalnih troškova |
| --- | --- | --- |
| 1. Kur niveli qendror dhe niveli lokal bashkërisht kontribuojnë në ndërtimin ose përvetësimin e një aseti, secili prej tyre regjistron pjesën e vet të pagesës si shpenzim kapital apo shpenzim rrjedhës, në përputhje me dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ.<br><br>2. Pas kapitalizmit të asetit nga institucioni financues, me marrëveshje të përbashkët në mes institucionit financues dhe institucionit përfitues, përcaktohet pronësia dhe menaxhimi i asetit. | 1. Where central and local level jointly cooperate on construction or appropriation of the asset, each of them separately registers its own part of the payment as capital or current expenditure, pursuant to the provisions of this Administrative Instruction.<br><br>2. After capitalization of the asset from funding institution, through joint agreement between funding institution and beneficiary institution, is determined the ownership and asset management. | 1. Kada centralni i lokalni nivoi zajednički doprinose izgradnji ili sticanju imovine, svaki od njih evidentira svoj deo plaćanja kao kapitalni trošak ili tekući trošak, u skladu sa odredbama ovog Administrativnog uputstva.<br><br>2. Nakon kapitalizacije imovine od finansijske institucije, zajednički sporazum između finansijske institucije i institucije korisnika određuje vlasništvo i upravljanje imovinom. |
| **KAPITULLI III<br>DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**<br><br>**Neni 10<br>Shtojca**<br><br>Pjesë përbërëse e këtij Udhëzimi Administrativ është Shtojca 1 - Udhëzimet praktike lidhur me klasifikimin e shpenzimeve për projektet kapitale. | **CHAPTER III<br>FINAL PROVISIONS**<br><br>**Article 10<br>Annex**<br><br>An integral part of this Administrative Instruction is Annex 1 – Practical instructions related to expenditure classification of capital projects. | **POGLAVLJE III<br>ZAVRŠNE ODREDBE**<br><br>**Član 0<br>Dodatak**<br><br>Sastavni deo ovog Administrativnog uputstva je Dodatak 1 - Praktične smernice za klasifikaciju troškova za kapitalne projekte. |

| Neni 11<br>**Hyrja në fuqi** | Article 11<br>**Entry into force** | Član 11<br>**Stupanje na snagu** |
| --- | --- | --- |
| Ky Udhëzim Administrativ hynë në fuqi më 1 janar 2020.<br><br>**Bedri HAMZA**<br><br>**(e nënshkruar)**<br>______________________<br>**Ministri i Financave**<br><br>**Datë 19/07/2019** | This Administrative Instruction enters into force on 1 January 2020.<br><br>**Bedri HAMZA**<br><br>**(signed)**<br>______________________<br>**Minister of Financave**<br><br>**Date 19/07/2019** | Ovo Administrativno uputstvo stupa na snagu u 1 Januara 2020.<br><br>**Bedri HAMZA**<br><br>**(potpisano)**<br>______________________<br>**Ministar Finansija**<br><br>**Dana 19/07/2019** |

**Shtojca 1 - Udhëzimet praktike lidhur me klasifikimin e shpenzimeve për projektet kapitale**

Në kuptimin praktik, tabelat e mëposhtme japin fazat kryesore të një projekti dhe klasifikimin e duhur të shpenzimeve që ndërlidhen me aktivitetet kyçe të çdo faze.

<table>
<tr><td colspan="3">Faza – Zhvillimi i Konceptit</td></tr>
<tr><td colspan="3">Projekti potencial është identifikuar dhe janë duke u kryer hulumtimet paraprake për të kuptuar më mirë fizibilitetin e tij.<br>Kjo fazë quhet Faza e Identifikimit në Manualin e PIP-it</td></tr>
<tr><td rowspan="6">Aktivitetet/Shpenzimet tipike</td><td>Shpenzimet për pagat dhe përfitimet tjera për ekipin e projektit</td><td rowspan="6">Shpenzimet rrjedhëse</td></tr>
<tr><td>Shpenzimet e udhëtimit që ndërlidhen me vlerësimin e vendit/terrenit</td></tr>
<tr><td>Aktivitetet hulumtuese</td></tr>
<tr><td>Raportet preliminare të vlerësimit</td></tr>
<tr><td>Studimet e fizibilitetit</td></tr>
<tr><td>Asistenca Teknike</td></tr>
<tr><td colspan="3">Faza – Planifikimi Paraprak</td></tr>
<tr><td colspan="3">Në këtë faze zakonisht ndërmerret planifikimi më i detajuar pasi koncepti është pranuar. Kjo fazë përfshin analizën ekonomike dhe financiare të rasteve biznesore; analizën e kostove dhe përfitimeve; hulumtimin dhe vlerësimin e terrenit, studimet e fizibilitetit, dhe diskutimet preliminare të planifikimit me autoritetet përkatëse. Kjo fazë mund të përshijë proceset që ndërlidhen me hulumtimin e tregut mbi kontraktorët e mundshëm dhe mbi procesin tenderues.<br>Kjo fazë quhet Faza e Formulimit në Manualin e PIP-it</td></tr>
<tr><td rowspan="7">Aktivitetet /Shpenzime tipike</td><td>Shpenzimet për pagat dhe përfitimet tjera për ekipin e projektit</td><td rowspan="7">Shpenzimet rrjedhëse</td></tr>
<tr><td>Shpenzimet e Konsulentëve</td></tr>
<tr><td>Shpenzimet e udhëtimit për ekipin e projektit</td></tr>
<tr><td>Shpenzimet për përgatitjen e tenderit</td></tr>
<tr><td>Tarifat ligjore</td></tr>
<tr><td>Tarifën e analizës së vlerësimit afarist (‘due diligence’)</td></tr>
<tr><td>Asistenca Teknike</td></tr>
<tr><td colspan="3">Shpenzimet e përgatitjes së tenderit përfshijnë punët preliminare në përgatitjen e specifikacioneve, kërkesat e dokumenteve, përgatitjet lidhur me aspektet ligjore dhe kontraktuale të informatave që duhet të përfshihen me rastin e lëshimit në treg të dokumentacionit tenderues.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Faza – Projektimi, Planifikimi dhe Prokurimi (1)</td></tr>
<tr><td colspan="3">Në këtë fazë, projekti ka të ngjarë të ofrojë përfitime në të ardhmen. Zakonisht ndërmerren aktivitete më të detajuara të projektimit dhe planifikimit. Kjo përfshin planet dhe vizatimet arkitektonike,</td></tr>
</table>

<table>
<tr><td colspan="3">inxhinierike, zhvillimet e fazave të detajuara të projektit, si dhe janë publikuar tenderët për ndërtime të ndryshme dhe aktivitete të tjera.</td></tr>
<tr><td rowspan="8">Aktivitetet/ Shpenzimet tipike</td><td>Shpenzimet për pagat dhe përfitimet tjera për Njësinë e Implementimit të Projektit</td><td rowspan="7">Shpenzimet kapitale</td></tr>
<tr><td>Shpenzimet e Konsulencës - p.sh. për shërbime arkitekturore/inxhinierike</td></tr>
<tr><td>Tarifat ligjore dhe tarifat e analizës së vlerësimit afarist (‘due diligence’)</td></tr>
<tr><td>Shpenzimet e tenderit, përfshirë edhe reklamimin e tenderit (1)</td></tr>
<tr><td>Shpenzimet e përgatitjes dhe negocimit të kontratës</td></tr>
<tr><td>Asistenca Teknike</td></tr>
<tr><td>Shpenzimet e bartjes së pronësisë në lidhje me shpronësimin e asetit me kusht që kompensimi i është paguar pronarit (2)</td></tr>
<tr><td>Riparimi i aktiviteteve të projektit (3)</td><td>Shpenz.rrjedh.</td></tr>
<tr><td colspan="3">(1) Shpenzimet e tenderit përfshijnë shpenzimet që lidhen me lëshimin e dokumenteve të tenderit dhe vlerësimin pasues të ofertave, duke përfshirë çdo këshillë profesionale dhe specifike të marrë në vlerësimin e ofertave të tenderit.<br>(2) Kur kompensimi nuk është paguar në lidhje me shpronësimin e asetit, atëherë çdo shpenzim gjyqësor duhet të trajtohet si shpenzim rrjedhës.<br>(3) Në disa raste, shpenzimet shtesë mund të ndodhin, për shembull, nëse një proces tenderi është anuluar dhe ka nevojë për t’u ritenderuar (për shembull për shkak të korrigjimeve të ndryshme apo korrupsionit), dokumentet e projektimit janë të një cilësie të dobët dhe duhet të rihartohen, ose nëse aktivitetet e tjera të projektit duhet të riparohen. Në këto rrethana, shpenzimet e përsëritjes së procesit ose riparimi i aktiviteteve duhet të trajtohen si Shpenzime Rrjedhëse pasi që nuk kontribuojnë në përfitimet ekonomike të pritshme në të ardhmen përtej asaj të shpenzimeve fillestare.<br>Kjo fazë është pjesë e fazës së zbatimit në Manualin e PIP-it.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Faza – Realizimi/Ndërtimi i Projektit</td></tr>
<tr><td colspan="3">Në këtë fazë ka filluar ndërtimi fizik i projektit/asetit. Vlerësimi i tenderit është finalizuar dhe është nënshkruar kontrata. Kryhen aktivitetet para ndërtimit, siç është blerja apo përvetësimi i tokës, përgatitja e terrenit (përfshirë edhe demolimin e ndërtesave ekzistuese), krijimi i zyrave në terren, etj. Gjatë kohës që vazhdon puna duhen bërë pagesat progresive ndaj kontraktorëve (nganjëherë duke u bazuar në arritjen e caqeve të paravendosura) në përputhje me marrëveshjet e kontratës.</td></tr>
<tr><td>Aktivitetet/Shpenzimet tipike</td><td>Shpenzimet për pagat dhe përfitimet tjera për Njësinë e Implementimit të Projektit</td><td>Shpenzimet kapitale</td></tr>
</table>

| | | |
|---|---|---|
| | Blerja/përvetësimi i tokës | |
| | Blerja e impianteve, pajisjeve dhe makinerive lidhur me projektin. | |
| | Rrënimi i ndërtesave ekzistuese | |
| | Tarifat ligjore | |
| | Tarifat e analizës së vlerësimit afarist (due diligence) | |
| | Taksat administrative lidhur me blerjet apo përvetësimet | |
| | Përpunimi i tokës dhe përgatitja e terrenit për ndërtim | |
| | Punët infrastrukturore | |
| | Punët ndihmëse | |
| | Pagesat sipas fazave të projektit/ndërtimit | |
| | Shpenzimet e menaxhimit të tenderimit/kontratës | |
| Të gjitha shpenzimet në këtë fazë trajtohen si shpenzime kapitale, pasi që ka të ngjarë që aseti që po ndërtohet të rezultojë me përfitimet ekonomike në të ardhmen.<br>Kjo fazë quhet *Faza e Implementimit* në Manualin e PIP-it | | |
| **Faza – Përmbyllja e Projektit, Operimi dhe Mirëmbajtja e Aseteve** | | |
| Në këtë fazë, projekti është përfunduar dhe i është dorëzuar autoritetit që operon me asetin. Data kur aseti është për herë të parë i gatshëm për përdorim dhe në gjendje të përdoret siç është menduar është data e komisionimit (pranimit teknik) të asetit. Nga kjo datë, shpenzimet e operimit, riparimit dhe mirëmbajtjes konsiderohen si shpenzime rrjedhëse. | | |
| | Pagat dhe mëditjet për operimin dhe mirëmbajtjen e asetit | Shpenz.rrjedhëse |
| | Riparimet dhe mirëmbajtja (1) | |
| 1. Riparimet dhe aktivitetet e mirëmbajtjes thjeshtë kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e aseteve në gjendjen e tyre fillestare dhe në nivelin fillestar të funksionalitetit. Këto janë shpenzime të nevojshme për ta mundësuar që aseti të vazhdojë të përdoret siç është menduar në fillim. | | |

**Annex 1 - Practical instructions related to expenditures' classification of capital projects**

In practical meaning, following tables provides key stages of a project, and proper classification or expenditure which are related to key activities of each stage.

<table>
<tr><td colspan="3">Stage – development of concept</td></tr>
<tr><td colspan="3">Potential project has been identified and preliminarily researches are being performed in order to better understand its feasibility.<br>This stage is called Identification Stage in PIP Manual</td></tr>
<tr><td rowspan="6">Activities/typical expenditure</td><td>Expenditure on wages and other benefits for project team</td><td rowspan="6">Current expenditure</td></tr>
<tr><td>Travel expenditure related to the site assessment</td></tr>
<tr><td>Research activities</td></tr>
<tr><td>Preliminarily assessment reports</td></tr>
<tr><td>Feasibility studies</td></tr>
<tr><td>Technical assistance</td></tr>
<tr><td colspan="3">Stage – Preliminarily planning</td></tr>
<tr><td colspan="3">At this stage, more detailed planning is usually undertaken after the concept is accepted. This stage involves the economic and financial analysis of business cases; cost and benefit analysis; research and field assessment, feasibility studies, and preliminary planning discussions with relevant authorities. This stage may include processes related to market research on potential contractors and tendering process.<br><br>This stage is called Formulation Stage in PIP Manual</td></tr>
<tr><td rowspan="7">Activities/typical expenditure</td><td>Expenditure on wages and other benefits for project team</td><td rowspan="7">Current expenditure</td></tr>
<tr><td>Consultants expenditure</td></tr>
<tr><td>Travel expenditure for project team</td></tr>
<tr><td>Expenditure for tender preparation</td></tr>
<tr><td>Legal fees</td></tr>
<tr><td>Due diligence fee</td></tr>
<tr><td>Technical assistance</td></tr>
</table>

<table>
<tr><td colspan="3">Tender preparation expenditure includes preliminary work on the preparation of specifications, document requirements, preparations regarding the legal and contractual aspects of the information to be included when the Tender Documentation is placed on the market.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Stage – Design, Planning and Procurement (1)</td></tr>
<tr><td colspan="3">At this stage, the project is likely to provide future benefits. Usually, more detailed design and planning activities are undertaken. This includes plans and architectural drawings, engineering, developments on detailed stages of the project, as well as tenders and other activities for various constructions have been advertised.</td></tr>
<tr><td rowspan="8">Activities/typical expenditure</td><td>Expenditure for wages and other benefits for Project Implementation Unit</td><td rowspan="7">Capital expenditure</td></tr>
<tr><td>Consultancy expenditure – e.g. for architectural/engineering services</td></tr>
<tr><td>Due diligence</td></tr>
<tr><td>Tendering expenditure, including even advertisement of tender (1)</td></tr>
<tr><td>Expenditure of preparation and contract negotiation</td></tr>
<tr><td>Technical assistance</td></tr>
<tr><td>Expenditure of proprietorship transfer related to asset expropriation with a condition that the compensation is paid to original owner (2)</td></tr>
<tr><td>Repair of project activities (3)</td><td>Current expenditure</td></tr>
<tr><td colspan="3">(4) The tender expenditure include the expenditure related to the issuance of tender documents and the subsequent assessments of bids, including any professional and specific advice received in the assessments of bids of the tender.<br>(5) When the compensation related to the asset expropriation is not paid, then every court expenditure should be addressed as current expenditure.<br>(6) In some cases, additional expenditure may occur, for example, if a tender process has been canceled and needs to be re-tendered (for example due to various corrections or corruption), the design documents are of poor quality and should be re-drafted, or if other project activities needs to be repaired. In these circumstances, expenditure of the process repetition or repair of the activities should be addressed as current expenditure since they do not contribute to the expected economic benefits in the future beyond the initial expenditure.<br><br>This stage is part of implementation stage in PIP Manual.</td></tr>
</table>

| | | |
|---|---|---|
| **Stage – Project Execution/Construction** | | |
| At this stage, the physical construction of the project/asset has begun. The tender assessment was finalized and the contract was signed. Pre-construction activities are carried out, such as purchase or appropriation of land, preparation of site, (including demolition of existing buildings), establishment of field offices, etc. During the course of the work, progressive payments to contractors should be completed (sometimes based on the achievement of pre-set targets) in accordance with the contractual arrangements. | | |
| Activities/typical expenditure | Expenditure for wages and other benefits for Project Implementation Unit | Capital expenditure |
| | Purchase/appropriation of land | |
| | Purchase of plants, equipment and machineries related to the project. | |
| | Demolition of existing buildings | |
| | Legal fees | |
| | Due diligence | |
| | Administrative tax related to purchase or appropriations | |
| | Land processing and site preparation for construction | |
| | Infrastructural works | |
| | Auxiliary works | |
| | Payments according to project/construction stages | |
| | Management expenditure of tendering/contract | |
| All expenditure at this stage are considered as capital expenditure, as it is likely that the asset under construction will result with economic benefits in future.<br>*This stage is called Implementation Stage in PIP Manual*. | | |
| **Stage – Project conclusion, Operation and Assets Maintenance** | | |
| At this stage the project is completed and handed over to the authority who operates with the asset. The date when the asset is for the first time ready for operation and in condition to be used as thought, is the commissioning date (technical acceptance) of asset. Since this date, operation, repair, and maintenance expenditure are considered as current expenditure. | | |
| | Wages and salaries for operation and asset maintenance | Current expenditure |
| | Repairs and maintenance (1) | |
| 2. Repair and maintenance activities simply are related to assets maintenance at their initial stage and at initial level of functionality. These are necessary expenditure to enable that asset continues to be used as thought at the beginning. | | |

**Dodatak 1 - Praktične smernice za klasifikaciju izdataka za kapitalne projekte**

U praktičnom smislu, u narednim tabelama prikazane su glavne faze projekta i odgovarajuća klasifikacija izdataka vezana za ključne aktivnosti svake faze.

<table>
<tr><td colspan="3">Faza – Razvoj koncepta</td></tr>
<tr><td colspan="3">Identifikovan je potencijalni projekat i u toku su preliminarna istraživanja kako bi se bolje razumela njegova izvodljivost.<br>Ova faza se naziva Faza identifikacije u PIP priručniku</td></tr>
<tr><td rowspan="6">Tipične aktivnosti / rashodi</td><td>Troškovi za plate i druge beneficije za projektnu ekipu</td><td rowspan="6">Tekući rashodi</td></tr>
<tr><td>Putni troškovi povezani sa procenom zemlje / lokacije</td></tr>
<tr><td>Istraživačke aktivnosti</td></tr>
<tr><td>Izvještaji o preliminarnoj proceni</td></tr>
<tr><td>Studije izvodljivosti</td></tr>
<tr><td>Tehnička pomoć</td></tr>
<tr><td colspan="3">Faza – Prethodno planiranje</td></tr>
<tr><td colspan="3">U ovoj fazi se obično preduzima detaljnije planiranje pošto je koncept prihvaćen. Ova faza uključuje ekonomsku i finansijsku analizu poslovnih slučajeva; analizu troškova i koristi; terenska istraživanja i procene, studije izvodljivosti, i preliminarne razgovore o planiranju sa relevantnim vlastima. Ova faza može uključivati procese koji se odnose na istraživanje tržišta potencijalnih izvođača radova i tenderski proces.<br><br>Ova faza se naziva Faza formulacije u PIP priručniku</td></tr>
<tr><td rowspan="7">Tipične aktivnosti / rashodi</td><td>Troškovi za plate i druge beneficije za projektnu ekipu</td><td rowspan="7">Tekući rashodi</td></tr>
<tr><td>Troškovi konsultanata</td></tr>
<tr><td>Putni troškovi za projektnu ekipu</td></tr>
<tr><td>Troškovi za pripremu tendera</td></tr>
<tr><td>Pravne tarife</td></tr>
<tr><td>Tarifa za procenu vrednosti biznisa (‘due diligence’)</td></tr>
<tr><td>Tehnička pomoć</td></tr>
<tr><td colspan="3">Troškovi pripreme ponude obuhvataju pripremne radove na pripremi specifikacija, zahteve za dokumente, pripreme u vezi sa pravnim i ugovornim aspektima informacija koje treba uključiti prilikom stavljanja tenderske dokumentacije na tržište.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Faza - Dizajn, planiranje i nabavka (1)</td></tr>
</table>

<table>
<tr><td colspan="3">U ovoj fazi, projekat se smatra da če verovatno pružiti buduće koristi. Obično se preduzimaju detaljnije aktivnosti projektovanja i planiranja. To uključuje arhitektonske i inženjerske planove, crteže, detaljne faze projekta i tendere za razne izgradnje i druge aktivnosti.</td></tr>
<tr><td rowspan="8">Tipične aktivnosti / rashodi</td><td>Rashodi za plate i druge koristi za Jedinicu za implementaciju projekta</td><td rowspan="7">Kapitalni izdaci</td></tr>
<tr><td>Troškovi konsultacija - npr. za arhitektonske / inženjerske usluge</td></tr>
<tr><td>Pravne tarife i tarife za procenu vrednosti biznisa („due diligence“)</td></tr>
<tr><td>Tenderski troškovi, uključujući i tendersko oglašavanje (1)</td></tr>
<tr><td>Troškovi pripreme i pregovaranja ugovora</td></tr>
<tr><td>Tehnička pomoć</td></tr>
<tr><td>Troškovi prenosa vlasništva u vezi sa eksproprijacijom imovine pod uslovom da je nadoknada isplaćena prvobitnom vlasniku (2)</td></tr>
<tr><td>Popravljanje projektnih aktivnosti (3)</td><td>Tekući rashodi</td></tr>
<tr><td colspan="3">(1) Troškovi tendera uključuju troškove vezane za izdavanje tenderske dokumentacije i naknadnu ponuda, uključujući sve stručne i specifične savete primljene u proceni ponude.<br>(2) Ako nadoknada nije isplaćena u vezi sa eksproprijacijom imovine, onda se svaki sudski trošak tretira kao tekuči trošak.<br>(3) U nekim slučajevima mogu nastati dodatni troškovi, na primer, ako je tenderski postupak poništen i potrebno ga je ponovo ponuditi (na primer zbog različitih ispravki ili korupcije), projektna dokumentacija je slabe kvalitete i treba ih ponovo uspostaviti, ili ako je potrebno popraviti druge projektne aktivnosti. Pod ovim okolnostima, troškovi ponavljanja procesa ili popravke aktivnosti treba tretirati kao tekuće troškove jer ne doprinose budućim očekivanim ekonomskim koristima iznad onih početnih troškova.<br><br>Ova faza je dio Faze implementacije u Priručniku PIP-a.</td></tr>
<tr><td colspan="3">Realizacija / Izgradnja projekta</td></tr>
<tr><td colspan="3">U ovoj fazi je počela fizička izgradnja projekta / imovine. Vrednovanje tendera je završeno i potpisan je ugovor. Predizgradnje aktivnosti se sprovode, kao što su nabavka ili otkup zemljišta, priprema terena (uključujući rušenje postojećih zgrada), osnivanje terenskih ureda, itd. Tokom</td></tr>
</table>

| | | |
|---|---|---|
| rada, moraju se izvršiti progresivne isplate izvođačima radova (ponekad na osnovu postizanja unapred utvrđenih ciljeva) u skladu sa ugovornim aranžmanima. | | |
| Tipične aktivnosti / rashodi | Rashodi za plate i druge koristi za Jedinicu za implementaciju projekta | Kapitalni izdaci |
| | Otkup / sticanje zemljišta | |
| | Kupovina postrojenja, opreme i mašina vezanih za projekat. | |
| | Rušenje postojećih zgrada | |
| | Pravna tarifa | |
| | Pravne tarife i tarife za procenu vrednosti biznisa (due diligence) | |
| | Administrativni porezi koji se odnose na kupovinu ili sticanje | |
| | Obrada zemljišta i priprema terena za izgradnju | |
| | Infrastrukturni radovi | |
| | Pomoćni radovi | |
| | Isplate prema fazama projekta / izgradnje | |
| | Troškovi Tendera / Upravljanje Ugovora | |
| Svi troškovi u ovoj fazi se tretiraju kao kapitalni izdaci, jer je vjerovatno da će se imovina koja se gradi rezultirati budućim ekonomskim koristima.<br><br>Ova faza se naziva *Faza implementacije* u PIP Priručniku | | |
| **Faza - Završetak projekta, rad i održavanje imovine** | | |
| U ovoj fazi, projekat je završen i dostavljen organu koji upravlja imovinom. Datum kada je imovina prvi put spremza za upotrebu i koja se može koristiti kako je planirano, je datum puštanja u rad (tehnički prijem) imovine. Od tog datuma, troškovi rada, popravka i održavanja se smatraju tekućim troškovima. | | |
| | Plate i dnevnice za rad i održavanje imovine | Tekući rashodi |
| | Popravci i održavanje (1) | |
| 1. Aktivnosti popravaka i održavanja odnose se samo na održavanje imovine u početnom stanju i na početnoj razini funkcionalnosti. To su nužni izdaci koji omogućuju nastavak korištenja imovine u skladu s izvornom namenom. | | |

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna Rahovec*
*Opština Orahovac/Municipality Rahovec*

Nr. 01-2022
Datë: 30.03.2022

# RAPORTI VJETOR I PUNËS I KOMITETIT TË AUDITIMIT 2021

Nga: Sead Rama, Kryesues i Komitetit të Auditimit

**Për: Kryesuesin e Kuvendit Komunal të Komunës së Rahovecit**
**CC: Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa**

RAHOVEC, Mars 2022

Për periudhën raportuese, Komiteti i Auditimit ka shqyrtuar raportet e Auditimit të Brendshëm dhe raportin vjetor të Auditorit Gjeneral për vitin 2020.
Gjithashtu, Komiteti i Auditimit ka mbajtur pesë seanca ku janë shqyrtuar pikët të ndryshme sipas programit dhe planin e punës për vitin 2021.

Në të gjitha takimet janë mbajtur procesverbale ku janë regjistruar të gjitha diskutimet e anëtarëve të komitetit të Auditimit dhe drejtorët e drejtorive përkatëse, pjesëmarrës në këto takime. Po ashtu në shumicën e seancave ka marrë pjesë drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, z. Afrim Limani. Gjithashtu, në procesverbalet e takimeve janë nxjerrë konkluza nga këto takime të cilat u janë rekomanduar drejtorive komunale për veprim.

## 1. Seanca e parë

Është mbajtur më 13.04.2021 me këto pika të rendit të ditës:

1. **Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
2. **Shqyrtimi i Raportit vjetorë të Auditimit të Brendshëm për vitin 2020;**
3. **Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft Statutit të Komitetit të Auditimit të Brendshëm;**
4. **Të ndryshme.**

Ky takim pune është mbajtur në përbërje të plotë të Komitetit të Auditimit.
Në këtë takim kanë diskutuar; Sead Rama, Kryesues i Komitetit, Fllanza Popaj, Anëtar i Komitetit, Sehad Boshnjaku, Anëtar i Komitetit, Skender Hamza, Anëtar i Komitetit, Mirsad Shala, Anëtar i Komitetit, si dhe Auditor i njësisë së Auditimit të brendshëm Ruzhdi Kabashi dhe Binak Kryeziu.

**Sead Rama** – Të nderuar, shpresoj se jeni të gjithë të pajtimit me këtë rend dite, konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parët ë rendit të ditës:
**1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**
A ka dikush të shtojë diçka ose të jep ndonjë vërejtje sa i përket procesverbalit nga mbledhja e kaluar, nëse jo atëherë e qes në votim procesverbalin nga mbledhja e kaluar. Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar procesverbali nga mbledhja e kaluar. Kalojmë në pikën e radhës:
**2. Shqyrtimi i Raportit vjetorë të Auditimit të Brendshëm për vitin 2020.**
**Sead Rama** – Këtë raporte e kamë dorëzuar kryetarit të komunës me datën 31.03.2021, ashtu ka qenë edhe e paraparë që të dorëzohet, besoj që këtë raporte e keni lexuar, keni pasur mjaftë kohë që ta shfletoni dhe të shikoni nëse ka diçka për të shtuar nga ana e juaj. Prandaj nëse keni diçka të shtoni sa i përket këtij raporti ju lutem fjala është e juaja.
**Skender Hamza** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, sa i përket raportit nuk kam diçka të veçantë të shtojë, vetëm desha të ju përgëzoj për përpilimin e këtij raporti, në këtë raporte janë të përfshirë të gjitha ato që janë thënë dhe diskutuar brenda 4 mbledhjeve që janë mbajtur në vitin 2020. Vetëm desha të ju njoftoj se ky raporte do të diskutohet edhe në KPF, po ashtu pastaj në mbledhje të kuvendit, ku ju si kryesues i Komitetit të Auditimit do ta prezantoni.
**Ruzhdi Kabashi** – Përshëndetje për të gjithë, sa i përket raportit të auditimit nuk kam çka të shtojë, por desha vetëm të ndërlidhem tek disa gabime teknike, në vend që të shkruhet Binak Kryeziu është shkruar Binak Berisha, kjo është një gabim teknik dhe besoj se do të përmirësohet.
**Binak Kryeziu** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, në mbledhjen e parë ceket që ka qenë pika Shqyrtimi i raportit të auditorit të brendshëm për zyrën e prokurimit, kjo pikë është shqyrtuar me datën 20.06.2020, e jo siç e keni cekur në raporte ne janar. Por si raporte final është dorëzuar me datën 30.12.2020.

**Sead Rama** – I nderuare unë e kam cekur që takimi është mbajtur me datën 20.06.2020, aty është cekur raporti final i asaj date dhe takimi që është mbajtur me datën 20.06.2020. Por ka mundësi që të ketë edhe gabime, prandaj ne jemi këtu që ti përmirësojmë këto gabime. Nëse nuk ka askush tjetër të shtoj diçka, kalojmë në pikën e radhës.

**3. Shqyrtimi dhe aprovimi i Draft Statutit të Komitetit të Auditimit të Brendshëm.**

**Sead Rama** - Sa i përket Draft Statuti për Komitet të Auditimit, ky draft është i përpiluar për të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, ku pastaj zyra e auditimit të Komunës së Rahovecit i ka plotësuar me të dhënat të cilat i takojnë komunës së Rahovecit. Ju si anëtar të këtij komiteti nëse keni ndonjë koment sa i përket këtij statuti fjala është e juaja.

**Skender Hamza** – I nderuari kryesues ju e ceket që ky drafte është i përgatitur për të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, por shpresoj se ata të cilët i kanë futur të dhënat për komunën tonë të i kenë përfshirë të gjitha ato që është dashur të i përfshij ky statut.

**Ruzhdi Kabashi** – Sa i përket këtij draft statuti, të gjitha informatat që kanë të bëjnë me komunën e Rahovecit janë të inkorporuar, si bazë për të gjitha komunitetet në Republikën e Kosovës është i njëjti, ato nene të cilat nuk kanë të bëjnë me komunën tonë janë eliminuar dhe ajo që është dashur të shtohet është shtuar. Por ajo që është më e rëndësishme është si formë për të gjitha komunat e Republikës së Kosovës është i njëjtë.

**Sead Rama** – Mendoj se si komitet i auditimit që jemi në përbërje prej 5 anëtarëve, mendoj se të gjitha pikat janë të përfshira në këtë statut, pra ajo që ka të bëjë me ne si komitet është e përfshirë, por nëse keni ju diçka të shtoni urdhëroni.

**Ruzhdi Kabashi** – Realisht këtë draft Statut e kanë punuar këshilltarët e auditimit të brendshëm që janë në kuadër të USAID, në bashkëpunim me auditorët e institucioneve të ndryshme, të gjitha këto janë të bazuara në bazë të ligjeve dhe udhëzimit administrativ për themelimin e komitetit të auditimit të brendshëm, prandaj si statut besoj se i plotëson të gjitha kushtet.

**Skender Hamza** – Sa jam duke parë në nenin 11 të këtij statuti ceket se hyrja në fuqi e këtij statuti hynë në datën e mbajtjes së mbledhjes dhe ditën e nënshkrimit, që realisht i bie sot. Kishte me qenë mirë që ky statut së pari të lekturohet nga zyrtarja e lektorimit në komunë, pastaj të nënshkruhet dhe nëse duhet edhe të publikohet në veb faqe të komunës e publikojmë, nëse jo atëherë në rregull jemi.

**Sead Rama** – Besoj se në veb faqe nuk duhet të publikohet sepse llogaritet si diçka e brendshme, por që të jemi më të saktë atëherë besoj se zyrtarët e auditimit e dinë më së miri a duhet apo jo.

**Binak Kryeziu** – Edhe ne si njësi e auditimit të brendshëm e kemi statutin për sektorin tonë, por këtë statut nuk e kemi publikuar.

**Sead Rama** – Mirë atëherë ky statut do të nënshkruhet nga ana ime dhe nga ana e kryetarit dhe do ju shpërndahet edhe juve si anëtar të këtij komiteti. Nëse nuk keni të shtoni diçka sa i përket kësaj pike, kalojmë në pikën e radhës.

**4. Të ndryshme.**

**Sead Rama** – Besoj se ne në vitin 2020 i kemi përmbushur kuotën e mbajtjes së takimeve pra i kemi mbajtur 4 takime.

**Ruzhdi Kabashi** – Kisha propozuar që në takimin e radhës të jetë si pikë e rendit të ditës raporti i njësisë së auditimit për vitin 2020 komplet, ky raporte i përfshin të gjitha raportet edhe ata që janë shqyrtuar, por edhe ata që nuk janë shqyrtuar.

**Sead Rama** – I nderuar besoj se kishte me qenë më mirë të shkojmë ashtu siç kemi shkuar deri më tani për secilën drejtori të shqyrtohen si pika të veçanta, janë edhe 6 raporte dhe i kryejmë për dy mbledhje, arsyeja është se nëse shkojmë me raportin vjetor nuk do të ketë seriozitet dhe nuk do jenë prezent të gjithë drejtorët në mbledhje, vetëm për këtë po e them.

**Binak Kryeziu** – Unë jam i pajtimit me propozimin e z. Ruzhdi Kabashi, të shkojmë me një raport të përgjithshëm dhe ato drejtori që nuk janë audituar të jenë prezent.

**Sead Rama** – Unë mendoj se më mirë është që të shkojmë për secilën drejtori sepse nëse shkojmë siq janë duke propozuar ju do të jetë sa për sy e faqe që thonë, vetëm sa të kalojë, nuk do të jetë shumë serioze, kurse nëse shkojmë për secilin raport atëherë çdo drejtor do i bartë përgjegjësit e veta. Por ju jeni ata që vendosni

nuk jam vetëm unë, ky ishte mendimi imë, por përsëri pajtohem me shumicën. Të nderuar anëtar të Komitetit për Komunitete me kaq përfundon mbledhja e këtij komitetit, ju faleminderit për pjesëmarrje dhe për angazhimin tuaj në këtë takim, shihemi në takimet e radhës.

## 2. Seanca e dytë

Është mbajtur më 25.05.2021 me këto pika të rendit të ditës:

1. **Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
2. **Shqyrtimi i Raportit të auditimit të brendshëm për Drejtorin për Administratës së Përgjithshme;**
3. **Shqyrtimi i Raportit të auditimit të brendshëm për Drejtorin për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale;**
4. **Të ndryshme.**

Të pranishëm ishin: Sead Rama Kryesues i Komitetit të Auditimit, Fllanza Popaj anëtare, Sehad Boshnjaku anëtar, Skender Hamza anëtar, Mirsad Shala anëtar, Ruzhdi Kabashi Auditor i Njësisë së Auditimit.
Në këtë takim, po ashtu ishin prezent, Drejtori për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, Z.Samir Mustafa dhe Zyrtari Ardian Rama.

**Sead Rama** – Të nderuar, shpresoj se jeni të gjithë të pajtimit me këtë rend dite, konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parët ë rendit të ditës:
**1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**
A ka dikush të shtojë diçka ose të jep ndonjë vërejtje sa i përket procesverbalit nga mbledhja e kaluar, nëse jo atëherë e qes në votim procesverbalin nga mbledhja e kaluar. Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar procesverbali nga mbledhja e kaluar. Kalojmë në pikën e radhës:
**2. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të brendshëm për Drejtorin për Administratës së Përgjithshme; .**
**Sead Rama** – Të nderuar pika e dytë e rendit të ditës do të shtyhet për ndonjë takim tjetër, arsyeja është se drejtoresha për administratë sot nuk gjendet këtu. Para se të kalojmë në pikën e radhës, fjalën e kërkon z. Sead Boshnjaku.
**Sead Boshnjaku** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, të nderuar anëtar të Komitetit të Auditimit, me datën 29.04.2021, është mbajtur mbledhja e kuvendit, ku në rend dite ka qenë edhe Raporti i punës së Komitetit të Auditimit për vitin 2020. Në këtë mbledhje në mungesë të kryesuesit të Komitetit të Auditimit këtë raport e kam prezantuar unë me pajtimin e kryesuesit dhe gjithë juve si anëtar të këtij komiteti, por arsyeja pse e mora unë fjalën është se anëtarët e kuvendit të komunës kanë pas vërejte sa i përket këtij raporti, ku sipas tyre ky nuk ka qenë raporte por hiq ma shumë se një procesverbal. Prandaj kërkoj si nga ky komitet poashtu edhe nga auditorët e brendshëm që ky raporte të jetë sa më i kapshëm për kuvendar, mua më është dukur si një lloje përqeshje nga ana e kuvendarëve me këtë raport. Poashtu mua ky takim me duket jo shumë serioz, arsyeja është se nëse auditorët e jashtëm e kanë kryer auditimin për vitin 2020, pse ne tani duhet të flasim për raportin e viti 2020, kur kjo punë vetëm është kryer nga auditorët e jashtëm.

**Ardian Rama** - Zyrtar nga Drejtoria e Shëndetësisë – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, i nderuar ky raporte është nga muaji janar e deri në muajin shtator 2020, nuk e përfshinë komplet vitin.
**Sead Rama** - I nderuar edhe ashtu ne nuk mundemi që në vitin aktual ta shqyrtojmë raportin e këtij viti, gjithmonë shqyrtohet raporti i viti të kaluar, por ju keni të drejtë sa i përket asaj që thoni se është gjysmak.
**Skender Hamza** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha vetëm të ndërlidhem me atë që e tha kolegu z. Sead Boshnjaku rreth shqyrtimit të raportit në kuvend, nuk isha me thanë se është bërë ndonjë përqeshje, por ata vetëm kanë bërë si vërejtje se ky raporte ka të përfshirë shumë pjesë të procesverbalit dhe është shumë voluminoz, sipas tyre është dashur të jetë më i shkurtër ku do të përfshiheshin, pastaj puna e kuvendarëve është që të na japin neve vërejtje dhe lavdata.
**Sead Rama** – Në këtë raporte më shumë janë përmbledhur pjesët e procesverbalit sepse ato gjëra janë diskutuar, arsyeja pse e kam bërë ma voluminoz është sepse me qenë raporti me ma shumë informata dhe të shihet se çka është punuar nga ana jonë si komitet. Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës.

**3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të brendshëm për Drejtorin për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.**

Objektivat e këtij auditimi kanë qenë:
1.Inkasimi dhe realizimi i të hyrave;
2.Taksat për shërbime shëndetësore nga participimi
3. Tarifa për sektorin e QPS-së,
4. Shpërndarja e barnave esenciale.
5. Menaxhimi i automjeteve në bazë të udhëzimit që është në fuqi dhe
6. Mirëmbajtja e dosjeve të punëtorëve.

Do të ndalesha tek objektivat e këtij auditimi e ato janë, inkasimi dhe realizimi i të hyrave, taksat për shërbime shëndetësore nga participimi, tarifa për sektorin e QPS-së, shpërndarja e barnave esenciale, menaxhimi i automjeteve në bazë të udhëzimit që është në fuqi dhe mirëmbajtja e dosjeve të punëtorëve.
Inkasimi dhe realizimi i të hyrave nga participimi, do të flasë në pika të shkurtra, konkluzioni i kësaj është: Mos mbajtja e shënimeve për të hyrat në regjistrin të njësive vartëse dhe procesimi aktual i informatave për të hyrat, krijon mundësin që këto të hyra të mos raportohen drejt. Po ashtu, është e rëndësishme që të hyrat e mbledhura me vonesë në llogari të DSHMS, jo në pajtim me rregullat e përcaktuara. Rekomandimi – 1, rekomandojmë DSHMS-në të sigurojë që plani i të hyrave është i bazuar në analiza dhe vlerësime të saktë, nga njësiti vartës që i grumbullojnë ato, për të përmirësuar nivelin e realizimit të tyre. Identifikimi dhe regjistrimi në librin e protokollit, konkluzioni, dobësitë e identifikuara vështirësojnë menaxhimin adekuat në regjistrimin e të gjitha pacienteve, metodat e aplikimit në SISH-it, në kushtet e tilla, i ekspozojnë rrezikut që SISH-i, mos të funksionojë. Rekomandimi numër 2, rekomandojmë drejtorin e audituar të sigurojë se subjektet përgjegjëse konkretisht (QKMF, QMF dhe AMF), të krijojnë mekanizma të duhura dhe të qëndrueshme, që të funksionalizohet SISH-i, në tërësi, për të pas të dhëna të sakta për të gjithë pacientet. Mekanizimi dhe shpërndarja e barnave esenciale, konkluzioni, procesi i parashtrimit të kërkesave për barna megjithëse pretendohet se ishte i organizuar në periudha të rregullta, formacioni i mbledhur gjatë auditimit tregon se SISH-i nuk ka funksionuar siç kërkohet. Rekomandimi numër 3 – Rekomandojmë DSHMS, të forcojë funksionimin e SISH-it, në mënyrë që të nxirën të dhënat e sakta për ti nxjerr raportet periodike dhe vjetore që të kryhen auditimi në mënyrë të rregullt. Pas kësaj vije Menaxhimi i bllok dëftesave, Konkluzioni – Mos realizimi i barazimeve mujore në mes të drejtorisë komunale me zyrtarin e të hyrave rrezikon devijime te caktuara në kontrolle të brendshme duke shkaktuar mangësi të informacionit në kohë, mbi llojet dhe shumat e të hyrave. Rekomandimi numër 4 – Rekomandojmë DSHMS-në që të sigurojë se barazimet dhe

harmonizimet në mes të arkës dhe zyrtarit që krijon të hyra të kryhen në baza të rregullta mujore dhe vjetore, të gjitha mospërputhjet e mundshme të sqarohen me kohë.
Mangësi në deponimin e parasë së gatshme në llogari bankare. Konkluzioni për këtë është: Parregullsitë e tilla munden të risin rrezikun e humbjes apo keqpërdorimin e parasë së gatshme. Rekomandimi numër -5, rekomandojmë QPS-në që të sigurojë monitorim përmes menaxherit të financave për të siguruar se parat e gatshme të arkëtuara nga ofrimi i shërbimeve të deponohen në llogarinë bankare, në shumën mbi 10 €.
Mirëmbajtja e dosjeve të punëtorëve në zyrën e personelit – QKMF-ja nuk ka arritur të vendos kontrolle adekuate sa i përket menaxhimit në mirëmbajtjen e dosjes së punëtoreve. Gjatë rishikimit të dosjeve personale nuk është respektuar vendimi në fjalë, në disa dosje, kishte mungesa të dokumenteve personale.
Menaxhimi i automjeteve – të gjeturat, gjatë ekzaminimit është gjetur, zyrtari për menaxhimin e automjeteve, evidencën për shfrytëzimin e automjeteve e mbanë në letër të bardhë në formë manuale, gjatë intervistimit, zyrtari deklaron se nuk ka asnjë pajisje elektronike për ti futur të dhënat.
Konkluzioni – Janë vërejtur veprime të mangëta të kontrollit e cila është çështje e menaxhimit për përmirësime të rëndësishme ku është kërkuar veprime të menjëhershme përmirësuese për tu mbrojtur në mënyrë adekuate kundrejt ekspozimit.
Rekomandimi numër – 6 - Rekomandojmë që drejtoria e audituar që mirëmbajtja e dosjeve të jetë sipas procedurës zyrtare dhe zyrtari i autoparkut të mbajë evidencë në pajisje elektronike. Ky ishte elaborimi në pika të shkurtra sa i përket raportit të auditimit për drejtorin e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale.
**Mirsad Shala** – Përshëndetje për të gjithë, desha të ndalem në fillim të faqja e parë në këtë raport, tek preambulë, këtë vërejtje e kam pasur edhe në raportet e tjera, disa ligje dhe rregullore ku bazohen auditorët e brendshëm janë të bazuara gabimisht, sepse janë jashtë fuqisë. Ligji i procedurës administrative që është i cekur këtu është i shfuqizuar, është ligji i ri i procedurës administrative 05 L/031. Pastaj ligji për menaxhimin e financave publike 02L/016 poashtu i shfuqizuar, tani në fuqi është ligji për financat publike 03 L/048. Pastaj rregullat financiare dhe udhëzimet e thesarit 02 shpenzimi i parasë publike është i shfuqizuar, tani është në fuqi 01/2013 që buron nga Ministria e financave, të gjitha këto janë në gazetën zyrtare.. pastaj në faqe nr.3, tek pika 3.1.1 inkasimi i të hyrave nga participimi, ceket se gjendja e raporteve për të hyrat në mes të drejtorisë dhe thesarit ishte e harmonizuar, megjithëse me disa vërejtje të dobëta. Por në funde është gjetur edhe si çështje tek rekomandimi në mangësi në barazimin e të hyrave, pyetja ime është se cila prej këtyre është e saktë.
**Samir Mustafa** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, sipas asaj që e tha zyrtari ligjor, i bie që komplet ky raporte që është audituar nga auditorët e brendshëm të jetë gabim dhe në kundërshtim me ligjin. Kjo i bie që auditorët e brendshëm nuk kanë ditur ku të bazohen, janë bazuar në ligjet që janë jashtë fuqie, nuk e di se sa është tani e arsyeshme që ne të debatojmë rreth këtij raporti. Por tjetra të gjitha ato rekomandime që ne si drejtori i kemi marrë nga auditorët, jemi duke u munduar maksimalisht që ti përmirësojmë dhe të zbatojmë. Sa i përket problemit me SISH-in, kjo duhet që kemi probleme, por nuk është në kompetencën e DSHMS – së, kjo është përgjegjësi e Ministrisë së Shëndetësisë, ka përmirësime të dukshme sa i përket SISH-it në QKMF. Sa i përket të hyrave, inkasimit dhe barazimit, kemi probleme teknike mes qendrës së mjekësisë familjare, pastaj AMF-të, realisht sipas rregullores çdo ditë pas orarit të punës zyrtari për që bënë inkasimit nga çdo AMF duhet të vije të barazohet, por kjo është për momentin e pamundur.

## 3. Seanca e tretë

Është mbajtur më 17.09.2021 me këto pika të rendit të ditës:

1. **Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
2. **Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të jashtëm për vitin 2020;**
3. **Shqyrtimi i Raportit final të Zyrës së prokurimit;**
4. **Shqyrtimi i Raportit të drejtorisë për Inspektim;**
5. **Të ndryshme.**

Të pranishëm ishin: Sead Rama kryesues, Blerina Kabashi anëtare, Sehad Boshnjaku anëtar, Skender Hamza anëtar, Mirsad Shala anëtar, Ruzhdi Kabashi nga Njesisa e Auditimit. Në këtë takim ishin prezent Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa z.Afrim Limani dhe Drejtori i Sherbineve Publike Z.Perparim Krasniqi.

**Sead Rama –** Të nderuar, e qes në votim rendin e ditës: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parët të rendit të ditës:

1. **Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**

A ka dikush të shtojë diçka ose të jep ndonjë vërejtje sa i përket procesverbalit nga mbledhja e kaluar, nëse jo atëherë e qes në votim procesverbalin nga mbledhja e kaluar. Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar procesverbali nga mbledhja e kaluar. Kalojmë në pikën e radhës:

**Të nderuar anëtar të komitetit të auditimit, pasi që pika e dytë e rendit të ditës është më voluminoze, pikën e tretë dhe të katërt nëse jeni të pajtimit e heqim nga rendi i ditës, këto dy pika i lëmë për mbledhjen e radhës.**

2. **2. Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të jashtëm për vitin 2020.**

Përmbajtja e raportit të auditorit të jashtëm përmban:

- opinionin e auditimit,

-gjetjet dhe rekomandimet,

- informacioni i përmbledhur për planifikim dhe realizimin e buxhetit dhe progresi në zbatimin e rekomandimeve.

Opinioni i auditimit ka përfunduar me datën 31.12.2020, me përpurthje me ligjet në fuqi të auditimit dhe standardet ndërkombëtare. Sipas opinionit, pasqyrat financiare vjetore të komunës së Rahovecit, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtet në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit për sektorin publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme. Baza për konkluzion kemi B1 ceket se në 1321 pagesat në vlerë totale prej 2,661.959 € ishin realizuar pas afatit kohor ligjor prej 30 ditësh. B2 ceket se pagesat për raporte detaje të pranimit për kryerjen e shërbimeve, angazhimeve në vlerë 86,431.00 €. Tek B3 ceket se në katër raste ishin nënshkruar kontrata për projekte kapitale në vlerë 650,887.00 €, derisa nuk kanë pasur mbulueshmëri financiare. B4 ceket se Mangësi në menaxhimin e të hyrave nga tatimi

në pronë. Kalojmë tek çështja B1- Vonesat në pagesat e faturave, nga analiza e bazës së furnitorëve janë identifikuar se në 1321 raste pagesat në vlerë totale 2,661.959 €, ishin realizuar pas afatit kohorë ligjore prej 30 ditësh, vonesat varijojnë nga një muaj deri në 5 vite. Kjo ishte ajo që kam pasur unë të shtoj në pika të shkurtra, nëse keni diçka të shtoni ju fjala është e juaja. Por një gjë duhet të keni parasysh, ky raport është vlerësuar nga auditorët si raport më i mirë që ka pasur Komuna e Rahovecit.
**Afrim Limani** – Përshëndetje për anëtarët e Komitetit të Auditimit, të nderuar ky raport në përgjithësi i takon drejtorisë për financa, ne jemi në dijeni të plotë se si ka kaluar i gjithë ky proces. Desha të ju japë disa informata që ju të keni më lehtë, pra të keni një orientim për nxjerrjen e një konkluze. Auditimi i pasqyrave financiare të komunës së Rahovecit për vitin 2020, opinioni i zyrës kombëtare të auditimit të jashtëm ka qenë i pa modifikuar pa theksim të çështjes, pra kjo i bije që historikisht ky është njëri nga raportet më të mira që ka pasur komuna e Rahovecit. Ajo që e dallon këtë raport nga vitet e tjera është që ka dalur pa theksim të çështjes sepse viteve tjera kemi pasur raport i pamodifikuar por me theksim të çështjes. Pastaj ajo që e bënë më të mirë këtë raport në krahasim me raportet të viteve të kaluara është se rekomandimet nga viti në vite janë duke u zvogëluar, në vitin 2018 kemi pasur 21 rekomandime, 2019 kemi pasur 14 rekomandime, kurse në vitin 2020 janë 12 rekomandime. Shumica nga rekomandimet e vitit 2020 mund të zbatohen nëse i qasemi me një vullnet dhe përkushtim më të madh. Ne si ekzekutiv e kemi formuar menjëherë një komision për zbatimin dhe implementimin e rekomandimeve që kanë dalë nga zyra kombëtare e auditimit, ky komision i ka mbajtur dy takime, në njërin ka qenë prezent edhe vetë kryetari i komunës, drejtorët janë zotuar që do ti zbatojnë këto rekomandime. Në kuadër të drejtorisë për financa dhe buxhet janë dhënë disa rekomandime, ku besoj se këto rekomandime deri ka muaji tetor i këtij viti do të zbatohen, por ka edhe disa rekomandime që janë vështirë për tu zbatuar. Por ajo që është shumë e rëndësishme është që ne në raportin e ardhshëm të dalim së paku me 50% të rekomandimeve të zbatuara.
**Skender Hamza** – Përshëndetje për gjithë të pranishmit, siç e dimë në raportin e vitit 2020 janë dhënë 12 rekomandime, pyetje ime është cilët nga këto 12 rekomandime janë rekomandime të pazbatueshme nga ana e komunës, kemi raste kur kemi rekomandime që komuna nuk ka mundësi të i zbatoj, janë rekomandime të dhënë vite pas viti.
**Afrim Limani** – Janë dy rekomandime, e para është pa mbulueshmërija financiare e projekteve kapitale, pe marrë një shembull, supozojmë se kemi lidhur kontratë me vlerën prej 1 milion €, në vitin e parë mundësitë e komunës janë që këtë projekt ta buxheton në shumën prej 200 mijë €, por ne këtë buxhet e kemi planifikuar në projeksione edhe për 2 vite tjera pasuese, ne e zbatojmë ligjin dhe nuk dalim jashtë kornizës buxhetore, por për auditorin ky projekt duhet të financohet së paku me 50%. Pastaj si rekomandim tjetër është vonesa në pagesat e faturave, kjo është një dukuri e cila përsëritet shpesh, realisht këtë ne mundemi të zvogëlojmë por kurrsesi ta eliminojmë. Kurse rekomandimet të tjera nëse i përvëlimi punës besoj se do të zbatohen.
**Përparim Krasniqi** – Përshëndetje për të gjithë, rekomandimet të cilat i kanë përfshirë drejtorin e shërbimeve publike janë mungesa e financave në projektet kapitale, për këtë rekomandim zakonisht përgjigjet kryetari i komunës, për arsye se kryetari i komunës është ZKF dhe detyra e tije është që të sigurojë fondet publike për çdo projekt kapital. Rekomandimi është për të gjitha drejtoritë që mos të ja fillojnë projektet në vlera të mëdha, por duhet të bëjë në bazë të kapaciteteve buxhetore që i ka.
**Blerina Kabashi** - Përshëndetje për të gjithë, nëse këto kontrata i nënshkruani ju, pse këto kontrata nuk kryhen në afatin kohorë ashtu siç është e përcaktuar në kontratë.
**Përparim Krasniqi** – Pikërisht ky ka qenë edhe rekomandimi i zyrës së auditorit, pra projektet kapitale të nënshkruhen në bazë mundësive buxhetore që i ka komuna, ne shumicën e projekteve i kemi me afat 3 vjeçar për arsye se ne si komunë nuk kemi mundësi një projekt të mbulojmë për një vite, por ajo që është më kryesore është se komuna e Rahovecit nuk i shkelë projeksionet buxhetore që i ka të planifikuara për 3 vitet e arshme.
**Blerina Kabashi** – Kush i merë përgjegjësitë për këto vonesa, kemi një kontratë ndërtimi i kompleksit përkujtimor, i cili është dashur të kryhet në vitin 2014, kurse ne tani jemi në vitin 2021 dhe ende kjo kontratë nuk është e përfunduar.
**Përparim Krasniqi** - Ky projekt ka qenë në kuadër të drejtorisë së urbanizmit, në vitet 2017, nuk janë siguruar fondet për realizimin e këtij projekti, pra e kanë stopuar, por në momentin që ne kemi ardhur në

qeverisje, e kemi bërë një arsyetim dhe i kemi ndarë mjetet për përfundimin e këtij projekti dhe tani ky projekt është përfunduar.

**Mirsad Shala** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha të ndërlidhem tej çështje C3 mangësitë në funksionimin e zbatimit të rekomandimeve të njësisë së auditimit të brendshëm, zakonisht ky rekomandim është për çdo vit, duhet që njësia e auditimit të brendshëm së bashku me zyrtarin kryesor financiar të ndërmarrin masa që këto rekomandime të mos na vinë për çdo vit. Poashtu njësia e auditimit të brendshëm duhet të fokusohet në vitet aktuale e jo e jo të bëjnë auditime për vitet e kaluara. Poashtu drejtorët duhet të i marrin më seriozisht rekomandimet e auditorëve dhe të i përmbushin ato që kanë mundësi dhe mos të në vinë në vitet e tjera të njëjtat rekomandime.

**Skender Hamza** – Tek rekomandimet që janë dhënë e shohë edhe një rekomandim për pasurit e luajtshme, pra rekomandimi 11, sa e di unë pasuritë e luajtshme regjistrohen për çdo vite nga një komision i cili është i formuar, pse ka dalur si rekomandim në këtë vit.

**Afrim Limani** – Sa i përket rekomandimit 11 mos regjistrimi i pasurive të luajtshme, zakonisht ne kemi kaluar mirë, në vitin 2018 ne jemi shpallur edhe komuna më e mirë në nivel vendi. Por në vitin 2020 është formuar një komision për regjistrimin e inventarit në shkolla dhe institucionet e tjera publike, por fatkeqësisht ky komision nuk e ka kryer punën deri në fund, sipas tyre kanë ngelur edhe disa shkolla pa e përfunduar regjistrimin dhe në bazën e këtij raporti ka ndikuar që auditorët e jashtëm të japin rekomandim.

**Skender Hamza** – Arsyeja pse e ceka këtë rekomandim është sepse qe 8 vite që jam duke punuar në komunë e di që jemi ballafaquar me këtë rekomandim para vitit 2018, kurse që nga viti 2018 siç e tha drejtori ky rekomandim nuk ka ekzistuar, mua më ra në sy pse tani në vitin 2020 është rikthyer, drejtori e dha përgjigjen e falënderoj.

**Mirsad Shala** – Sa i përket rekomandimit 11 ka qenë pak edhe neglizhencë e drejtorisë për ekonomi dhe zhvillim, sepse këtu ceket që komuna edhe përkundër rekomandimeve të viteve paraprake ende nuk e ka aprovuar rregulloren e brendshme për menaxhimin e pasurisë. Drejtoria për ekonomi dhe zhvillim pas këtij rekomandimi është dashur të propozoj aprovimin rregullores për menaxhimin e pasurisë.

**Sead Boshnjaku** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, do të kyçem edhe unë tek pasuritë kapitale sepse më ra në sy pjesa e mbajtjes së regjistrit me Excell, drejtori e ceku që zyrtari nuk ka qenë i përgatitur që ta mbajë regjistrin e pasurive kapitale, Mirsadi e përmendi që duhet të propozohet një rregullore nga drejtoria për ekonomi dhe zhvillim. Unë kisha propozuar që të propozohet një rregullore për jetësimin e pasurive kapitale, pastaj këto pasuri kur të dalin në shitje në ankand të kenë një vlerë e cila ja mbulon së paku shpenzimet e komunës.

**Sead Rama** - Desha vetëm të ndërlidhem tek rekomandimi Nr.1, ku ceket që komuna të mos hy në obligime pa fonde të mjaftueshme, mendoj se kishte me qenë mirë që faturat të paguhen brenda afatit kohorë, arsyeja është se nëse këto fatura nuk paguhen me kohë, kjo i kushton komunës sepse të gjitha ato fatura shkojnë pastaj përmes përmbaruesit. Mendoj s ky rekomandim mundet shumë lehtë të zbatohet nga ana e komunës.

**Skender Hamza** – Si rekomandim i imi kishte me qenë që drejtoritë të cilat i kanë rekomandimet nga auditori i jashtëm, të i marrin më seriozisht dhe aty ku kanë mundësi të i kryejnë detyrat e tyre, mire e tha edhe drejtori i financave nëse ka vullnet disa rekomandime do të eliminohen për vitin e ardhshëm. Ne jemi duke parë që për çdo vite komuna jonë ka më pak rekomandime nga ana e auditorët e jashtëm, kjo falë angazhimit, prandaj shpresoj se në raportin e vitit të ardhshëm do të kemi shumë më pak rekomandime.

**Sead Rama** – Pajtohem plotësisht me ju i nderuar, ky le të jetë edhe rekomandim ose konkluzion nga mbledhja e sodit. Nëse nuk ka askush nga ju që të shtojë diçka me kaq e mbyllim këtë takim, shihemi në takimet e radhës.

## 4. Seanca e Katërt

Është mbajtur më 18.11.2021 me këto pika të rendit të ditës:

1. **Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
2. **Shqyrtimi i Raportit të brendshëm për Zyrën e prokurimit;**
3. **Shqyrtimi i Raportit të brendshëm për drejtorisë për Inspektim;**
4. **Shqyrtimi i Raportit të brendshëm për drejtorin Komunale të Arsim;**
5. **Të ndryshme.**

Të pranishëm ishin: Sead Rama kryesues, Blerina Kabashi anëtare, Sehad Boshnjaku anëtar, Skender Hamza anëtar, Mirsad Shala anëtar, Ruzhdi Kabashi i Njësisë së Auditimit. Në këtë takim ishin prezent Drejtori i Drejtorisë për drejtorisë për Inspektim z.Besnik Hoti.

Në këtë takim kanë diskutuar; Sead Rama, Kryesues i Komitetit, Blerina Kabashi Anëtar i Komitetit, Sehad Boshnjaku, Anëtar i Komitetit, Skender Hamza, Anëtar i Komitetit, Mirsad Shala, Anëtar i Komitetit, Drejtori i Drejtorisë për drejtorisë për Inspektim z.Besnik Hoti.

**Sead Rama –** Të nderuar, e qes në votim rendin e ditës: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parët ë rendit të ditës:

**1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**
A ka dikush të shtojë diçka ose të jep ndonjë vërejtje sa i përket procesverbalit nga mbledhja e kaluar, nëse jo atëherë e qes në votim procesverbalin nga mbledhja e kaluar. Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar procesverbali nga mbledhja e kaluar. Kalojmë në pikën e radhës:

**2. Shqyrtimi i Raportit të brendshëm për Zyrën e prokurimit.**
Të nderuar anëtar të komitetit të auditimit, zyrtari i prokurimit nuk na ka ardhur në mbledhje, ne nuk e di se me kënd do të diskutojmë, besoj se nuk është serioze kjo edhe pse emailin e ka pranuar një javë para, por siç po shihni edhe ju ai nuk është prezent në mbledhje, mua nuk më ka dhënë asnjë arsyetim për mungesën e tije në këtë mbledhje. Prandaj kalojmë në pikën e radhës:

**3. Shqyrtimi i Raportit të brendshëm për drejtorisë për Inspektim.**

Fushëveprimi dhe objektivat e këtij auditimi janë periudha janar – nëntor të vitit 2020, duke përfshirë të gjitha dokumentacionet që kanë të bëjnë me identifikimin e të hyrave, aktvendimet, regjistrimet, evidentimet, raportet dhe barazimet.
Objektivat janë:
-menaxhimi dhe realizimi i të hyrave,
-aplikimi i taksës komunale,
-planprogramet e punës,
-raportet periodike dhe vjetore
-dhe evidentimi i inspektimeve,
- aktvendimeve,
-pëlqimeve dhe fletëparaqitjeve.

Konkluzioni, inkasimi i të hyrave që nuk bazohet në bazë të rregullores, ndikon në uljen e barazimit në të hyra. mos planifikimi i mirëfilltë dhe jo i caktuar sipas taksës komunale, ndikon në shfaqjen e diferencave dhe rrit rrezikun e humbjes apo edhe keqpërdorimin e parasë së gatshme. Rekomandimi -1, rekomandojmë Drejtorin për Inspektim të eliminoj dobësitë e identifikuara dhe të mbikëqyrë në baza të rregullta zbatimin e Rregullores, duke mundësuar shtimin në inkasim në të hyra. Çështja -2, ka të bëjë me mangësitë e identifikuara në inkasimin e të hyrave. Konkluzioni, mangësitë e identifikuara e vështirësojnë inkasimin e drejtë të të hyrave, gjithashtu kjo do të ndikonte në mbledhjen më të ulët të të hyrave që reflekton me më pak fonde për të realizuar objektivat komunale. Rekomandimi -2, rekomandojmë që Drejtoria për Inspektim të shtojë kontrollet në mënyrë që të gjitha të hyrat të realizohen sipas nenit 36 të Rregullores 01 Nr.80/20 dhe të hyrat të inkasohen në kohën e duhur. Të nderuar anëtar të këtij komiteti, fjala është e juaja. Nëse nuk keni ju çka ët shtoni do isha kyçë unë përsëri, tek çështja 1, tek mangësitë e planifikimit, regjistrim dhe realizimin e taksave, të gjeturat sipas tabelës, taksat komunale tek tabela një është paraqitur se Inspektimet të ndryshme me kërkesën e peronave fizik, ka edhe disa takse tjera të cekura në këtë tabelë, por nuk do i ceki të gjitha. Në bazë të raportit financiar të zyrtarit kryesor të të hyrave ishin planifikuar: taksa administrative për fletëngarkesë, të planifikuara 1,000.00 €, të realizuara 1,200.00 €, gjobat nga inspektorati të planifikuara 1.000.00 €, të realizuara 185.00 €, licenca e pranimit teknik të lokaleve, të planifikuara nuk ka, realizim 490.00 €, inspektimi higjienik sanitar, planifikim nuk ka pasur, realizim 30.00 €. Ky raport nuk ka pasur shumë rekomandime vetëm dy kanë qenë, por mirë kishte me qenë që ta diskutojmë.

**Skender Hamza** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë, desha vetëm të kyçem sa i përket drejtorisë së inspektimit, tek sektori i uzurpimit të trotuareve, kishte me qenë mirë që drejtoria e inspektoratit të bëjë një planifikim për vitin e ardhshëm që të bëjë sa më shumë kontrolle, pra të merën masa nga kjo drejtori për lirim të trotuareve. Kishte me qenë mirë që si komitet të dalim me një konkluzë që drejtoria e inspektoratit të gjithë ata pronarë të lokaleve që nuk i respektojnë vendimet e inspektoratit të gjobiten sipas ligjeve në fuqi. Mendoj se janë bërë shumë inspektime por gjoba ka shumë pak, nuk e besoj se e kemi aq mirë gjendjen që mos të gjobiten.

**Sead Rama** – Poashtu edhe unë desha të dalë aty sepse me të vërtet janë bërë shumë inspektime sa e kam vërejtur gjatë elaburimit të materialit, por siç e thatë shumë pak gjoba janë dhënë, prandaj edhe unë jam i mendimit me ju z. Hamza që të gjobiten ato biznese që nuk e respektojnë rendin dhe ligjin.

**Besnik Hoti, Drejtori i Drejtorisë për Inspektim** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, shumë me vend e ka ngritur këtë shqetësim z. Skender Hamza, por ekspozimi i mallit e ka një leje e cila merret nga Drejtoria për Shërbime Publike, inkasimi i taksës shkon po në këtë drejtori. Por tejkalim i lejes është problematikë e cila neve na shfaqet dhe me plotë të drejtë qytetarët ankohen pastaj për uzurpim të trotuareve. Kurse sa i përket gjobave, ne nuk i shqiptojmë por të gjitha lëndët i dërgojmë në gjykatë, pastaj është në kompetencën e tyre që të vendosin. Sipas informatave që i kemi shumica e lëndëve janë parashkruar.

**Sead Rama** – I nderuari z. Drejtor, kishte me qenë mirë që të merrni më shumë informata pse këto lëndë të parashkruhen, a keni bërë ju ndonjë kërkesë ndaj gjykatës që të ju tregoj se cilët lëndë janë zgjidhur dhe cilat janë parashkruar.

**Besnik Hoti** – Nuk kam ndonjë informatë kështu të saktë, por të gjithë e dimë se sa të s'ter ngarkuara janë gjykatat tona me lëndë të ndryshme, poashtu desha të ju tregoj se secilit inspektor për lëndët e tyre ju ka ardhur një njoftim që ka parashkrim absolut të lëndës dhe nuk janë shqiptuar gjobat.

**Blerina Kabashi** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, mendoj se kishte me qenë më mirë nëse do ja kishin dhënë një afat për pagesë 1-3 muaj për pagimin e gjobës se sa të dërgohen lëndët në gjykatë.

**Besnik Hoti** – Të nderuar ne lëndët i dërgojmë në gjykatë, ne si inspektorat nuk i përcaktojmë gjobat, por i dërgojmë në gjykatë, pastaj ajo është në kompetencat e gjykatësit a duhet apo jo të i shqiptohet gjoba.

**Skender Hamza** – Për fund mendoj se do të duhej ne si komitet të i përkrahim rekomandimet dhe konkluzionet e dala nga zyra e auditimit të brendshëm.

**Sead Rama** – Ne do të kemi një takim të posaçëm sa i përket konkluzave dhe rekomandimet e dala nga zyra e auditimit të brendshëm, sa nga ta janë respektuar nga drejtoritë komunale, sa ju kanë përgjigjur zyrës së auditorit etj.

**Sead Boshnjaku** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, një e gjetur e cila është tek sektori i tregut, ku janë cekur këtu gjobat, mendoj se duhet të ketë më shumë vetëdijesim të qytetarëve, bizneseve etj. Pastaj një vizitë nga ana e inspektoratit që ti njoftojë një herë se nëse nuk respektohen vërejtjet e tyre atëherë herrave tjera do shkohet me gjoba, nëse shkohet menjëherë me gjoba mendoj se nuk do të jetë mirë vetëm sa irritohen bizneset dhe ma merr mendja edhe ngarkohen. Tek sektori i tregut, gjatë rishikimit kërkesa për rishikim pune tabela 1 numër rendor 3, ku sektori i tregut kishte lëshuar 51 pëlqime pune, kurse inkasimi i të hyrave nuk është kryer në kodin e dedikuar. Drejtor si rekomandim i imi personal dhe besoj edhe i komitetit të auditimit, të shikosh se ku derdhen mjetet e drejtorisë tënde, pra në cilin kodë janë derdhur.
**Besnik Hoti** – I nderuar edhe unë të ju them të drejtën kam menduar që këto mjete nuk shkojnë në kodin adekuat që e ka drejtoria, por nga të hyrat që mi ka prezantuar drejtori i financave e kam parë që mjetet janë duke shkuar në drejtorit përkatëse si Drejtorin për Zhvillim Ekonomik dhe disa drejtori të tjera, por sa i përket kësaj të gjeture unë sapo të dalë nga këtu do të konsultohem me personat përgjegjës.
**Sead Rama** – Ju falënderojmë drejtor, kalojmë në pikën e radhës:
**4. Shqyrtimi i Raportit të brendshëm për drejtorin Komunale të Arsim.**
Të nderuar siç jeni duke parë edhe drejtori i DKA-së, ose ndonjë zyrtar nga kjo drejtori nuk janë prezent në mbledhje, siç e ceka dhe më lartë kjo nuk është aspak mirë dhe aspak serioze. Unë për vete nuk kam çka të diskutoj pasi që ata nuk janë prezent.
**Skender Hamza** – I nderuari kryesues ne si komitet duhet të dalim me një konkluzion që i përkrahim rekomandimet e dala nga zyra e auditimit të brendshëm sa i përket auditimit të DKA-së.
**Kryesuesi** – Pajtohem plotësisht, pra konkluza e dalë nga z. Hamza është edhe konkluzë e komitetit të auditimit. Kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës.
**5. Të ndryshme.**
A ka dikush të shtoj diçka sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, nëse jo atëherë unë për sot e mbylli mbledhjen, shihemi në mbledhjen e radhës.

## 5. Seanca e Pestë

Është mbajtur më 03.12.2021 me këto pika të rendit të ditës:

1. **Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
2. **Shqyrtimi i Raportit të brendshëm për drejtorin e Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë;**
3. **Shqyrtimi i Raportit të brendshëm për drejtorin e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale;**
4. **Të ndryshme.**

Të pranishëm ishin: Sead Rama Kryesues i Komitetit të Auditimit, Blerina Kabashi anëtare, Sehad Boshnjaku anëtar, Skender Hamza anëtar, Mirsad Shala anëtar, Ruzhdi Kabashi Auditor i Njësisë së Auditimit.
Në këtë takim, po ashtu ishin prezent, Drejtori i Drejtorisë Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë.

**Sead Rama** – Të nderuar, e qes në votim rendin e ditës: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parët ë rendit të ditës:

**1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**
A ka dikush të shtojë diçka ose të jep ndonjë vërejtje sa i përket procesverbalit nga mbledhja e kaluar, nëse jo atëherë e qes në votim procesverbalin nga mbledhja e kaluar. Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar procesverbali nga mbledhja e kaluar. Kalojmë në pikën e radhës

**2.Shqyrtimi i Raportit të brendshëm për drejtorin e Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë;**

Qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit, qëllimi i auditimit është që të kryhet një auditim i cili do ju afrojë menaxhmentit të drejtorisë, informata të dobishme rreth operacioneve dhe efikasitetin që operon. Komunikimi i hapur me ju është i rëndësishëm për suksesin e auditimit. Fushëveprimi i auditimit është periudha janar – shtator e viti 2021, duke përfshirë të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me identifikimin e të hyrave, aktvendimet, regjistrimet, evidentimet, pagesat dhe barazimet. Objektivat e këtij auditimi janë: inkasomi dhe realizimi i të hyrave, barazimi dhe harmonizimi i të hyrave në raport me zyrtarin e të hyrave vetanake dhe taksat për shërbime pronësore sipas Udhëzimit Administrativ MMPH-Nr. 08/2014.
Çështja -1, mangësitë në planifikimin dhe realizimin e të hyrave. Konkluzioni, planifikimi i të hyrave në ulje ndaj viti paraprak, departamenti i buxhetit nuk është bazuar në analiza të mirëfillta, duke mos marrë në konsiderim edhe trendin historik, që ka ndikuar në shfaqjen e diferencave në mes planifikimit dhe realizimit. Rekomansimi -1: rekomandojmë DKGJP, që ti sigurojë departamentit buxhet me rastin e planifikimit të të hyrave, që të merr parasysh të gjitha informacionet relevante, përfshirë edhe planifikimin e të hyrave gjatë viteve paraprake, që të ketë efekt në realizimin e të hyrave. Çështja – 2, mos barazimi i të hyrave në mes drejtorive përkatëse. Konkluzioni: Mos harmonizimet e të hyrave, ndikon në raportimin jo të drejtë të të hyrave apo evidentimin e klasifikimit të mundshëm në kode të gabuara të transaksioneve Rekomandimi – 2: rekomandojmë DKGJP, që të sigurojë se barazimet në mes drejtorisë përkatëse dhe zyrtarit kryesor financiar për të hyra të kryhen në baza të rregullta mujore dhe vjetore, të gjitha mospërputhjet e mundshme të sqarohen me kohë. Çështja -3, moszbatimi i kërkesave për menaxhimin e rrezikut. Konkluzioni, Mungesa e menaxhimit efektiv të rrezikut do të zvogëlojë përformancën e sistemit të vlerës për para si dhe do të dëmtojë ofrimin e cilësisë së përformancës së suksesit të mësimeve. Rekomandimi -3: Rekomandojmë që menaxhimi të jetë me efektiv në ofrimin e cilësisë së performancës në vendosjen e procesit kontrollues në arritjen e objektivave specifike. Fjala është tani e juaja të nderuar.
**Afrim Oruçi** – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, të gjeturat e auditorëve të brendshëm janë reale, ne kemi bashkëpunuar me kohë me auditorët, ata kanë kërkuar nga ne materiale dhe ne si drejtori ju kemi ofruar, prandaj po e them se këto të gjetura janë reale. Sa i përket rekomandimit të parë, ne jemi duke u munduar që vitet në vijim ky rekomandim të mos jetë, sa i përket mosbarazimit, fatkeqësisht kjo e gjetur ka figuruar edhe vitin e kaluar edhe tek raporti i auditorëve të jashtëm. Problemi ka qenë që kemi qenë në vitin pandemik dhe zyrtarja që ka qenë për barazimin e gjendjes ka qenë në pushim të lehonisë, zyrtarët tjerë nuk kanë dashur të shkojnë në financa për çdo muaj që të bëjnë barazimin, tani më ky problem është rregulluar. Ne si drejtori kemi bërë një plan të veprimit që ti qaset seriozisht rekomandimeve të auditorëve.
**Sead Boshnjaku** – Përshëndetje për të gjithë, rekomandimi imë për drejtorin është që gjatë planifikimit të buxhetit për vitin e ardhëm të jenë shifrat sa më të sakta, jo sikurse këtu që i kemi të cekur, që të hyrat e planifikuar për vitin 2021 ishin në vlerën prej 23,000.00 €, kurse realizimi i të hyrave 12,000.00 €. Pra realizimi kundrejt planifikimit ishte 55%. Pyetjen që ja kisha drejtuar drejtorit është: Çka ka ndikuar që të vije deri tek ky realizim i dobët.
**Afrim Oruçi** – Kjo është bërë për arsye se qeveria e re që është qendrore ka bërë hapjen e thirrjes për subvencione direkte e ka shpallë shumë me vonese, kjo kur nuk ka ndodhur më parë, gjithmonë thirrja është bërë në muajin shkurt, dhe ne zakonisht gjithmonë këto të hyra i realizojmë në këtë kohë. Kurse tani thirrja është bërë në muajin shtator – tetor, pra kjo ka qenë arsyeja e mos realizimit të të hyrave me planifikimin në këtë kohë, sepse kjo shumë është realizuar por në pjesën e dytë të vitet.
**Sead Rama** – Atë që e tha drejtori është ashtu, sa e di unë thirrja për subvencione ka qen par një muaji, mendoj se kjo periudhë do të barazohet me planifikim.

**Ruzhdi Kabashi** – Audior – Përshëndetje për të gjithë, nuk isha pajtuar me drejtorin për atë që e tha sepse ne çdo vite kemi pasur aplikime për subvencione, periudha se kur ka qenë thirrja nuk është e rëndësishme. E gjitha është qëllimi tek planifikimi, nëse vitin e kaluar kanë qenë të planifikuara p.sh 30,000.00 €, pse këtë vite me qene shuma 23,000.00 €. Poashtu nëse vitin e kaluar kanë qenë të realizuara 30,000.00€, ne atëherë duhemi të bazohemi në realizimin e viti të kaluar pra në të hyrat e përafërta, pra planifikimi i të hyrave është bërë shumë i vogël në krahasim me realizimin që mundet të bëhet.
**Afrim Oruçi** – Nëse këtë vite bazohemi në të hyrat e këtij veti dhe në atë periudhë bëjmë edhe planifikimin në bazë të kësaj periudhe, mendoj se përsëri do të gabohemi për vitin e ardhshëm, nëse ka thirrje në fillim të vitit, do të ketë tejkalim të të hyrave, nuk është diçka që varet nga ne, thirrja bëhet nga Ministria e Bujqësisë, pas kësaj periudhe nëse e shihni ne kemi tejkalim të të hyrave.
**Sead Boshnjaku** – Nëse në vitin 2020 kanë qenë të hyrat 30,000.00 €, rekomandimi imë kishte me qenë që planifikimi në të gjitha drejtorit të jetë 10% plus ose minus, në mënyrë që jo të bëhet më pak ose njëjtë edhe drejtoritë në fund të dalin të vetëkënaqur.
**Sead Rama** – I nderuar minus nuk ka mundësi të planifikohet, zakonisht planifikimit shkojnë plus disa përqindje, vetëm nëse kemi ndonjë rast specifik.
**Sead Rama** – Nëse nuk ka askush diçka të shtoj, desha të them diçka sa i përket këtij raporti në fund. Ky raport nuk ka pasur shumë rekomandime siç edhe e keni parë ju vetë, kanë qenë gjithsej 3 rekomandime, këto rekomandime janë të zbatueshme, drejtori e tha se rekomandimi numër 2 është plotësuar, atëherë besoj se edhe këto 2 rekomandime të mbetura do të plotësohen. Kalojmë në pikën e radhës:
**3. Shqyrtimi i Raportit të brendshëm për drejtorin e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.**
Sa i përket këtij raporti unë për vete nuk e kisha diskutuar fare, pasi edhe nuk e kemi askënd nga kjo drejtori, edhe pse drejtori i shëndetësisë tani është liruar nga detyra , mendoj se është dashur të dërgoj ndonjë përfaqësues nga kjo drejtori.
**Mirsad Shala** – Mendoj se drejtori i shëndetësisë edhe pse është liruar nga ky postë, ai emalin e ka parë dhe është dashur ta dërgoj ndonjë përfaqësues që të na jep disa sqarime që ne i kishim kërkuar. Mendoj se kur bëhet ftesa për mbledhje të Komitetit të Auditimit, kishte me qenë mirë që të qitni në CC edhe kryetarin e komunës, pastaj ndoshta do ta marrin pak ma seriozisht këtë punë.
**Sead Rama** – Të nderuar kalojmë në pikën e fundit për këtë mbledhje.
**5. Të ndryshme.**
A ka dikush të shtoj diçka sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, nëse jo atëherë unë për sot e mbylli mbledhjen, shihemi në mbledhjen e radhës.

Shtojcë; të bashkëngjitur gjeni pesë procesverbalet e seancave të mbajtura të Komitetit të Auditimit.

Rahovec, 30.03.2021

Sead Rama, Kryesues i Komitetit të Auditimit

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Kuvendi i Komunës Rahovec***
*Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec*

---

# DRAFT

# RREGULLORE

# PËR

# DHËNIEN E TITUJVE TË NDERIT, DEKORATAVE DHE ÇMIMEVE NGA KOMUNA E RAHOVECIT

**Maj - 2022**

**RREGULLORE PËR DHËNIEN E TITUJVE TË NDERIT, DEKORATAVE DHE ÇMIMEVE NGA KOMUNA E RAHOVECIT**

**Kuvendi i Komunës në Rahovec**

Në mbështetje të nenit 11 dhe nenit 12 paragrafi 2 pika c), nenit 17 dhe nenit 40 paragrafi 2 pika a) të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008) dhe nenit 10 paragrafi 2 pika 2.3, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.1, nenit 57 paragrafi 1 pika 1.19 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kuvendi I Komunës në Rahovec në mbledhjen e mbajtur me date 31.05.2022 miraton këtë:

# RREGULLORE PËR DHËNIEN E TITUJVE TË NDERIT, DEKORATAVE DHE ÇMIMEVE NGA KOMUNA E RAHOVECIT

## I. DISPOZITAT E PERGJITHSHME

### Neni 1

### Qëllimi

Me këtë Rregullore përcaktohen kushtet e përgjithshme dhe procedura për dhënien e titujve të nderit, çmimeve, dekoratave, mirënjohjeve dhe medaljeve nga Komuna e Rahovecit për qytetarët, personat jurdik, shtetasit e huaj dhe organizatat e ndryshme për merita të veçanta dhe kontribute në Komunën e Rahovecit.

### Neni 2
### Fushëveprimi

Dekoratat, mirënjohjet dhe çmimet tjera u ndahen dhe jepen individëve, shoqatave, organizatave, personaliteteve që kanë ndikuar në fusha të ndryshme të veprimtarisë shoqërore si, humanizmit, kontributit kombëtar, kulturor, sportiv dhe aktivitete të tjera publike në Komunën e Rahovecit.

### Neni 3
### Përkufizimet
**Me ketë Rregullore termat e mëposhtme kanë keto kuptime:**

1.**"Dekoratë"** është çmimi që u jepet personaliteteve të vendit ose të huaj, si shenjë nderimi për arritje të veçanta personale dhe për kontribut të përgjithshëm shoqëror.

2. **"Mirënjohje"** është çmimi që u jepet qyetarëve si shenjë nderimi për kontribut in në të mirë të qytetarëve të Komunës së Rahovecit.

3.**"Medalje"** – është çmimi që u jepet individëve të caktuar për arritjet personale apo grupore në fusha të ndryshme të veprimtarisë shoqërore e sportive.

## II. DEKORAT AT DHE DHËNIA E TYRE

### Neni 4
### Llojet e dekoratave dhe çmimet që i ndan Komuna e Rahovecit

Llojet e titujve - dekoratave që i ndan Komuna e Rahovecit janë:

1. **Dekorata "Qytetar nderi"** i Komunës së Rahovecit u jepet qytetarëve që nuk janë banorë të Komunës së Rahovecit për kontribut të përgjithshëm në të mirën e përgjithshme, për çështje kombëtare, liri dhe pavarësi.

2. **"Medalja e lirisë"** u jepet familjeve të dëshmorëve, invalidëve, veteranëve dhe luftëtarëve për çlirimin e atdheut në periudha të ndryshme të historisë kombëtare.

3. **Dekorata "Nderi i komunës"**, u jepet individëve për kontribute në promovimin e Komunës së Rahovecit dhe zhvillimin e përgjithshëm shoqëror.

4. **Dekorata "Ukshin Hoti"** –

- u jepet personaliteteve të shquara të fushës së politikës e

- familjeve emblematike dhe individëve që kanë kontribuuar për liri, dinjitet njerëzor e kombëtar;

- aktivistëve për ruajtjen dhe kultivimin e vlerave historike - kombëtare shqiptare dhe

- atyre që janë shquar për vlerat universale humaniste e civilizuese.

4.1. **Dekorata "Ukshin Hoti"** mund t'u jepet edhe personave të huaj që kanë kontribuar për çështjen shqiptare apo edhe për mbrojtjen e vlerave civilizuese e humaniste.

4.2. Kryetari i komunës për çdo vit, në ditëlindjen e Ukshin Hotit, më 17 qershor, ndan dekoratë për personalitetet e përcaktuar për këtë dekoratë.

5. **Dekorata për humanizëm "Dr. Ali Sokoli"**, u jepet personave që merren me aktivitete humanitare apo atyre që me punën dhe përkushtimin e tyre humanist kanë ndikuar në përmirësimin e kushteve të jetës e të punës për njerëzit në nevojë.

6. **Çmimi letrar "Sulejman Krasniqi"**, u jepet personave me kontribute në krijimtarinë letrare-artistike, personave që ndikojnë në ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare, në ruajtjen e trashëgimisë historike dhe në pasurimin e jetës kulturore-artistike.

6.1. Ky çmim ndahet nga një juri profesionale në Ditën e Bibliotekës Komunale "Sulejman Krasniqi" më 7 dhjetor.

6.2. Çmimi mund t'iu ndahet krijuesve dhe kontributdhënësve edhe pas vdekjes.

7. **Çmimi "Bujku i Vitit"**, i jepet një apo më shumë personave, qytetarë të komunës së Rahovecit, të cilët arrijnë rezultate inkurajuese në; perimekulturë, vreshtari, pemtari, fermë kafshësh, bletari, shpendari apo veprimtari tjetër prodhuese në fushë specifike të prodhimtarisë bujqësore, blegtorale apo shpendtari.

7.1. Fituesin apo fituesit e këtij çmimi e përzgjedh një komision ekspertësh i formuar nga kryetari i Komunës.

8. **Çmimi "Lexuesi i vitit"**, i jepet lexuesit/es – banor/e i/e Komunës së Rahovecit, për numrin më të madh të librave të lexuar gjatë një viti kalendarik, i cili është anëtar i rregullt i Bibliotekës Komunale "Sulejman Krasniqi", apo edhe personit i cili me punën dhe përkushtimin personal ka arritur të nxisë të lexuarit dhe krijimtarinë letrare – artistike tek të rinjtë.

(propozim; ky çmim mund të ndahet në ditën e qendrës së kulturës "Mensur Zberaj" më 28 maj apo në ndonjë nga ditët botërore të librit, të poezisë apo kulturës)

8.1 Çmimi "Lexuesi i Vitit" ndahet nga një juri e formuar enkas nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport.

8.2 Çmimi rëndom jepet një herë në vit, por jo domosdoshmërisht.

8.3 Varësisht nga konkurrenca, çmimi mund t'i jepet me shumë se një personi.

9. **Medalja -"Sportisti i vitit"**, i jepet sportistit – individit që është banor i Komunës së Rahovecit apo sportistit që i kontribuon zhvillimit të sportit në këtë komunë.

9.1. Mirënjohje dhe falënderime mund të ndajnë organet komunale brenda fushës së kompetencës së tyre.

10. **Mirënjohje - Falënderime** u jepen personave fizik dhe subjekteve juridike në shenjë mirënjohje për kontributin e dhënë qytetarëve dhe Komunës së Rahovecit.

11. Dekoratat nga paragrafi 1, 2, 3, 4, 5, 6 të këtij neni mund t'iu jepen edhe personaliteteve pas vdekjes (post mortum).

### Neni 5
### Propozimet për ndarjen e dekoratave dhe titujve të nderit

1. Dekoratat, titujt e nderit, mirënjohjet dhe çmimet, mund të propozohen nga anëtarët e Kuvendit të Komunës, nga Kryetari i Komunës, nga shoqata apo organizata të shoqërisë civile, si dhe nga personalitete të dëshmuara nga jeta politike, kulturore, shoqërore, studiues e hulumtues të shquar shkencor.

2. Në propozim parashtruesi i propozimit duhet të arsyetojë propozimin me shkrim, me një përmbledhje të veprimtarisë dhe kontributeve të veçanta të të propozuarit.

**Neni 6**
**Forma dhe dukja fizike e dekoratave**

1. Dekorata "Qytetar nderi" i komunës së Rahovecit përbëhet nga:

1.1. Pllakë bronzi me dimensione 21x30 cm të dekoruar, e cila në sfond ka emblemën e Komunës së Rahovecit, si dhe një certifikatë, të shkruar në gjuhën shqipe dhe në gjuhën amtare të atij/asaj që e pranon këtë decorate/titull. Përmban emrin dhe mbiemrin e bartësit të shpërblimit të shkruara me shkronja të gravuara në radhën e parë, dhe teksti "Qytetar nderi" i komunës së Rahovecit në radhën e dytë.

1.2. Certifikata shkruhet në letër të fortë cilësore së paku 150 gr, formati A4, me ngjyrë ari, në sfondin e së cilës është emblema e Komunes së Rahovecit dhe e nënshkruar nga Kryetari i Komunës.

2. Dekorata - titulli "Nderi i komunës", përbëhet nga:

2.1. Pllakë bronzi me dimensione 21x30 cm të dekoruar, e cila në sfond ka emblemën e komunës së Rahovecit si dhe një certifikatë të veçantë të shkruar në gjuhën shqipe. Përmban emrin dhe mbiemrin e bartësit të shpërblimit të gravura në radhën e parë, emërtimin e dekoratës përkatëse në radhën e dytë.

2.2. Certifikata shkruhet ne letër të fortë cilësore së paku 150 gr, formati A4, me ngjyrë argjendi, në sfondin e se cilës është emblema e Komunës së Rahovecit dhe e nënshkruar nga Kryetari i Komunës.

3. **Dekorata "Ukshin Hoti",** përfshin një pllakë metalike të gravuar me portretin e Ukshin Hotit, emrin dhe mbiemrin e përfituesit të dekoratës dhe motivacioni.

4. **Dekorata për humanizëm "Dr. Ali Sokoli",** mund të jetë një pllakë metalike apo dekoratë në letër kartoni, ku të jetë gdhendur portreti i Dr. Ali Sokolit, emri dhe mbiemri i përfituesit dhe motivacioni.

5. Çmimi "**Lexuesi i Vitit**" përbëhet nga:

5.1. Çmimi shoqërohet nga një fletëpërcjellje të cilësisë së lartë ku shënohet stema e Republikës së Kosovës, stema e komunës së Rahovecit, çmimi "Lexuesi i Vitit" dhe emri i pranuesit të çmimit.

6.Medalja "Sportisti i vitit", përbëhet nga medalje me ngjyrë ari dhe certifikatë të veçantë të shkruar në gjuhën shqipe. Përmban emrin dhe mbiemrin e bartësit të shpërblimit dhe emërtimin "Sportisti i Vitit".

7.Mirënjohjet dhe falënderimet jepen në formë të certifikatës që përmban emrin dhe mbiemrin e bartësit dhe arsyetimin e shkurtër të dhënies.

**Neni 7**
**Dorëzimi i dekoratës**

1. Pas aprovimit të rregullores nga Kuvendi i Komunës për dhënien e dekoratave, Kryetari i Komunës ia dorëzon dekoratën solemnisht të dekoruarit.

2. I dekoruari - bartësi i titullit nënshkruhet formalisht në Regjistrin e Bartësve të Titujve të Nderit, regjistër ky që do të mbahet nga Zyrtari për Protokoll i Komunës.

3. Në rast se personaliteti nuk jeton më, pranimin e dekoratës mund ta bëjë anëtari i afërm i familjes apo personi i afërm i të dekoruarit.

**Neni 8**
**Bartja dhe revokimi i titujve**

1. Bartësi i titullit është i obliguar që titullin ta bartë me dinjitet, duke pasur parasysh çdo herë sjelljet e tij në jetë dhe angazhimin e përditshëm, si dhe të dëshmojë respekt për autoritetin që i'a ka ndarë titullin apo dekoratën (Kuvendit të Komunës së Rahovecit).

2. Bartësit të titullit mund t'i revokohet titulli, nëse konstatohet se me sjelljet e veta dëmton imazhin e dhënësit të dekoratës, si dhe cenon vlerat morale, atdhetare e humaniste.

3. Revokimi bëhet në procedurën e paraparë paraprake sikur për dhënien e titullit (shpërblimit), ndërsa vendimi përfundimtar merret në mbledhje të rregullt të Kuvendit të Komunës.

## III. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

**Neni 9**
**Dekoratat dhe titujt e dhënë më parë**

Titujt e ndarë para hyrjes në fuqi të kesaj Rregulloreje do të konsiderohen valide dhe regjistrohen në Regjistrin e bartësve të Titujve të Nderit.

**Neni 10**
**Përgjegjës për zbatimin e kësaj Rregulloreje**

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje janë; Kryetari i Komunës së Rahovecit, Kuvendi i Komunës së Rahovecit dhe Drejtoritë përkatëse komunale.

**Neni 11**
**Hyrja në fuqi**

Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Rahovecit, kjo rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas shpalljes publike në Web faqen e Komunës.

**01 Nr.____/22**
**Datë:31.05.2022**

**Defrim Kafexhiu**

______________

**Kryesues i Kuvendit**

Në bazë të nenit 12 pika 1 dhe 2 shkronja d), nenit 14, nenit 17 paragrafi 1 shkronja c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 30/2013"), Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 01 Nr. 2566 i datës 30.05.2013, nenit 53 paragrafit 3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2016") dhe nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 39, nenit 40 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në Rahovec në mbledhjen e mbajtur me dt. 31.05.2022 miraton këtë:

**Projekt - V E N D I M**
**Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr. 295/22 i datës 30.03.2022 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për nevojat e komunitetit të fshatit Çifllak**

1. Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi 01 Nr. 295/22 i datës 30.03.2022 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për nevojat e komunitetit të fshatit Çifllak.

2. Ndryshimi dhe plotësimi bëhet duke u bazuar në shkresën me rekomandimet nga ana Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës Nr. 2183/22 të dt. 12.05.2022 dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Nr. 020-311/12 të dt. 12.05.2022.

3. Pas nenit 3 të vendimit bazik 01 Nr. 295/22 i datës 30.03.2022 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për nevojat e komunitetit të fshatit Çifllak, shtohet një nen i ri, me tekstin si në vijim:

   **3A.** Pjesa e parcelës në sipërfaqe prej 300 $m^2$ (treqind metra katror) në të cilën parashihet të ndërtohet objekti sipas pikës 1 dhe 2 të këtij vendimi, sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 01 Nr. 2566 i datës 30.05.2013 gjendet brenda zonës ndërtimore.

4. Nërsa pikët tjera të vendimit bazik me numër 01 Nr. 295/22 i datës 30.03.2022 mbesin të pandryshuara.

5. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren

(QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

*Vendimi u dërgohet:*

- *Anëtarëve të Kuvendit,*
- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

**KUVENDI I KOMUNËS SË RAHOVECIT**

**01-Nr._____/22**
**Datë: 31.05.2022**

**Defrim Kafexhiu**

__________________

**Kryesues i Kuvendit**

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosovo / Republic of Kosovo**
*Kuvendi i Komunës Rahovec*
*Opština Skupština Rah...a / Municipality of Rahovec*

RAHOVEC /ORAHOVAC
Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)
Nr./Br./No 295 Nr. i faq/Br.str/No.pg 01
Data/Datum/Date 30.03.2022

Në mbështetje te nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja (d), nenit 14, nenit 17 paragrafi 1 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr-03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 39, nenit 40, nenit 57 paragrafi1 pika 1.3 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit me Nr. Prot. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë:30.03.2022, merr këtë:

**VENDIM**
**Për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për nevojat e komunitetit të fshatit Çifllak**

1. Me këtë vendim **caktohet** lokacioni për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për nevojat e komunitetit të fshatit Çifllak.
2. Lokacioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të jetë në pjesën e parcelës kadastrale sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510081-00169-1 me sipërfaqe të përgjithshme prej 3541$m^2$ (tremijë e pesëqind e dyzet e një metra katror), zona kadastrale Çifllak, e evidentuar në posedim të P.SH.E Kosovës K.K.Rahovec.
3. Nga sipërfaqja e përgjithshme e parcelës së cekur në nenin 2 të këtij vendimi, ndahen **300$m^2$ (treqind metra katror)** për ndërtimin e objektit për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për nevojat e komunitetit të fshatit Çifllak.
4. Objekti për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme për nevojat e komunitetit të fshatit do të financohet nga donatorët.
5. Prona e paluajtshme dhe objekti që do të ndërtohet nuk e ndërron titullarin juridik, pronar i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë nga donatorët e ndërtimit të objektit.
6. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit që të bëjë parcelizimin dhe skicimin në teren dhe regjistrimin e gjendjes në librat kadastral.
7. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
8. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Anëtarëve të Kuvendit ,***
- ***Shërbimit të Kuvendit,***
- ***Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, dhe***
- ***Arkivi.***

**KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC**

**01 Nr.295/22**
**Me datë:30.03.2022**

**Defrim Kafexhiu**

**Kryesues i Kuvendit**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
*Komuna e Rahovecit*
*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*
**Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit**

---

Nr. Ref: 119
Data: 16.05.2022

Në mbështetje të nenit 62 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 të datës 25.05.2016, nenit 84 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017 dhe Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) Nr. 2566 i datës 30.05.2013, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në Komunën e Rahovecit jep këtë:

# KONSTATIM

Duke u bazuar në kërkesën për rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë me Nr. Prot. 2183/22 të datës 12.05.2022 dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Nr. 030-311/12 të datës 12.05.2022, Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit në Komunës së Rahovecit konstaton se: Ngastra kadastrale sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510081-00169-1 me sipërfaqe të përgjithshme prej 3541 $m^2$ (tremijë e peseqind e dyzet e një metra katror), zona kadastrale Çifllak, në vendin e quajtur Grobe-Qerana, në posedim të P.SH.E Kosovës K.K.Rahovec, sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) nr. 2566 i datës 30.05.2013 **gjindet brenda zonës ndërtimore**.

**Albnor Mullabazi**

**Drejtor i DUPMM**

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE AMBIENTIT / MINISTRASTVO INFRASTRUKTURE I SREDINE / MINISTRY OF INFRASTRUCTURE AND ENVIRONMENT
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71510081-00169-1

| | |
|---|---|
| Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: | 08-942/03-0025606/20 |
| Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: | 06.07.2020 - 14:29 |
| Komuna / Opština / Municipality: | Rahovec / Orahovac / Rahovec |
| Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: | ÇIFLLAK / ČIFLAK / ÇIFLLAK |
| Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: | Rahovec / Orahovac / Rahovec |

### A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë<br>Vrsta Jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type | Zona U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>(m²) | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P-71510081-00169-1 | PARCELË / PARCELA / PARCEL | / / | Rural | 3541<br>300m2<br>~~250 m² [illegible]~~ | 6/2007 | | |

### A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendbanimi - adresa<br>Prebivalište - adresa<br>Resident - address | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address Details | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|
| GROBLE-QERANA/GROBLE-QERANA/GROBLE-QERANA | | GROBLE-QERANA | | |

REPUBLIKA E KOSOVËS · Komuna e Rahovecit · Drejt. për Kadastër · RAHOVEC · VIII · ORAHOVAC · REPUBLIKA KOSOVA · Opština Orahovac

Printuar nga / Odštampano od / Printed by: Atip.Kryeziu | P-71510081-00169-1 | Zyrtari përgjegjës / Odgovorno lice / Official person

Atip Kryeziu



Ç; Fl[illegible]

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja (m²)<br>Površina (m²)<br>Area (m²) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture | Kullosa/Pašnjaci/pasture | Kullosë E Klasës 2/Pasnjak 2 Klase/2nd Class Pasture | 3541 |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivalište<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Upis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual / Individualna Drzavina / single possessor | P.SH.E KOSOV.K.K.RAHOVEC | KCID1502206 | RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC / | | RAHOVEC 1/2 | 1/1 | 6/2007 | |

**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova-Republic of Kosova**

***Qeveria -Vlada-Government***

*Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit / Ministrastvo Infrastrukture i Sredine / Ministry of Infrastructure and Environment*

**AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY**

## KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : RAHOVEC

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Çiflak

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Površina/Area m² |
|---|---|---|
| P-71510081-00169-1 | Parcelë / Parcela / Parcel | 3541 |



Shkalla/Razmera/Scale: 1:699

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 06.07.2020

Koha/ Vreme/ Time: 02:42:06

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojio/Aproved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature:


USHTARËVE
RILINDJA KOMBËTARE
RILINDJA KOMBËTARE
00167-0
00169-2
00169-1
Çiflak
00176-1
00176-2
00176-3
00177-0
00178-0
00484-0
89
91
93
15
12
11
103
106
104
90
108
110
92
118
116
120
111

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu
-III- Nr. i prot / Br. prot. 757 Më / Dt. 08.03.2022
RAHOVEC - ORAHOVAC

# Kuvendit Komunal Rahovec

## Kërkesë

**Për ndërtimin të Objektit për Aktivitete Rinore**

Këshilli i fshatit Çifllak Kërkojmë nga Kuvendi Komunal i Rahovecit që të na jep shfrytëzim një pjesë të parceles nr 169 (169-1) për ndërtimin e Objektin për Aktivitete Rinore. Ku mundë të i kryejmë të gjitha aktivitetet rinore te Fshatit

Fshati Çifllak numeron mbi 300 shtepi ose mbi 2000 banor andaj ne mendojmë se ndertimi një objekti të tillë është i domosdoshem.

Banoret e fshatit janë dakorduar se parcela e lartëshenua i plotëson të kushtet per këtë qellim dhe se nuk ashtë penges per ushtrimin e aktiviteteve të tjera të jetes normale në këtë fshatë

Ne mendojmë se siperfaqja prej 300 metra katror është e mjaftushme për ndertimin e këti objekti.

Duke shpresuar se kërkeses sonë do ti përgjigjeni pozitivishtë ju pershendesim përzemersishtë.

Me respektë kshilli i fështit Çifllak.

Çifllak.

08/03/2022

Kryrati fshatit.

Sali Thaqi

Lista e nënshkrimeve te Banoreve të Fshatit Çifllak për kërkes Komunes së Rahovecit

Për Shtëpi e Komunitetit [ODA E FSHATIT]

| Nr | Emri Mbiemri | Nr.persosnal | nënshkrimi |
|---|---|---|---|
| | Sali Thaqi | 1008121857 | [signature] |
| 1 | Bashkim Gashi | 1008120702 | Bashkim Gashi |
| 2 | Bexhet Limani | 1008189971 | [signature] |
| 3 | Ajet Salihi | 1008185910 | ASalihaj |
| 3 | Kytrim Kelmendi | 1008129482 | Kytim Kelmendi |
| 4 | AHMET KABASHI | 100822373 | AKaboshi |
| 5 | Nezir Thaqi | 1008188951 | N THAQI |
| 6 | Gani Krasniqi | 1008121537 | GANI KRASNIQI |
| 7 | Salih Krasniqi | 1008189460 | SKrasniqi |
| 8 | Ibrahim Thaqi | 1008185088 | [signature] |
| 9 | Nijazi Krasniqi | 1008187471 | NKrasniqi |
| 10 | Muhamet Kabashi | 1008129981 | Muhamet Kabashi |
| 11 | Hajdar Krasniqi | 1008189206 | HajdarKrasniqi |
| 12 | Enver [illegible] | 2008124837 | [signature] |
| 13 | Beslim Mazreku | 1008186273 | BMazreku |
| 14 | Avdi Thaqi | 1008123201 | AThaqi |
| 15 | Demush Ferizi | 1008185669 | DFerizi |
| 16 | Mustaf Kastrati | 1008860888 | Mustaf Kastrati |
| 17 | Hajdar Thaqi | 1008189915 | AThagi |
| 18 | | | |
| 19 | | | |
| 20 | | | |
| 21 | | | |
| 22 | | | |

08.03.2022

Çifllak

Kryetari I Këshillit të Fshatit

Sali Thaqi

[signature]

Në bazë të nenit 12 pika 1 dhe 2 shkronja d), nenit 14, nenit 17 paragrafi 1 shkronja c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), dispozitave të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 30/2013"), Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 01 Nr. 2566 i datës 30.05.2013, nenit 53 paragrafit 3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2016") dhe nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 39, nenit 40 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në Rahovec në mbledhjen e mbajtur me dt. 31.05.2022 miraton këtë:

**Projekt - V E N D I M**
**Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr. 296/22 i datës 30.03.2022 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e morgut për nevojat e komunitetit të fshatit Hoçë e Vogël**

1. Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi 01 Nr. 296/22 i datës 30.03.2022 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e morgut për nevojat e komunitetit të fshatit Hoçë e Vogël.

2. Ndryshimi dhe plotësimi bëhet duke u bazuar në shkresën me rekomandimet nga ana Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës Nr. 2187-3/22 të dt. 12.05.2022 dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Nr. 020-311/13 të dt. 12.05.2022.

3. Pas nenit 3 të vendimit bazik 01 Nr. 296/22 i datës 30.03.2022 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e morgut për nevojat e komunitetit të fshatit Hoçë e Vogël, shtohet një nen i ri, me tekstin si në vijim:

   **3A.** Pjesa e parcelës në sipërfaqe prej 500 $m^2$ (pesëqind metra katror) në të cilën parashihet të ndërtohet morgu sipas pikës 1 dhe 2 të këtij vendimi, sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 01 Nr. 2566 i datës 30.05.2013 pjesa prej afro 40% e parcelës është brenda kufirit ndërtimor, kurse pjesa tjetër prej afro 60% është e paraparë si tokë bujqësore klasa e bonitetit II.

4. Nërsa pikët tjera të vendimit bazik me numër 01 Nr. 296/22 i datës 30.03.2022 mbesin të pandryshuara.

5. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren

(QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

*Vendimi u dërgohet:*

- *Anëtarëve të Kuvendit,*
- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

**KUVENDI I KOMUNËS SË RAHOVECIT**

**01-Nr.____/22**
**Datë: 31.05.2022**

**Defrim Kafexhiu**

**Kryesues i Kuvendit**

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec

RAHOVEC /ORAHOVAC

Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)
Nr./Br./No 296 Nr. i faq/Br.str/No.pg 01
Data/Datum/Date 30/03/2022

Në mbështetje te nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja (d), nenit 14, nenit 17 paragrafi 1 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr-03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 39, nenit 40, nenit 57 paragrafi1 pika 1.3 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit me Nr. Prot. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë:30.03.2022, merr këtë:

**VENDIM**

**Për caktimin e lokacionit për ndërtimin e morgut për nevojat e komunitetit të fshatit Hoçë e Vogël**

1. Me këtë vendim **caktohet** lokacioni për ndërtimin e morgut për nevojat e komunitetit të fshatit Hoçë e Vogël dhe më gjerë.
2. Lokacioni i cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të jetë në pjesën e parcelës kadastrale sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510046-00813-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 35595m$^2$ (tridhjetë e pesë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e pesë metra katror), zona kadastrale Hoçë e Vogël, e evidentuar në posedim të Komunës së Rahovecit.
3. Nga sipërfaqja e përgjithshme e parcelës së cekur në nenin 2 të këtij vendimi, ndahen **500m$^2$ (pesëqind metra katror)** për ndërtimin e morgut për nevojat e komunitetit të fshatit Hoçë e Vogël dhe më gjerë.
4. Ky objekti do të financohet nga donatorët.
5. Prona e paluajtshme dhe objekti që do të ndërtohet nuk e ndërron titullarin juridik, pronar i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë nga donatorët e ndërtimit të objektit.
6. Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit që të bëjë parcelizimin dhe skicimin në terren dhe regjistrimin e gjendjes në librat kadastral.
7. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
8. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

***Vendimi u dërgohet:***

- ***Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, dhe***
- ***Arkivi.***

**KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC**

**01 Nr.296/22**
**Me datë:30.03.2022**

**Defrim Kalexhiu**
**Kryesues i Kuvendit**

**Republika e Kosovës**
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
***Komuna e Rahovecit***
*Opština Orahovac / Municipality Rahovec*
**Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit**

---

Nr. Ref: 118
Data: 16.05.2022

Në mbështetje të nenit 62 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), nenit 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 të datës 25.05.2016, nenit 84 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017 dhe Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) Nr. 2566 i datës 30.05.2013, Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale në Komunën e Rahovecit jep këtë:

# KONSTATIM

Duke u bazuar në kërkesën për rishqyrtimin e ligjshmërisë së aktit të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë me Nr. Prot. 2187-3/22 të datës 12.05.2022 dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal Nr. 030-311/13 të datës 12.05.2022, Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit në Komunës së Rahovecit konstaton se: Ngastra kadastrale sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510046-00813-0 me sipërfaqe të përgjithshme prej 35595m$^2$ (tridhjetë e pesë mijë e peseqind e nëntëdhjetë e pesë metra katror), zona kadastrale Hoçë e Vogël, në posedim të Komuna e Rahovecit, sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) nr. 2566 i datës 30.05.2013 **ka destinim një pjese prej afro 40% e parcelës është brenda kufirit ndërtimor, kurse pjesa tjetër prej afro 60% është e paraparë si Tokë Bujqësore Klasa e Bonitetit II.**

**Albnor Mullabazi**
*[signature]*
**Drejtor i DUPMM**

Hoçë Vogël

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
*Qeveria - Vlada - Government*
*Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure*
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

# CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

## NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-71510046-00813-0

| | |
|---|---|
| Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number: | 08-942/03-0011525/22 |
| Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission: | 08.03.2022 - 09:30 |
| Komuna / Opština / Municipality: | RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC |
| Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: | Hoçë E Vogël / Mala Hoca / Hoqa E Vogël |
| Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: | RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC |

## A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

| Numri i njësisë kadastrale<br>Broj katastarske jedinice<br>Cad. Unit. No. | Lloji i njësisë<br>Vrsta Jedinice<br>Unit Type | Lloji i pronës<br>Vrsta imovine<br>Property Type | Zona<br>U/R<br>G/S<br>U/R | Sipërfaqja<br>Površina<br>Area<br>(m²) | Përshkrim<br>Opis<br>Description | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| P-71510046-00813-0 | PARCELË / PARCELA / PARCEL | Pronë shoqërore / Drushtvena Imovina / Socially owned Land | | 35595 | 1-1997 | | |

## A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE /CADASTRAL UNIT ADDRESS

| Vendbanimi - adresa<br>Prebivaliste - adresa<br>Resident - address | Kodi Postal<br>Poštanski Kod<br>Postal Code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address Details | Krijuar më datën<br>Uradjeno na dan<br>Created On | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|
| KODRA-GROBLJE/KODRA-GROBLJE/KODRA-GROBLJE | | | | |

REPUBLIKA KOSOVA / Komuna për Kadastër / Opština Orahovac / Odeljenje za Katastar — ORAHOVAC

## A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

| Numri<br>Broj<br>Number | Lloji i shfrytëzimit të parcelës<br>Vrsta koriscenja parcele<br>Parcel Type Of Use | Shfrytëzimi aktual i parcelës<br>Trenutno koriscenje parcele<br>Parcel Current Use | Kualiteti i klasës<br>Kvalitet klase<br>Quality Class | Sipërfaqja (m²)<br>Površina (m²)<br>Area (m²) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Tokë Tjetër/Ostalo Zemljiste/OtherLand | Jo Pjellore/Neplodno/Unproductive | | 35595 |

## B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

| Të drejtat<br>Prava<br>Rights | Emri<br>Ime<br>Name | Nr. personal<br>Licni broj<br>ID. No. | Vendbanimi<br>Prebivaliste<br>Resident | Kodi postal<br>Poštanski kod<br>Postal code | Hollësitë e adresës<br>Pojedinosti adrese<br>Address details | Pjesa e pronës<br>Deo imovine<br>Share quota | Pershkrimi<br>Opis<br>Description | Azhuruar<br>Ažurirano<br>Updated |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor | **Komuna e Rahovecit** | 600535233 | RAHOVEC / ORAHOVAC / RAHOVEC / | | DËSHMORËT E PASHTRIKUT | 1/1 | 1-1997 | |

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA /GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

## KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : RAHOVEC

Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Hoçë e Vogël

| Njësia/Jedinica/Unit | Tipi/Vrsta/Type | Sipërfaqja/Površina/Area m² |
|---|---|---|
| P-71510046-00813-0 | Parcelë / Parcela / Parcel | 35595 |




Shkalla/Razmera/Scale: 1:2395

Punoi/Obradio/Created:

Data/ Data/Date: 08.03.2022

Koha/ Vreme/ Time: 09:37:55

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note:

Aprovoi/Usvojio/Approved: Drejtori/Direktor/Director

Nënshkrimi/Potpis/Signature


00760-0
00762-0
00764-0
00848-0
00813-0
00847-0
00815-0
00816-0
00812-0
00810-2
00810-1

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu
-III- Nr. i prot / Br. prot. 219 Më / Dt. 07.03.2022
RAHOVEC - ORAHOVAC

*Drejtuar:* **Komunës së Rahovecit**

*Për:* **Kryetarin e Komunës – Kuvendin Komunal**

*Nga:* **Këshilli i Fshatit Hoçë e Vogël**

*Këshillit i fshatit Hoçë e Vogël, në mbledhjen e vet të mbajtur me 5.03.2022 ka vendosur që t'iu drejtohet autoriteteve komunale përkatësisht, Kryetarit të Komunës z.Smajl Latifit dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit që të na përkrahin në ndërtimin e një morgu në fshatin tonë, me këtë:*

## *KËRKESË*

Duke u mbështetur në kërkesat e qytetarëve tanë, si dhe duke u mbështetur edhe në të drejtën tonë ligjore, përkatësisht duke u bazuar në Ligjin nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së të Komunës, si dhe ligjeve e akteve tjera nënligjore që rregullojnë bashkëpunimin e institucioneve komunale me qytetarë, Këshillit i fshatit Hoçë e Vogël i drejtohet Kryetarit të Komunës z.Smajl Latifit dhe Kuvendit të Komunës së Rahovecit që të na përkrahin në ndërtimin e një morgu në fshatin tonë.

